

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2021



42

PRISHTINË
2022

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2021

42



PRISHTINË
2022

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

YEAR-BOOK 2021

42

Editor: Correspondent member Luan Mulliqi, Scientific Secretary

Prepared by: Lendita Juniku- Pula



**PRISHTINA
2022**

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

VJETARI 2021

42

Redaktor: Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, Sekretar shkencor

Përgatitur nga: Lendita Juniku- Pula



**PRISHTINË
2022**

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

PËRBËRJA E AKADEMISË	1
KRYESIA	1
ANËTARËT E AKADEMISË	3
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	3
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	3
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	3
SEKSIONI I ARTEVE	4
ANËTARËT IN MEMORIAM	4
ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS	4
ANËTARËT E JASHTËM	4
ANËTARË NDERI	5
SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE	5
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021	7
HYRJE	9
KUVENDI	9
KRYESIA	19
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	41
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	46
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	48
SEKSIONI I ARTEVE	50
SHËRBIMI PROFESIONAL, ADMINISTRATIV E TEKNIK	53
PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK- ut PËR VITIN 2022	59
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS	79
KRONIKA E VITIT 2021	93

PËRBËRJA E AKADEMISË

KRYESIA



Akademik
Mehmet Kraja
Kryetar
(3.10.2019 – vazhdim)



Akademik
**Jusuf
Bajraktari**
Nënkryetar



Anëtare
korrespondente
Myzafere Limani
*Sekretare
shkencore*



Akademik
Eqrem Basha
*Sekretar i
Seksionit të
Gjuhësisë dhe
të Letërsisë*



Akademike
**Justina Shiroka-
Pula**
*Sekretare e
Seksionit të
Shkencave
Shoqërore*



Anëtar
korrespondent
**Fetah
Podvorica**
*Sekretar i
Seksionit të
Shkencave të
Natyres*



Anëtar
korrespondent
Luan Mulliqi
*Sekretar i
Seksionit të
Arteve*

PËRBËRJA E AKADEMISË

ANËTARËT E AKADEMISË

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000, Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më 2004, Kujtim Shala (1974), i zgjedhur më 2020, Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më 2008, Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më 1996, Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më 1975, Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më 2008. Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Bardh Rugova (1974) i zgjedhur më 2016, Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më 2012, Nysret Krasniqi (1976), i zgjedhur më 2020, Shkumbin Munishi (1971) i zgjedhur më 2020.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më 2016, Edi Shukriu (1950), e zgjedhur më 2020 Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000, Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012, Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më 2016. Justina Shiroka Pula (1953), e zgjedhur më 2020, Muhamedin Kullashi (1949), i zgjedhur më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më 2012, Besnik Krasniqi (1978), i zgjedhur më 2020, Frashër Demaj (1973), i zgjedhur më 2016, Gjyljeta Mushkolaj (1963), e zgjedhur më 2016,

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më 2012, Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më 2000, Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më 2012,

Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më
1996.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Morina (1956), i zgjedhur më
2012,
Fetah Podvorica (1968), i zgjedhur më
2016,
Myzafere Limani (1954), e zgjedhur më
2016,
Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më
2012,
Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më 2000,
Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,
Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Luan Mulliqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më 2012.

ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Agim Çavdarbasha,
Ali Hadri,
Ali Podrimja,
Idriz Ajeti,
Besim Bokshi,
Dervish Rozhaja,
Ekrem Murtezai,
Engjëll Berisha,
Esat Stavileci,
Enver Gjerqeku,
Esad Mekuli,
Fehmi Agani,

Gazmend Zajmi,
Jashar Rexhepagiq,
Latif Susuri,
Mark Krasniqi,
Muharrem Berisha,
Musa Haxhiu,
Muslim Mulliqi,
Osman Imami,
Pajazit Nushi,
Remzi Bakalli,
Syrja Popovci,
Vladeta Vukoviq,
Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova,
Ruzhdi Pllana.

ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur
më 1986.

b) Anëtarët korrespondentë:

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur
më 1991.

ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipçeviq (histori), Kroaci, i
zgjedhur më 1983,
Abdylmenaf Bexheti (ekonomi),
Maqedoni e Veriut, i zgjedhur më
2020,
Brian D. Joseph (gjuhësi), SHBA, i
zgjedhur më 2020,
Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i

zgjedhur më 1991,
Irena Sawicka (gjuhësi), Poloni, e
zgjedhur më 2020,
Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i
zgjedhur më 1991,
Eric Hamp (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur
më 1991,
Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i
zgjedhur më 1996,
Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i
zgjedhur më 1996,
Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë,
i zgjedhur më 1996,
Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani,
i zgjedhur më 1996,
Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i
zgjedhur më 2000,
Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur
më 2000,
Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë),
Francë, i zgjedhur më 2000,
Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i
zgjedhur më 2000,
Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i
zgjedhur më 2000,
Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur
më 2004,
Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i
zgjedhur më 2004,
Emin Riza (arkitekturë), Shqipëri, i
zgjedhur më 2008,
Françesko Altimari (gjuhësi), Itali, i
zgjedhur më 2008,
Muhamet Mufaku (histori), Jordan, i
zgjedhur më 2008,
Alajdin Abazi (elektroteknikë),
Maqedoni, i zgjedhur më 2012,
Kolec Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i
zgjedhur më 2012,
Oliver Schmit (histori), Austri, i
zgjedhur më 2012,
Radoslav Katičić (gjuhësi), Kroaci, i
zgjedhur më 2012,
Bahri Beci (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur
më 2016,
Matteo Mandala (gjuhësi), Itali, i

zgjedhur më 2016,
Mentor Petrela (mjekësi), Shqipëri, i
zgjedhur më 2016,
Kristaq Prifti (histori), Shqipëri, i
zgjedhur më 2016.

ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i
zgjedhur më 2000.

SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK

Lendita Juniku Pula, sekretare e
Akademisë,
Ali Caka, drejtor i Departamentit të
Përkrahjes Profesionale dhe
Teknologjisë së Informacionit e
Komunikimeve,
Vjollca Hykolli, drejtoreshë e
Departamentit për Buxhet dhe
Financa,
Hilmi Zogjani, drejtor i Departamentit
të Bibliotekës dhe Arkivit,
Furtuna Naka, udhëheqëse e
prokurimit,
Xhemshit Brajshori, zyrtar i lartë për
marrëdhënie ndërkombëtare,
Hasime Maliqi, zyrtare certifikuese,
Lirijeta Bunjaku, zyrtare e lartë për
buxhet dhe financa,
Lidije Kelmendi, zyrtare e librarisë,
Rejhane Ajeti Islami, zyrtare e lartë për
bibliografi dhe hulumtim shkencor
Bedri Pllana, zyrtar bibliotekar,
Taulant Veseli, administrator i lartë i
sistemeve të TIK-ut,
Gerta Çuna, zyrtare e TI- së për
përkrahje,
Burim Rexhepi, zyrtar i lartë për
botime,
Nitë Krasniqi, zyrtare e logjistikës
Alban Bytyçi, vozitës- korrier,
Valbona Olluri, zyrtare teknike.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021



RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

HYRJE

Edhe gjatë vitit 2021 për shkak të përhapjes së pandemisë Covid- 19 u aplikuan masat parandaluese nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të penguar shtrirjen e saj. Kjo gjendje ndikoi në realizimin e Programit të punës së ASHAK- ut.

Disa aktivitete shkencore u anuluan, ndërsa disa të tjera u mbajtën me numër të reduktuar të pjesëmarrësve.

KUVENDI

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2021 ka mbajtur tri mbledhje. Mbledhja e parë më 24 shkurt (CIII), mbledhja e dytë më 30 qershor (CIV) dhe mbledhja e tretë (CV) më 9 dhjetor.

I. Mbledhjen e parë të vitit 2021(CIII) e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, i cili e propozoi rendin e ditës dhe kërkoi miratimin e Kuvendit.

H. Islami në diskutimin e tij kërkoi që pika 4 (Shqyrtimi dhe miratimi i projekt- idesë dhe propozimi i anëtarëve të grupeve punuese për hartimin e platformave për Enciklopedinë shqiptare, Fjalorin e madh të gjuhës shqipe dhe Kuvendin e studimeve albanologjike) të hiqet nga rendi i ditës. Ai tha se kjo pikë e rendit të ditës të kthehet për diskutim së pari nëpër seksione e më pas të diskutohet

në një mbledhje tjetër të Kuvendit.

Kryetari Kraja tha se sqarimin pse duhet të diskutohet kjo pikë sot në Kuvend e ka paraqitur në shkresën e cila fillimisht është miratuar nga Kryesia e Akademisë dhe u është dërguar me materiale të gjithë anëtarëve të Akademisë. Ai tha se është mirë që sot të caktohen grupet punuese, të cilat do t'i hartojnë platformat e më pas miratimin e platformave e bën Kuvendi i Akademisë. Diskutuan edhe R. Ismajli, A. Aliu, S. Hamiti dhe pas diskutimeve Kuvendi vendosi që pika 4 të hiqet nga rendi i ditës, diskutimi për projektet e paraqitura në pikën 4 të kthehet nëpër seksione dhe më pas në Kuvend.

U miratua rendi i ditës: miratimi i procesverbalit të mbledhjes CII të Kuvendit të Akademisë; Miratimi i Raportit të punës së Akademisë për vitin 2020; Miratimi i Raportit financiar të Akademisë për vitin 2020 dhe çështje vijuese.

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin nga mbledhja pararendëse.

Para fillimit të shqyrtimit të Raportit të punës së Akademisë për vitin 2020, Kryetari Kraja paraqiti një rekapitullim të punës për vitin 2020. Ai në fjalën e tij tha:

“Sikundër që tashmë është e njohur, viti i shkuar, për shkak të pandemisë, ka qenë një vit i vështirë për të gjithë ne, një vit i vështirë për të gjithë institucionet e vendit dhe, vetëkuptohet, edhe për Akademinë. Prandaj programi i punës, të cilin po e shqyrtojmë sot, ka mungesat e veta

krejtësisht të arsyeshme dhe të paevitueshme.

Megjithatë, edhe përkundër kësaj vështirësie, Akademia ka arritur ta ruajë vazhdimësinë e punës dhe të aktiviteteve të saj, të ruajë qëndrueshmërinë institucionale dhe të zhvillojë një aktivitet ndonjëherë gati alternativ, në mënyrë që, për aq sa ishte e mundur, të mos binte në vakuum programor.

Mbështetja kryesore e Akademisë, edhe në këtë rast ka qenë puna individuale e anëtarëve të saj. Vepra të rëndësishme janë realizuar nga anëtarët e Akademisë dhe unë me këtë rast dua t'i përgëzoj ata për përkushtimin dhe profesionalizmin, që edhe në një kohë të këtillë kanë pasur kurajë t'i përkushtohen punës së tyre shkencore dhe artistike.

Por pavarësisht nga kjo, programi i punës i Akademisë gjatë vitit të shkuar i ka pasur mungesat e veta, veçmas në format e paraqitjes publike, siç janë konferencat dhe tryezat shkencore, pastaj ekspozitat, koncertet, promovimet dhe aktivitete të tjera, të cilat implikojnë përfshirje më të madhe të një audience më të gjerë shkencore dhe artistike.

Ideja për ta hapur Akademinë ndaj një audience më të gjerë shkencore dhe artistike natyrisht që ka pësuar një goditje të rëndë, por jo të pariparueshme. Synimi për të mbajtur një komunikim intensiv të Akademisë me opinionin publik po ashtu pësoi shumë, sepse reduktimi i veprimtarive ose pezullimi i tyre e la këtë komunikim pa një subjekt substancial.

Ishte vetëm politika ajo që funksionoi pa ndonjë pengesë të madhe, por Akademia si institucion arriti të mbahej jashtë ndikimeve dhe përdorimit të saj

për kauza të politikës ditore.

Megjithatë, edhe përkundër të gjitha vështirësive, gjatë vitit të kaluar ne arritëm të zhvillonim një proces normal, përgjithësisht të suksesshëm, të zgjedhjeve të anëtarëve të rinj dhe të përparimit të anëtarëve korrespondentë në anëtarë të rregullt të Akademisë. Me këtë rast nuk mendoj se nuk duhet të komentohen rezultatet, por vetëm procesi, i cili i përmbushi të gjitha standardet dhe parametrat e rregullativës ligjore dhe statutore.

Por, më lejoni të them këtu se, nga rrethanat e pandemisë u godit edhe njëra nga shtyllat themelore të programit të punës së Akademisë, që është veprimtaria botuese, e cila pësoi vonesa të mëdha, një herë për shkak të pandemisë, deri në qershor të vitit 2020, dhe pastaj për shkak të procedurave të tenderimit, të cilat u tërhoqën zvarrë për disa muaj me radhë, zvarritje kjo që nuk u tejkalua as me ndërhyrje në OSHP. Kjo bëri që dalja e pothuajse të gjithë botimeve të Akademisë të vitit 2020 të zhvendosen në dy muajt e parë të këtij viti. (Sot mbërrijnë në Akademi 16 vepra, tashmë të shtypura dhe të përfunduara.)

Ndërkohë, edhe përkundër kësaj situatë, Akademia arriti të realizojë tre projekte alternative: një raport për dialogun me Serbinë; raportin për energjinë dhe të hartojë një platformë gjithëpërfshirëse për arsimin, e cila tashmë është gati.

Ndryshe nga "Raporti për energjinë", në realizimin e të cilit u përfshinë pothuajse të gjithë anëtarët e Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe si rezultat doli një studim i plotë dhe gjithëpërfshirës, raporti për dialogun

me Serbinë u refuzua nga seksioni përkatës dhe nga synimi për të qenë një punë ekipore, u desh të përfundonte në një projekt autorial. Afërsisht e njëjta gjë ndodhi edhe me platformën për arsimin, e cila tashmë është realizuar (mbetet vetëm të caktohet koha kur do të bëhet publike), por me një vërejtje substanciale, se hartimi i kësaj platforme u bë nga sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore (i shpreh mirënjohje për punën e bërë) dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, me një pjesëmarrje dhe ndihmë minimale të anëtarëve të Akademisë.

Një projekt tjetër alternativ është edhe biblioteka: është në realizim e sipër ideja që biblioteka e Akademisë të bëhet bibliotekë e specializuar për botimet për Kosovën në gjuhët e ndryshme të botës. Projekti është ambicioz dhe kërkon kohë që të realizohet.

Dua të tërheq vëmendjen tuaj edhe për disa çështje që lidhen me këtë raport vjetor:

- E para, efikasiteti i administratës. Ende nuk është arritur që shërbimet e administratës të vihet në funksion të plotë të stafit akademik. Administrata ende synon të bëhet një akademi më vete brenda Akademisë. Për ta evituar këtë situatë, është vendosur që të gjitha vendimet financiare, me transparencë të plotë, të kalojnë në vendimmarrje të plotë të Kryesisë, pavarësisht se për çfarë niveli të shpenzimeve bëhet fjalë. Në anë tjetër, të gjitha daljet financiare, blerjet, tenderimet etj., përveç që duhet të miratohen nga Kryesia, ato duhet të mbikëqyren nga stafi akademik. (Megjithatë, kësaj administrate i duhet njohur merita dhe vullneti i mirë për të

rritur financiarisht të ardhurat e stafit akademik, përmes gjetjeve ligjore, që bënë që shpërblimet e akademikëve të mos përfshihen në tatimin e të ardhurave).

- E dyta, mirëmbajtja e objektit, i cili, për shkak të punimeve jocilësore tashmë kishte filluar të degradonte. Janë bërë disa ndërhyrje, që duhet të vazhdojnë dhe të cilat bëhen kryesisht pa shpenzime financiare, sepse merren përsipër nga ministria përkatëse, por kërkojnë impenjim të vazhdueshëm.

- Në të ardhmen duhet të evitohet përfshirja në programin e punës së Akademisë të projekteve që nuk realizohen;

- E treta, duhet nxitur një kohezion më i madh dhe bashkëpunim ndërmjet seksioneve. Seksionet dhe as individët (çdo respekt për punën e tyre), nuk duhet të bëhen akademi brenda Akademisë;

- E katërta, është një e arritur e mëhershme që botimet e Akademisë, shumica syresh, tashmë janë të një niveli të mirë shkencor, por tani mbetet të bëhet një punë më e madhe redaktoriale dhe në standardizim i aparaturës shkencore dhe i paraqitjes së saj përmbajtësore dhe grafike. Në këtë pikë kërkohej angazhim më i madh i sekretarëve të seksioneve, të cilët njëkohësisht janë edhe redaktorë të botimeve;

- E pesta, mbetet të bëhet një punë më e madhe në standardizimin e revistave, të cilat, gjithashtu, kërkojnë redaktim dhe përzgjedhje të teksteve, pajisje me aparaturë shkencore etj. ;

- E gjashta, aktivizimi dhe përditësimi i faqes së internetit, qoftë i biografive dhe bibliografive të akademikëve, përfshirë edhe botimet e tyre dhe

aktivitetin e tyre akademik, shkencor dhe artistik.

- E shtata, mungon një elaborat për një projekt konkret për funksionalizimin e Qendrës Leksikografike Enciklopedike, nuk mungojnë as mjetet financiare as pajisjet teknike.

- Dhe e teta, këtij raporti të punës i mungojnë raportet e komisioneve, të cilat edhe për aq sa kanë punuar, nuk kanë paraqitur përshkrim të punës së tyre në formë të përmbledhur”.

Më pas filloi shqyrtimi i Raportit të punës me radhë duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet dhe SHPAT. Në diskutimin e tij M. Dushi paraqiti disa vërejtje, së pari për procesin e zgjedhjeve për anëtarë të Akademisë. Ai tha se zgjedhjet nuk është dashur të mbahen në një situatë pandemike dhe se shqetësimin ia ka përcjellë edhe Kryetari Kraja. Po ashtu ai paraqiti edhe vërejtje për prurjet e reja. Më pas M. Dushi diskutoi edhe një herë për projektin “Vendbanimet e Kosovës” duke paraqitur vërejtje për raportin e paraqitur për projektin në fjalë, ku ka munguar pjesa e arsytimit financiar.

Sa i përket mbajtjes së zgjedhjeve Kryetari Kraja sqaroi se mbajtja e zgjedhjeve me kohë është kërkesë ligjore dhe se të gjitha procedurat janë mbajtur në përputhje me masat anti-Covid, ndërsa për anëtarët e zgjedhur ai tha se kjo çështje tani më ka përfunduar nëpërmjet një procesi të rregullt, transparent dhe me votën e secilit anëtar të Akademisë. Lidhur me vërejtjet për projektin “Vendbanimet e Kosovës” reagoi J. Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore. Ajo në fjalën e saj tha se projekti në fjalë i përket Seksionit të SSHS-së dhe se në Seksion janë dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme, të cilat i janë përcjellë edhe

Kryesisë dhe Kuvendit të Akademisë. Kjo çështje është diskutuar disa herë edhe në Kuvend dhe konsiderohet e mbyllur tani më. Ajo tha se ky lloj diskutimi që po përsëritet në disa kuvende radhazi duhet të tejkalohet. Dokumentet për projektin në fjalë i ka të gjitha SSHS-ja dhe si sekretare e Seksionit jam e gatshme t’ju ofrojë të gjitha sqarimet që kërkoni, por kjo mënyrë e komunikimit duke etiketuar vazhdimisht emra të anëtarëve të Seksionit tonë është e papranueshme. Ajo po ashtu reagoi edhe për vërejtjet për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë duke thënë se nuk ka kuptim të zhvillohet një diskutim i tillë, procesi zgjedhor ka përfunduar, secili prej nesh ka votuar sipas bindjes së vet dhe secili mban përgjegjësi për votën e dhënë.

Pas diskutimeve Kuvendi e miratoi Raportin e punës së Akademisë për vitin 2020, i cili do të botohet në revistën “Vjetari 2020”.

Kuvendi e shqyrtoi në vazhdim edhe Raportin financiar për vitin 2020. Kryetari Kraja tha se viti 2020 ishte vit i vështirë për shkak të pandemisë Covid-19. Gjatë vitit ka pasur shkurtime buxhetore dhe deklarim të kursimeve për shkak të pamundësisë për realizimin e aktiviteteve të parapara, dhe se të gjitha janë paraqitur në Raport.

Raporti financiar i Akademisë për vitin 2020 u miratua pa vërejtje.

II. Në mbledhjen e dytë të Kuvendit CIV, para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës Kryetari Kraja në fjalën hyrëse theksoi:

“Të nderuar anëtarë të Akademisë, Më lejoni që në fillim të shpreh

kënaqësinë time që jemi këtu sërish në një mbledhje të Kuvendi, të përfshirë nga një ndjenjë lehtësimi, me që kaluam së bashku një periudhë të vështirë, pa përjetuar pasoja dhe dhembje të reja, të shkaktuara nga pandemia dhe pasojat e saj.

Me gjithë vështirësitë, gjatë këtyre muajve, që nga mbledhja e fundit e Kuvendit, mund të themi se Akademia ka arritur ta ruajë vazhdimësinë e punës dhe të aktiviteteve të saj, të zhvillojë veprimtaritë themelore dhe të ruajë qëndrueshmërinë e institucionit.

Edhe gjatë kësaj periudhe mbështetja kryesore e Akademisë ka qenë puna individuale e anëtarëve të saj, të cilët, me gjithë vështirësitë dhe atmosferën jo të përshtatshme, kanë arritur të realizojnë vepra të rëndësishme nga fushat e ndryshme të shkencës dhe të arteve. Ata dua t'i përgëzoj me këtë rast për përkushtimin dhe profesionalizmin.

Lehtësimi gradual i masave anti- covid bëri që Akademia, së fundi, të bëjë përpjekjet e para të kthimit në normalitet, duke rikthyer në agjendë aktivitete nga programi i punës, siç është veprimtaria botuese, por edhe disa projekte alternative, siç i kam quajtur unë, siç ishte paraqitja publike e platformës për arsimin dhe projekti për ekonominë në hije, pastaj radhazi promovimi i botimeve të reja nga të katër seksionet: "Leksikoni i vendbanimeve", pastaj "Demografia e Kosovës" e akademik Hivzi Islamit, vepra e Norbert Joklit "Studime historiko- krahasuese për gjuhën shqipe", "Studime albanoballkanologjike" të Brian D. Joseph-it, "Leksikoni i termave të sociolinguistikës", promovimi i botimit të veprës muzikore të akademik Rauf

Dhomit dhe, së fundi, paraqitja publike e veprës "Komforti termik" i akademik Fejzullah Krasniqit dhe prof. Rexhep Selimaj.

Ndryshe nga viti i kaluar, kur u paraqiten vështirësi administrative në punët botuese, sivjet mund të thuhet se kjo veprimtari është duke ecur më mirë, duke e pasuruar tashmë fondin e botimeve të Akademisë me vepra të reja dhe të rëndësishme nga fushat e ndryshme të shkencave dhe të arteve.

Përveç veprave që kanë qenë të përfshira në planin botues të vitit 2021, në planin botues kemi përfshirë edhe përmbledhjen e dokumenteve të GJND-së (Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë), dokumente që nuk janë botuar më herët në gjuhën shqipe. Besojmë se ky botim paraqitet me interes jo vetëm për specialistët e fushës, por edhe për opinionin e gjerë.

Pas kësaj periudhe të pandemisë, kam shpresë se Akademia do ta intensivikojë edhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Më lejoni që me këtë rast ta falënderoj Komisionin për Marrëdhënie Ndërkombëtare, i cili ka qenë aktiv dhe ka mbushur deri- diku vakuumin që është krijuar në komunikim ndërkombëtar, për shkak të rrethanave të pandemisë, duke iu përgjigjur ftesave të ndryshme qoftë nga ALLEA, qoftë nga akademitë evropiane, me të cilat Akademia jonë ka bashkëpunim të rregullt.

Në anë tjetër, më duhet të them se kemi bërë përpjekje, përmes anëtarit të jashtëm të Akademisë sonë nga Akademia e Maqedonisë së Veriut, të rifillojmë bashkëpunimin me këtë akademi, por deri më tani, ndoshta për shkak të ndërrimit të udhëheqjes së atjeshme, ende nuk kemi gjetur mirëkuptim për t'i rivendosur këto

marrëdhënie në binarë normalë.

Me Akademinë e Shqipërisë puna kryesore është përqendruar në përgatitjen e Konferencës së Albanologjisë, e cila, ashtu siç është paraparë me protokollin e bashkëpunimit, do të mbahet në fund të nëntorit të këtij viti, në bashkorganizim të dy akademive dhe me një pjesëmarrje të gjerë të studiuesve të të gjitha fushave të studimeve albanologjike.

Ndërkohë, për projektin e Enciklopedisë shqiptare, siç e dini, është konstituuar grupi i punës, në përbërjen e të cilit janë përfshirë përfaqësuesit e të gjithë seksioneve. Ky grup i punës e ka hartuar një propozim-platformë, e cila është finalizuar, por me pak vonesë për t'u përfshirë në materialet e kësaj mbledhjeje të Kuvendit. Në procedurën e mëtejshme, pas shqyrtimit fillestar të bërë në Kryesi, do të kalojë për shqyrtim nëpër seksione, t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe më pas të harmonizohet edhe me platformën e korrigjuar dhe të ndryshuar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ajo nuk do të bëhet dokument i Akademisë, pa marrë miratimin e këtij Kuvendi, ashtu siç jemi marrë vesh në mbledhjen e kaluar.

Në fund, më lejoni t'i theksoj edhe dy gjëra: për vitin e ardhshëm kemi një zvogëlim të buxhetit për 58 mijë euro në krahasim me këtë vit, prandaj programi i punës së Akademisë për vitin 2021 duhet të harmonizohet me këtë mundësi buxhetore, duke u përpjekur që disa veprimtari themelore të Akademisë të mos cenohen në asnjë mënyrë.

E fundit: raporti i auditorit për vitin 2020, ashtu si edhe ai për vitin 2019,

nuk ka asnjë gjetje dhe asnjë rekomandim.

Ju faleminderit!"

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës diskutuan M. Dushi dhe R. Ismajli.

M. Dushi në diskutimin e tij tha se procesverbal i është përmbajtësor dhe pasqyron deri diku diskutimin e tij në mbledhjen e fundit. Ai po ashtu e lavdëroi punën e udhëheqjes së Akademisë dhe të Administratës së saj, në rrethana të rënda pandemike. Sa i përket pjesës për zgjedhjet e fundit në Akademi ai tha se nuk është paraqitur në procesverbal i gjithë diskutimi i tij. Ai në vazhdim tha se nuk e mohon që zgjedhjet kanë kaluar mirë dhe sipas procedurave përkatëse, por se theksi i diskutimit të tij ka qenë çështja e kriterëve. Sipas tij në Seksionin e Shkencave Shoqërore janë shkëlur kriteret, sepse anëtar i Akademisë nuk mund të zgjidhet personi që nuk e ka arritur gradën shkencore më të lartë në institucionin prej nga ka ardhur propozimi (UP apo institutet).

Lidhur me këtë reagoi Kryetari Kraja, i cili tha se Ligji dhe Statuti i Akademisë nuk përcaktojnë kriteret tilla dhe e përsëriti edhe një herë se procedura e zgjedhjeve është zhvilluar në përputhje me aktet normative të Akademisë.

R. Ismajli në diskutimin e tij tha se në procesverbal ka një shënim për QLE-në.

Ai tha se ka elaborat për QLE-në, ka rregullore, por ajo duhet të rishikohet dhe të vazhdojnë procedurat e funksionalizimit të saj.

Kryetari Kraja tha se Kryesia ka marrë vendim për riangazhimin e punonjësit në QLE, për vazhdimin e punëve të projektit "Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX", i cili ka filluar punën

në muajin prill të këtij viti. Ai tha po ashtu se, Qendra mund të punojë vetëm kur ka projekte konkrete.

Pas diskutimeve Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes CIII, pa ndryshime.

Më pas Kuvendi filloi shqyrtimin e Programit të punës për vitin 2022 me rend sipas seksioneve. Kryetari Kraja tha se sekretarët e seksioneve mund të japin sqarime nëse kërkohet. Gjatë shqyrtimit të programit të punës së SGJL- së, E. Basha tha se nuk ka asgjë për të shtuar, por se është i gatshëm të ofrojë sqarime nëse kërkohet.

H. Islami në diskutimin e tij tha se vitin që shkoi kishte ngecje në realizimin e botimeve. Pavarësisht nga situata pandemike disa punë kanë mundur të shtyhen, por ka munguar angazhimi i Komisionit të vlerësimit për shtypjen e botimeve.

Sa i përket programit të SGJL- së ai tha se marrë në përgjithësi programi është i pasur, ka propozime të mira e sidomos propozimi për projektin Historia e letërsisë shqipe, është shumë i rëndësishëm dhe duhet të përkrahet, por paraqiti vërejtje për dy pika të propozuara: dorëshkrimin të Skënder Gashit, duke thënë se ASHAK- u ka botuar disa herë libra të autorit në fjalë e meqë tani ai nuk jeton më, ky propozim nuk do të duhej të përfshihej në program dhe propozimi i Kujtim Shalës për të cilin tha se çdo vjet boton nga një libër. Ky oportunitizëm, siç tha ai, duhet të ndalet nga Seksioni.

Lidhur me programin e punës së SSHN- së, H. Islami tha se është i varfër, nuk ka asgjë, vetëm bartje nga vitit paraprak. Në këtë Seksion ai tha se ka dukuri të nepotizmit, sepse në projekte përshihen familjarë të autorëve apo bartësve të projekteve. Lidhur me këtë

ai shtroi dy pyetje për Kryesinë e Akademisë:

1. A është e vërtetë se Kryesia ka marrë vendim t'u paguhen shpenzimet e publikimeve në revista shkencore familjarëve të anëtarëve të Akademisë? dhe

2. A është e vërtetë se sekretarja shkencore e Akademisë e dërgon vajzën e saj ta përfaqësojë Akademinë në konferenca ndërkombëtare me kompensim?

Lidhur me vërejtjet e H. Islamit për SGJL- në, Kryetari Kraja tha se dorëshkrimi i Skënder Gashit është diskutuar disa herë dhe meqë recensentët kanë dhënë vlerësim pozitiv është vendosur të përfshihet në program, ndërsa sa i përket asaj që një autor boton çdo vit radhazi, kjo dukuri nuk është vetëm në SGJL, por ka edhe në seksionet e tjera autorë që botojnë vit pas viti radhazi. Edhe E. Basha për botimin e Skënder Gashit e pohoi arsyetimin e Kryetarit Kraja.

Lidhur me pyetjen e parë të H. Islamit, Kryetari Kraja tha se përgjigjet do t'i paraqesë Sekretari i SSHN- së.

Pas këtyre diskutimeve u miratua programi i punës së SGJL- së, pa ndryshime dhe u shqyrtua programi i punës së SSHSH- së. J. SH. Pula paraqiti në pika të shkurtra arsyetimet për pikat e propozuara dhe programi i punës së SSHSH- së, u miratua po ashtu pa ndryshime.

Gjatë shqyrtimit të programit të punës së SSHN- së, F. Podvorica tha se si Seksion jemi munduar t'i respektojmë masat për parandalimin e pandemisë Covid- 19 dhe me qëllim të kujdesit ndaj shëndetit të të gjithëve i kemi ndërprerë shumë punë dhe aktivitete. Ai tha se nuk ka këtë vit propozime për

botime, sepse autorët nuk kanë arritur t'i dorëzojnë dorëshkrimet e gatshme ashtu siç kërkohet me rregullore. Sa i përket botimit të dy anëtarëve tanë në revista ndërkombëtare me qasje të lirë, kjo është shumë e rëndësishme për ne. Lidhur me pagesat e projektit të M. Limanit, ai tha se të gjitha pagesat janë realizuar ashtu siç janë paraqitur në arsyetimin e projektit, i cili është miratuar në Seksion, Kryesi dhe Kuvend.

Pas diskutimeve u miratua edhe Programi i punës së SSHN-së pa ndryshime.

Në fund, u miratua edhe Programi i punës i Seksionit të Arteve.

Programi i punës së ASHAK- ut për vitin 2022 do të botohet në Vjetarin 2021.

Pas miratimit të Programit të punës diskutoi S. Hamiti. Ai paraqiti vërejtje për formën e hartimit të programeve dhe propozoi që në të ardhmen të koordinohen seksionet, ashtu që bëhet një standard i programit të punës për të gjitha seksionet. Ai më pas tha se seksionet kanë paraqitur projekte afatmesme dhe afatgjate dhe këto projekte kanë shpenzime financiare, prandaj duhet të punojmë që të bëjmë planifikim të mirë për realizimin e tyre.

Në fund S. Hamiti foli edhe për projektin: "Historia e letërsisë shqipe" duke thënë se realizimi i tij kërkon mjete financiare të konsiderueshme dhe njoftimi se vitin vijues ka shkurtime buxhetore është paksa shqetësues.

Kryetari Kraja tha se pavarësisht nga shkurtime buxhetore do të bëjmë përpjekje që ky projekt i rëndësishëm së veçantë të realizohet sipas planit.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kuvendi e shqyrtoi Planin strategjik gjithëpërfshirës të

Akademisë, 2022- 2025. Me kërkesë të Kryetarit Kraja, M. Limani, kryesuese e grupit punues për hartimin e Planit strategjik gjithëpërfshirës e njoftoi Kuvendin me rrjedhën e punës. Ajo tha se grupi punues e ka hartuar draftin e Planit strategjik gjithëpërfshirës dhe më pas atë ua ka dërguar të gjithë anëtarëve të Akademisë duke ua lënë në dispozicion për rreth 15 ditë për të paraqitur vërejtje e propozime. Nga të gjithë anëtarët e Akademisë propozime me shkrim kanë paraqitur M. Dushi dhe H. Islami dhe një propozim është paraqitur nga Seksioni i Shkencave të Natyrës. Të gjitha këto propozime grupi punues i ka miratuar dhe i ka përfshirë në draftin që sot e kemi përpara për shqyrtim.

Në diskutimet e tyre S. Hamiti dhe R. Ismajli, paraqitën disa vërejtje dhe propozuan që të bëhen përmirësime dhe kësaj radhe të mos miratohet Plani strategjik. Diskutoi edhe M. Dushi, i cili tha se Plani strategjik është përmbajtësor, por se tek objektivat duhet të përfshihen edhe disa kritere për polemikat shkencore.

Pas diskutimeve Kryetari Kraja tha se hartimi i Planit strategjik është kërkesë ligjore dhe si institucion duhet ta kemi, por meqë ka vërejtje, ai propozoi që drafti në fjalë t'u lihet edhe për një kohë në dispozicion të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe të miratohet në një mbledhje tjetër të Kuvendit.

III. Mbledhja e tretë (CV) e Kuvendit ishte mbledhje zgjedhore për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë.

Para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës Kryetari Kraja njoftoi se përveç akademik Rexhep Qosjes, i cili nuk përfshihet në kuorum, mungon edhe anëtar korrespondent Xhevdet

Xhafa, i cili ka njoftuar me kohë, se për arsye shëndetësore gjendet jashtë vendit dhe nuk mund të jetë prezent.

Ai propozoi që Kuvendi të marrë vendim për mospërfshirjen në kuorum të Xh. Xhafës dhe kërkoi nga Sekretarja e Akademisë ta paraqesë bazën ligjore.

L. Pula e njoftoi Kuvendin se Statuti i Akademisë, neni 29, paragrafi 14, përcakton se: "Kuvendi në mbledhjen përkatëse mund të vendosë që në kuorum të mos përfshihen anëtarët, të cilët për shkak të sëmundjes së gjatë ose për ndonjë arsye tjetër, janë të penguar të marrin pjesë në punën e Akademisë".

Kuvendi e miratoi propozimin e Kryetarit dhe vendosi që përveç R. Qosjes edhe XH. Xhafa të mos përfshihet në kuorum.

Më pas L. Pula me kërkesë të Kryetarit Kraja njoftoi se në sallë janë të pranishëm 37 anëtarë të Akademisë nga 39 sa janë gjithsej. Pas vendimit të Kuvendit që në këtë mbledhje të mos përfshihen në kuorum dy anëtarë të Akademisë, konstatohet se kuorumi për sot është 19, pra për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor të Akademisë konsiderohet i zgjedhur kandidati që fiton 19 vota. Nëse për funksionin e caktuar asnjëri nga kandidatët nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave (19), votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave, ose për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.

Pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse Kuvendi caktoi Komisionin e zgjedhjeve me këtë përbërje: Eqrem Basha, Myzafere Limani dhe Arsim Bajrami.

Më pas u shpërndanë fletëvotimet për Kryetar të Akademisë.

Pas votimit me vota të fshehta,

Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë: votuan 37 anëtarë të ASHAK- ut. U gjetën 29 fletëvotime të vlefshme dhe 8 fletëvotime të pavlefshme.

Akademik Mehmet Kraja mori 29 vota dhe u zgjodh Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Në vazhdim u shpërndanë fletëvotimet për Nënkyetar të Akademisë.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Nënkyetarit të Akademisë: votuan 37 anëtarë të ASHAK- ut. U gjetën 31 fletëvotime të vlefshme dhe 6 fletëvotime të pavlefshme.

Akademike Justina Sh. Pula mori 31 vota dhe u zgjodh Nënkyetare e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Sipas radhës u shpërndanë fletëvotimet për Sekretar shkencor të Akademisë.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të Akademisë: votuan 37 anëtarë të ASHAK- ut. U gjetën 35 fletëvotime të vlefshme dhe 2 fletëvotime të pavlefshme.

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi mori 19 vota.

Anëtar korrespondent Bardh Rugova mori 16 vota.

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi u zgjodh Sekretar shkencor i Akademisë

së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Kuvendi më pas me ngritje të dorës miratoi në parim unanimisht zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve:

1. Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.
2. Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.
3. Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës.

Para miratimit të caktimit të Rauf Dhomit si ushtrues i detyrës së sekretarit të seksionit të Arteve diskutoi H. Islami.

Ai tha se zgjedhja e Rauf Dhomit U. D. Sekretar është në kundërshtim me Statutin e Akademisë dhe se Kuvendi nuk duhet ta miratojë. Ai tha se Kryesia nuk është dashur të caktojë grup punues, sepse nuk ka qenë asnjëherë praktikë në Akademi një gjë e tillë. Këtë çështje ka mundur ta rregullojë Sekretarja e Akademisë. Edhe në të kaluarën Akademia ka pasur jurist si psh. Esat Stavileci, por i cili nuk është përfshirë në raste të tilla, me arsyetimin se çështje të tilla i përkasin Sekretarit të Akademisë. Seksioni i Arteve ka mundur të bëjë zgjidhje më efikase, ashtu që më mirë të caktohej U. D. Sekretari i deritanishëm edhe për një mandat sesa të caktohet një anëtar që i ka kaluar 75 vjet. Ne kemi pasur rast të njëjtë me kryetarin Daci, por e kemi respektuar Ligjin dhe Statutin dhe atij i është ndërprerë mandati.

Kryetari Kraja njoftoi se Kryesia e Akademisë duke marrë parasysh që asnjëri nga anëtarët e Seksionit të Arteve nuk i plotëson kushtet ligjore për t'u zgjedhur Sekretar dhe duke konsideruar që duhet të gjendet një

zgjidhje që Seksioni të mos mbetet pa udhëheqje, ka ngritur një grup punues prej tre juristëve (L. Pula, A. Bajrami dhe Gj. Mushkolaj) për të paraqitur një zgjidhje për këtë çështje. Grupi punues e ka hartuar një propozim të cilin e ka miratuar Kryesia e Akademisë. Ai më pas kërkoi nga L. Pula të njoftojë për rrjedhën e procesit.

L. Pula tha se në bazë të propozimit të grupit punues të miratuar nga Kryesia e Akademisë, Seksioni i Arteve në mbledhje të rregullt me vota të fshehta e ka caktuar R. Dhomin U. D. Sekretar të Seksionit për periudhën katërvjeçare.

Caktimi i u. d. Sekretarit të Seksionit është bërë në bazë të Statutit të Akademisë, neni 14, paragrafi 3, që precizon se:

“3. Në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit të seksionit, seksioni me vendim të veçantë cakton një anëtar të tij ushtrues detyre të Sekretarit të seksionit”.

Gj. Mushkolaj në diskutimin e saj tha se grupi punues ka bërë propozim që Seksioni të caktojë ushtruesin e detyrës së Sekretarit të Seksionit, por ky grup nuk ka pasur informacione të mjaftueshme dhe nuk ka qenë në dijeni se kjo do t'i paraqitet Kuvendit për votim. Meqë tani Kryetari kërkoi që të bëhet edhe miratimi i caktimit të U. D të SA, ajo tha se kjo çështje nuk mund të shtrohet për votim në Kuvend, sepse për U. D. nuk votohet.

R. Ismaji dhe S. Hamiti në diskutimet e tyre thanë se letra dhe propozime të tilla nuk mund t'i servohen Kuvendit për votim, me këto çështje le të merret Kryesia e Akademisë, ashtu siç edhe ka caktuar grup punues për punë të tilla. Ata theksuan edhe një herë se Kuvendi i Akademisë nuk duhet të merret me

çështje të tilla. Që të dytë po ashtu rikujtuan ndërprerjen e mandatit të Kryetarit Daci, për shkak të kufirit të moshës. A. Bajrami tha se një situatë e tillë nuk është e lehtë, por duhet të bëhet një zgjidhje dhe si grup kemi bërë një propozim duke menduar se Seksioni do ta caktojë U. D. Luan Mulliqin dhe se kjo çështje do të zgjidhet më lehtë, por Seksioni i Arteve ka vendosur ndryshe.

Pas diskutimeve Kryetari Kraja konstatoi se caktimi i R. Dhomit, ushtrues i detyrës së Sekretarit të Seksionit të Arteve për periudhën 4-vjeçare nuk u miratua. Ai më pas, bazuar në diskutimet e Kuvendit, propozoi që R. Dhomi të caktohet U. D. për periudhën 6 mujore, ndërsa deri në zgjedhjen e Kryesisë së radhës, Seksioni i Arteve çdo 6 muaj të caktojë me vendim ushtruesin e detyrës së Sekretarit të Seksionit dhe me atë vendim të njoftohet çdoherë Kryesia e Akademisë. Propozimi u miratua.

KRYESIA

Me iniciativën e Kryesisë së Akademisë janë botuar:

1. Platformë për Rimëkëmbjen e Arsimit në Kosovë.
2. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për Kosovën (mendim këshillimor 22 korrik 2010).

Kryesia e Akademisë gjatë vitit 2021 ka mbajtur 24 mbledhje (XLIX- LXXII) në të cilat është marrë me shqyrtimin e shumë çështjeve, duke u bazuar në kompetencat e parapara me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë.

I. Kryesia në mbledhjen e parë të vitit 2021, XLIX mbajtur më 11 janar pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes paraprake diskutoi për caktimin e zyrave për anëtarët e Akademisë pas zgjedhjeve të fundit. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe pas diskutimeve u vendos të fillojnë procedurat për ndarjen e zyrave: nr. 302(303), 304 (305), 312 (313), 310(311) dhe 314 (315). Kjo për arsye se nuk ka vend të mjaftueshëm për të gjithë anëtarët e Akademisë dhe se zyrat e lartpërmendura janë relativisht të mëdha që mund të ndahen e të funksionalizohen për dy deri në tre veta.

Mbledhjet e seksioneve pas ndarjeve të zyrave do të mbahen në sallën - 1, apo edhe në sallën e Kryesisë së Akademisë.

Më pas Kryesia vendosi për caktimin e zyrave për disa anëtarë të Akademisë, si në vijim:

- Akademik Kujtim Shala vendoset në zyrën nr. 308;
- Akademik Muhamedin Kullashi vendoset në zyrën nr. 218;
- Anëtar korrespondent Besnik Krasniqi vendoset në zyrën nr. 310 (311);
- Anëtar korrespondent Nysret Krasniqi vendoset në zyrën nr. 310 (311);
- Anëtar korrespondent Shkumbin Munishi vendoset në zyrën nr. 310 (311);
- Punonjësi z. Xhemshit Brajshori e liron zyrën nr. 308 dhe vendoset në katin IV, në zyrën nr. 401.

Kryesia njëherësh e caktoi Komisionin për evidencimin e gjendjes në zyrën e akademikut të ndërjës Ekrem Murtezai, në përbërje prej: Justina SH. Pula, Lendita Pula dhe Ali Caka.

Në vazhdim u vendos që më 27 janar të mbahet ceremonia e ndarjes së fletëdëshmive për anëtarët e zgjedhur të Akademisë.

Në kuadër të pikës katër të rendit të ditës u diskutua çështja e faqesueb të ASHAK- ut. Kryetari Kraja tha se M. Limani e ka paraqitur një propozim dhe kërkoi nga ajo të njoftojë më gjerësisht Kryesinë. M. Limani tha se faqjaueb e ASHAK- ut duhet të ridizajnohet. Ajo propozoi të përcaktohen specifikat dhe të fillojë procedura e tenderimit për një dizajn të ri të faqesueb. Në diskutimet e tyre J. Pula dhe E. Basha thanë se do të ishte mirë që faqjaueb të ridizajnohet, por problemin e faqesueb e shohin më shumë në plotësimin, përditësimin dhe pasurimin e saj. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe u tha se disa herë është diskutuar kjo çështje dhe është thënë që sekretarët e seksioneve të angazhohen në pasurimin dhe përditësimin e faqesueb secili për seksionin e vet, por kjo nuk ka funksionuar. M. Limani më pas tha se është e gatshme të marrë përsipër të mbledhë shënimet nga sekretarët e seksioneve dhe t'ia përcjellë ato të gatshme për publikim administratës së ASHAK- ut, përkatësisht DPPTIK- ut. Propozimi u miratua.

Kryesia më pas diskutoi çështjen e disa dorëshkrimeve të fundit të Akademisë. Kryetari Kraja tha se dorëshkrimet që dorëzohen duhet të jenë në përputhje me programin e punës, pra të dorëzohen me numër të tabakëve që janë prezantuar në program. Mund të ketë ndonjë lëvizje të vogël 3- 4 tabakë plus- minus, por jo nga 45 tabakë të propozuar të dorëzohen 65 tabakë, sa edhe një tjetër dorëshkrim. Këto gjëra duhet të kontrollohen, sepse paraqesin

probleme edhe në planifikimin buxhetor. Kjo çështje u përket sekretarëve të seksioneve, që janë edhe redaktorë të botimeve për seksionet e tyre. Ata në momentin që e pranojnë dorëshkrimin duhet ta vërtetojnë se a është në përputhje me programin e punës. Nëse ka ndryshime të mëdha çështja duhet t'i dërgohet për shqyrtim Këshillit botues dhe më pas për miratim Kryesisë së Akademisë. Në diskutimet e tyre L. Mulliqi dhe F. Podvorica thanë se kjo çështje nuk do të bëhet problem sikur të respektohet Rregullorja për veprimtari botuese, e cila e qartëson se asnjë dorëshkrim nuk hyn në program të punës pa qenë i gatshëm. L. Mulliqi po ashtu insistoi që të respektohet Rregullorja, të mos përfshihen në program të punës dorëshkrimet që nuk janë të gatshme dhe formularët e veprimtarisë botuese të plotësohen me kohë sipas renditjes, sepse nëse të gjithë i plotësojnë formularët me kohë nuk do të ndodhin lëshimet.

Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe pas diskutimeve u tha se tri dorëshkrimet (A. Bajrami, H. Islami dhe A. K. Berishaj) që tani më janë dorëzuar, të përgatiten për shtyp në formatin që janë dorëzuar nga autorët. Në kuadër të pikë së fundit të rendit të ditës Kryesia:

- Diskutoi për mbajtjen e mbledhjeve të seksioneve për shqyrtimin e raportit të punës për vitin 2020. U tha që mbledhjet të mbahen më së largu deri javën e parë të muajit shkurt.

- Diskutoi për çështjen e mirëmbajtjes së pastërtisë në objektin e ASHAK- ut. U tha se me gjithë kërkesat e vazhdueshme drejtuar MAP- it, pastrimi i objektit nga ana e tyre nuk po funksionon si duhet. Ka zyrë që nuk

pastrohen për kohë të gjatë, sepse i tërë objekti mbahet vetëm me dy veta. Kryesia vendosi të sigurohet pastrimi shtesë në objektin e ASHAK- ut, duke e angazhuar një punonjës që do të pastrojë çdo të shtune. Punonjësit t'i bëhet kompensimi mujor në vlerë prej 100. 00 euro bruto dhe zyrtari i logjistikës i ASHAK- ut të bëjë mbikëqyrjen e tij. U diskutua po ashtu edhe mungesa e pastrimit nëpër zyra. U tha që të shikohet mundësia që të ketë edhe nëpër zyra pastrim shtesë.

II. Në mbledhjen L mbajtur më 8 shkurt, Kryesia e shqyrtoi raportin e punës së ASHAK- ut për vitin 2020 duke filluar me radhë nga Kuvendi, Kryesia, seksionet e deri te Shërbimi profesional, administrativ e teknik. Kryetari Kraja në diskutimin e tij edhe kësaj radhe e shtroi çështjen e njoftimit të anëtarëve të Akademisë me vendimet e Kryesisë. E. Basha tha se kohë më parë kur e kemi diskutuar këtë çështje kemi rënë dakord që secili sekretar ta njoftojë Seksionin e tij me vendimet e Kryesisë, meqë raporti vjetor i punës i paraqet në detaje të gjitha procesverbalet e Kryesisë. Ai në vazhdim propozoi që të krijohet një version i raportit vjetor që i përmbledh në një tërësi të gjitha aktivitetet e Kryesisë, pa hyrë në detaje duke paraqitur procesverbalin në tërësi. Me propozimin u pajtua edhe Kryetari, por u tha që kjo çështje të mendohet për vitet në vazhdim, ndërsa tha që sekretarët e seksioneve të vazhdojnë të njoftojnë seksionet rregullisht me vendimet e Kryesisë.

Raporti i punës së ASHAK- ut për vitin 2020 u miratua njëzëri.

Më pas u shqyrtua edhe raporti financiar i ASHAK- ut për vitin 2020. L.

Pula me kërkesë të Kryetarit e njoftoi Kryesinë me rrjedhën e shpenzimit të buxhetit për vitin 2020 dhe me ndryshimet që janë bërë kohë pas kohe nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës. Ajo tha se, marrë parasysh gjendjen e krijuar nga pandemia Covid-19, buxheti është realizuar në shkallë të mirë, me suficit në vlerë prej 22,903. 12€, që i bie se 98,17% e buxhetit është shpenzuar me kohë.

Kryesia e miratoi edhe raportin financiar për vitin 2020.

Në kuadër të pikës së radhës të rendit të ditës Kryetari Kraja fillimisht e njoftoi Kryesinë se pas vizitës së kryetarit të ASHSH- së, Skënder Gjinushi dhe pas bisedave lidhur me bashkëpunimin për projektet e përbashkëta e ka hartuar një informatë për anëtarët e Akademisë dhe propozon që në mbledhjen e Kuvendit të shqyrtohet dhe të miratohet projekt- ideja për hartimin e platformave për Enciklopedinë shqiptare, Fjalorin e madh të gjuhës shqipe dhe Kuvendin e studimeve albanologjike. Njëherësh në këtë informatë ai tha se i ka paraqitur edhe propozimet për caktimin e anëtarëve të grupeve punuese për hartimin e platformave në fjalë.

Kryesia u pajtua me propozimet e Kryetarit dhe vendosi të thërrasë mbledhjen CIII të Kuvendit të Akademisë, më 24 shkurt 2021, ora 11:00, me këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CII të Kuvendit të Akademisë; Miratimi i Raportit të punës së Akademisë për vitin 2020; Miratimi i Raportit financiar të Akademisë për vitin 2020; Shqyrtimi dhe miratimi i projekt- idesë dhe propozimi i anëtarëve të grupeve punuese për hartimin e platformave për Enciklopedinë shqiptare, Fjalorin e

madh të gjuhës shqipe dhe Kuvendin e studimeve albanologjike dhe çështje vijuese.

Në vazhdim u miratua raporti i projektit: “Hulumtim mbi mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezeve të reja frekuencore UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela në territorin e Kosovës” të udhëhequr nga prof. Myzafere Limani dhe u mor vendim për realizimin e pagesave për personat e angazhuar në projekt.

Kryesia në kuadër të kësaj mbledhjeje caktoi Grupin punues për hartimin e planit strategjik gjithëpërfshirës dhe për hartimin e planit të menaxhimit të rrezikut, me këtë përbërje:

1. Anëtare korrespondente Myzafere Limani, kryetare;
2. Akademike Justina Pula, anëtare;
3. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, anëtar;
4. Anëtar korrespondent Bardh Rugova, anëtar;
5. Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, anëtar;
6. Lendita Pula, sekretare e Akademisë, anëtare;
7. Një anëtar nga SHPAT-i për mbështetje teknike.

Më pas u diskutua për rrjedhën e çështjeve që kanë të bëjnë me financa, përkatësisht shpërndarjen e mjeteve buxhetore sipas planifikimit. Me kërkesë të Kryetarit Kraja, L. Pula e njoftoi Kryesinë se gjatë vitit 2020 për shkak të rrethanave pandemike që rezultuan në pezullimin dhe shtyrjen e aktiviteteve, si dhe vonesën e shtypjes së librave, rrjedha e shpërndarjes së mjeteve buxhetore ka pësuar

ndryshime. Janë paguar honorarët e autorëve me vendime të Kryesisë, një pjesë e tyre nga mjetet buxhetore të kategorisë së shtypjes së botimeve. Po ashtu ka pasur edhe lëvizje të tjera. Kjo situatë mund të paraqitet edhe këtë vit. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe të gjithë u pajtuan që shpenzimi i mjeteve buxhetore të realizohet sipas nevojave të ASHAK- ut.

Në kuadër të pikës së fundit të kësaj mbledhjeje Kryesia:

- Vendosi të rregullohet vetura Peugeot e ASHAK- ut, në njërin nga serviset e autorizuar që ofron çmimin më të ulët.

- Vendosi të fillojnë procedurat për blerjen e kompjuterëve sipas planifikimit për vitin 2021. Janë planifikuar 4,000. 00€ me të cilat mund të blihen 8 kompjuterë. U propozuan edhe anëtarët e Komisionit të vlerësimit: Eqrem Basha dhe M. Limani, ndërsa anëtari i tretë u tha të caktohet nga administrata.

III. Në mbledhjen LI të mbajtur më 26 shkurt, Kryesia:

- U njoftua nga Kryetari se kanë dalë nga shtypi botimet e fundit të ASHAK- ut. Ai tha se të gjitha duhet të promovohen dhe kërkoi nga sekretarët e seksioneve ta propozojnë orarin e promovimeve të botimeve, secili për seksionin e tij. U tha që ditëve në vijim të caktohen datat dhe më pas të bëhen përgatitjet e nevojshme.

Sa i përket shtypjes së librave M.

Limani tha se për shkak të vonesave që ndodhën dhe për të mos pasur ngecje i ka aprovuar të gjitha dorëshkrimet për shtyp në formë elektronike, por ajo kërkoi që sekretarët e seksioneve të plotësojnë dokumentacionin edhe në

kopje letër, ashtu që ajo më pas t'i nënshkruajë të gjitha.

Njëherësh u diskutua edhe çështja e botimit të dorëshkrimeve të vitit 2021. U tha se tenderi të shpallet për të gjitha dorëshkrimet dhe më pas ato të shkojnë në shtyp sipas radhës.

Në kuadër të po kësaj pike të rendit L. Pula e njoftoi Kryesinë se për bartjen e librave ka nevojë kohë pas kohe të angazhohet një punëtor me mëditje ditore. Kryesia u pajtua dhe u tha që të vazhdojë puna.

- Diskutoi për projektet me ASHSH- në: për Enciklopedinë shqiptare, Fjalorin e madh të gjuhës shqipe dhe Kuvendin e studimeve albanologjike. Kryetari Kraja tha se sipas vendimit të Kuvendit çështja e projekteve të lartpërmendura do të diskutohet edhe një herë sot në Kryesi dhe më pas në seksione. Ai e përsëriti edhe një herë se qëndrimi i tij është që dy akademitë patjetër duhet të punojnë në këto projekte. Në vazhdim Kyetari tha se e ka përgatitur një shkresë e cila do t'u dërgohet seksioneve. Gjatë javës që vjen të gjitha seksionet do të mbajnë mbledhjet e tyre dhe do të caktojnë nga një përfaqësues që do të jetë pjesë e grupit punues për hartimin e platformës për Enciklopedinë shqiptare. Grupi i ASHAK- ut do të përbëhet nga katër përfaqësues të seksioneve dhe Kryetari i Akademisë.

Për dy projektet e tjera: Fjalorin e madh të gjuhës shqipe dhe Kuvendin e studimeve albanologjike, propozimet do t'i paraqesë Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë. J. Bajraktari tha se e përkrah plotësisht nismën për hartimin e projekteve të lartpërmendura dhe se pavarësisht nga dallimet që kanë

ekzistuar në të kaluarën, tani është koha të përqafohet ideja dhe të vazhdohet me punë.

M. Limani tha se edhe në Seksionin e Shkencave të Natyrës është përkrahur nisma për hartimin e projekteve në fjalë, me theks që platformat të hartohen duke marrë për bazë të gjitha kërkesat e ASHAK- ut. M. Kraja sqaroi se do të ketë dy redaksi dhe se e gjitha do të jetë baras.

L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se diskutimet që u bënë në Kuvendin e fundit të Akademisë i vlerëson si mjaft pozitive, meqë tani rruga për hartimin e Enciklopedisë shqiptare është hapur dhe nuk mund të ketë kthim pas. Ai tha se e përkrah këtë nismë dhe mendon se duhet të fillohet me punë sa më parë. L. Mulliqi po ashtu propozoi që të funksionalizohet QLE- ja ashtu që projektet të realizohen në kuadër të saj. Pas diskutimeve Kryetari Kraja tha se hapi i parë është caktimi i grupeve punuese. Më pas grupet punuese do të hartojnë platformat, të cilat do t'i dërgohen për miratim Kuvendit të Akademisë dhe pas miratimit projektet do të përfshihen në Programin e punës të Akademisë.

- U njoftua nga L. Pula se blerja e kompjuterëve ka dështuar, meqë çmimi i ofruar është i lartë dhe nuk mund të mbulohet me mjetet që janë në dispozicion. M. Limani ofroi sqarimet e nevojshme dhe propozoi të nisen procedurat për blerjen e një modeli tjetër të kompjuterëve me çmim më të ulët dhe që i plotësojnë kërkesat e ASHAK- ut. Propozimi u miratua.

- Diskutoi për funksionalizimin e Qendrës Leksikografike Enciklopedike të ASHAK- ut. U dhanë propozime e sugjerime dhe u tha që Seksioni i

Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK- ut, të paraqesë një koncept të punës që do të shqyrtohet më pas në Kryesi dhe në Kuvendin e Akademisë.

IV. Në mbledhjen LII të datës 5 mars, si zakonisht pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, sipas radhës u shqyrtuan pikat e rendit të ditës. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se janë mbajtur mbledhjet e seksioneve dhe të gjitha seksionet i kanë propozuar përfaqësuesit e tyre për pjesëmarrje në grupet punuese për hartimin e platformave të projekteve: Enciklopedia shqiptare, Fjalori i madh i gjuhës shqipe dhe Kuvendi i studimeve albanologjike.

Kryesia u pajtua njëzëri me propozimet e seksioneve dhe vendosi si në vijim:

I. Caktohet Grupi punues për hartimin e platformës për projektin Enciklopedia shqiptare (pjesa përfaqësuese e ASHAK-ut) me këtë përbërje:

1. Akademik Mehmet Kraja, koordinator
2. Akademik Sabri Hamiti
3. Akademik Anton K. Berishaj
4. Akademik Nexhat Daci
5. Akademik Rauf Dhomi

II. Caktohet Grupi punues për hartimin e platformës për projektin Fjalori i madh i gjuhës shqipe (pjesa përfaqësuese e ASHAK- ut) me këtë përbërje:

1. Akademik Rexhep Ismajli, koordinator
2. Anëtar korrespondent Bardh Rugova
3. Anëtar korrespondent Shkumbin Munishi

III. Caktohet Grupi punues për hartimin

e platformës për projektin Kuvendi i studimeve albanologjike (pjesa përfaqësuese e ASHAK- ut) me këtë përbërje:

1. Akademik Eqrem Basha, koordinator
2. Akademik Ali Aliu
3. Akademik Kujtim Shala
4. Lindita Rugova, dekane e Fakultetit të Filologjisë
5. Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik, Prishtinë.

Në vazhdim u diskutua për digjitalizimin e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës. Kryetari Kraja tha se kohë më parë nga DPPTIK-u e kemi marrë një shkresë me tri propozime për mënyrën e digjitalizimit të FEK-ut. Ai tha se e përkrah propozimin e dytë që digjitalizimi të bëhet me softuerë të specializuar për mirëmbajtjen, përditësimin dhe korrigjimin e zërave. Me propozimin e Kryetarit u pajtuan e dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë. Më pas u diskutua për rrjedhën e punës dhe u vendos që Këshilli redaktues i ASHAK- ut, me në krye Sekretaren shkencore të merren me çështjen në fjalë, fillimisht vetëm duke i bërë përmirësimet e domosdoshme, ndërsa në të ardhmen e afërt do të caktohet një redaksi e cila do të merret me përditësimin e FEK- ut.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

- Diskutoi për promovimin e botimeve të ASHAK- ut. U tha që sekretarët e seksioneve të caktojnë datat dhe në bashkëpunim me administratën të bëjnë përgatitjet e nevojshme. Po ashtu u tha që për secilin botim që promovohet sekretarët e seksioneve të

përgatitin njoftimin për faqenueb.

- Shqyrtoi kërkesën e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Ankara. Kërkesa u miratua. U tha që të bëhet një përzgjedhje e botimeve në koordinim me ta. Kryetari Kraja tha se dhurimi i librave të bëhet vetëm në bazë të kërkesave të cilat duhet t'i miratojë Kryesia.

- Diskutoi për plotësimin e formularëve të veprimtarisë botuese. Meqë për shkak të rrethanave pandemike miratimi i dorëshkrimeve për shtyp është bërë nga Sekretarja shkencore në formë elektronike dhe formularët nuk mund të protokollohen me datat e rregullta, Kryesia vendosi që të njëjtit të protokollohen nga ky vit sipas renditjes.

- Vendosi që në faqenueb të vendoset regjistri i të gjitha botimeve të ASHAK-ut.

V. Në mbledhjen LIII, mbajtur më 23 mars Kryesia:

- E shqyrtoi draftin e dokumentit të KASH 2022- 2024. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe u dhanë disa sugjerime shtesë. U tha që dokumenti të plotësohet me sugjerimet e paraqitura dhe të procedohet tutje.

- U njoftua nga Kryetari Kraja se gjatë kryerjes së procedurave të veprimtarisë botuese nganjëherë po paraqiten disa pengesa teknike dhe për këtë arsye ai propozoi të caktohet një grup punues që do të rishikojë Rregulloren për veprimtari botuese të ASHAK- ut dhe Rregulloren për honorarët e veprimtarinë botuese. Diskutuan edhe L. Mulliqi, M. Limani F. Podvorica dhe pas diskutimeve Kryesia vendosi të caktojë grupin punues për plotësimin e rregulloreve në fjalë, me këtë përbërje:

1. Anëtare korrespondente Myzafere Limani, kryesuese;

2. Akademik Eqrem Basha, anëtar;

3. Akademike Justina SH. Pula, anëtare;

4. Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, anëtar;

5. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, anëtar;

6. Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

- Vendosi që për të gjitha dorëshkrimet e veprave muzikore të caktohet notografi, për përshkrimin e notave muzikore. U tha se notografin e cakton Seksioni i Arteve i ASHAK- ut, ndërsa kompensimi për punën e notografit realizohet sipas Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese të ASHAK- ut.

- Vendosi t'u shpërndahen nga dy kopje të botimeve të ASHAK- ut, të gjitha institucioneve sipas Rregullores për veprimtarinë botuese, neni 23, paragrafët 1 dhe 2, përfshirë edhe universitetet lokale në Kosovë, Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" dhe bibliotekat rajonale. Po ashtu u vendos që autorëve të botimeve të Akademisë, në bazë të kërkesës me shkrim, mund t'u jepen pa kompensim botimet e saj. Zyrtari i logjistikës, obligohet që autorit të botimit t'ia paraqesë formularin përkatës për nënshkrim dhe pas pranimit të formularit të nënshkruar nga autori, zyrtari i logjistikës ia dërgon botimin përkatës autorit dhe e bën daljen e tij nga sistemi- depo.

- Vendosi të përkthehet në gjuhën shqipe dhe më pas të përgatitet për botim materiali i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me titull: Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence by the Provisional Institutions of Self- Government of Kosovo.

- E miratoi kërkesën e DPPTIK- ut për vijimin e trajnimeve. U tha që trajnimet t'i vijojnë Ali Caka, Taulant Veseli dhe Gerta Çuna, ndërsa u kërkuar që këta dy të fundit t'i nënshtrohen edhe testit për certifikim.

VI. Në mbledhjen LIV mbajtur më 2 prill Kryesia:

- Vendosi që të caktohet përkthyesi për përkthimin në gjuhën shqipe të materialit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me titull "Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence by the Provisional Institutions of Self-Government of Kosovo". Z. Sheholli pas kryerjes së punës i realizohet pagesa sipas Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese, neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1. 1.

- Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të Kryetarit të Akademisë, me anëtarët e grupit punues për Konferencën e studimeve albanologjike (Eqrem Basha, Kujtim Shala, Lindita Rugova, Hysen Matoshi) dhe Lendita Pula, për qëndrimin në Tiranë me ftesë të ASHSH- së, më 24- 26 mars 2021.

- Vendosi që Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, me kërkesë të tyre, t' u dhurohen nga një kopje e botimeve të ASHAK- ut;

- Vendosi që profesor. dr. Nebi Caka të angazhohet për vazhdimin e kryerjes së punëve në Qendrën Leksikografike Enciklopedike të ASHAK- ut, nga data 02. 04. 2021- 02. 10. 2021. U tha që Profesor Caka do të marrë përsipër të gjitha punët për realizimin e projektit "Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX".

Prof. Caka do t'ia paraqesë raportin me

shkrim çdo tre muaj Kryesisë së Akademisë. Në fund të punës, Kryesisë ia paraqet raportin përfundimtar dhe bashkë me të ia dorëzon të gjithë materialin e përpunuar, i cili është pronë e ASHAK- ut.

- Vendosi që të realizohet pagesa për notografin për përshkrimin e notave muzikore të dorëshkrimit (dy pjesë) të akademik Zeqirja Ballatës: Përgjedhje e një cikli veprash kamerale dhe Përgjedhje e një cikli veprash vokalo-instrumentale, t'i realizohet pagesa në përputhje me Rregulloren për honoraret e autorëve të veprimtarisë botuese të ASHAK- ut, neni 6.

- E shqyrtoi kërkesën e Ministres së MASHT-it, znj. Arbërie Nagavci për delegimin e përfaqësuesit të ASHAK-ut për anëtar të Komisionit për shqyrtimin e nominimeve për anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë- KSHC dhe e caktoi anëtare korrespondente Myzafere Limanin, përfaqësuese e ASHAK- ut në Komisionin e lartcekur.

VII. Në mbledhjen LV të Kryesisë, të datës 19 prill, Kryesia:

- Diskutoi për dizajnimin dhe mirëmbajtjen e faqesueb të ASHAK- ut. Kryetari Kraja njoftoi se faqja ueb është dizajnuar vite më parë dhe tani është koha të ridizajnohet dhe t'i përshtatet ndryshimeve të fushës përkatëse. Kryesia u pajtua me propozimin e Kryetarit dhe u vendos të fillojnë procedurat për ridizajnimin dhe më pas edhe mirëmbajtjen e faqesueb.

Eqrem Basha dhe M. Limani u caktuan nga Kryesia të udhëzojnë administratën, përkatësisht DPPTIK- un për përgatitjen e kërkesave dhe specifikave të nevojshme për hapjen e tenderit.

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës u diskutua edhe çështja e ridizajnit të revistave të ASHAK- ut. Diskutuan të gjithë anëtarët e pranishëm dhe u tha që gjatë muajit maj të mblidhet Këshilli botues i ASHAK- ut. Të bisedohet dhe të propozohet ridizajni i revistave e më pas kjo çështje të diskutohet nëpër seksione dhe me redaksitë e revistave.

- Propozoi Eqrem Bashën dhe M. Limanin, anëtarë për komisionin e vlerësimit të tenderit: Shërbime të shtypjes të botimeve të ASHAK- ut. Anëtari i tretë u tha se do të caktohet nga administrata.
- Diskutoi për përgatitjet për Programin e punës së ASHAK- ut për vitin 2022. U tha se gjatë muajve prill- maj të mbahen mbledhjet e seksioneve dhe më pas të vazhdojnë procedurat sipas rregullit.
- Diskutoi për promovimin e botimeve të ASHAK- ut. U tha se për shkak të masave anti covid u pezullua promovimi i botimeve të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Kryetari Kraja tha se duhet parë mundësia që të vazhdojë promovimi. Në diskutimet e tyre anëtarët e Kryesisë thanë se promovimet mund të bëhen, por duhet të zbatohen të gjitha masat anti covid.
- U njoftua nga L. Pula për disa blerje dhe riparime që duhet të bëhen, si: blerja e tepihëve jashtë dhe në hyrje të objektit, riparimi i perdeve, blerja e kutive të votimit dhe blerja e luleve në hapësirat e përbashkëta.

VIII. Në mbledhjen LVI të mbajtur më 11 maj, Kryesia:

- U njoftua nga Kryetari Kraja se Ministria e Arsimit e Shkencës e Teknologjisë dhe e Inovacionit -

MASHTI e ka bërë shpalljen publike për paraqitjen e propozimeve për Këshillin Kombëtar të Shkencës dhe ASHAK- ut i takon t'i paraqesë dhe t'i dërgojë propozimet e veta.

Diskutuan të gjithë anëtarët e Kryesisë. U tha që nga Seksioni i SHN-së të paraqiten dy propozime (meqë kërkohet për dy fusha), ndërsa nga Seksioni i GJL dhe Seksioni i SHSH-së të paraqitet nga një propozim. Pas diskutimeve u tha që secili sekretar i Seksionit të bisedojë me anëtarët e seksionit të tij ashtu që të vendoset për propozimin.

Propozimet duhet të definohen sa më parë dhe më 17 maj t'i dërgohen MASHTI- it, bashkë me dokumentacionin përkatës.

- E miratoi raportin për fazën e parë të projektit "Burimet njerëzore dhe zhvillimi i sektorit privat në Kosovë, hendeku i shkathtësive dhe kualifikimeve" dhe mori vendim të realizohen pagesat për personat e angazhuar në projekt.

IX. Në mbledhjen LVII, të datës 31 maj, Kryesia e shqyrtoi dokumentin e shpërndarjes së buxhetit për shpenzim sipas Qarkores së 1- rë buxhetore 2022-2024. L. Pula me kërkesë të Kryetarit Kraja e njoftoi Kryesinë se në vitin 2022 ka shkurtim të buxhetit të ASHAK- ut në kategorinë mallra dhe shërbime, në vlerë prej 57,140. 00 € dhe se këto mjete duhet të zbriten nga disa kategori ekonomike, sepse duhet t'u përmbahemi kufijve buxhetorë të lejuar nga MFPT.

Më pas u shqyrtuan të gjitha kategoritë ekonomike me radhë dhe u propozuan disa plotësime. U tha që pasi të përfundojnë mbledhjet e seksioneve

dhe të hartohet drafti i Programit të punës së ASHAK- ut për vitin 2022, në mbledhjen e radhës të Kryesisë të miratohet përfundimisht shpërndarja e buxhetit për shpenzim.

Në vazhdim Kryesia diskutoi për realizimin e pagesave (paushalleve) për të angazhuarit në projektet e ASHAK- ut: "Raporti për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë" dhe "Platforma për rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë". Kryetari Kraja tha se për të dy projektet është punuar shumë dhe mirë dhe propozoi të caktohen paushallet për të angazhuarit. Ai kërkoi nga J. Pula dhe F. Podvorica të paraqesin propozimet për mënyrën dhe vlerën e pagesave. J. Pula, koordinatore e Grupit punues për hartimin e Platformës për rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë tha se ajo vetë heq dorë nga pagesa, ndërsa tha se tre anëtarë të jashtëm duhet të kompensohen. F. Podvorica tha se në Grupin punues për hartimin e Raportit për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë nga Seksioni i SHN-së kanë marrë pjesë shtatë anëtarë. Ai propozoi që pagesat të realizohen vetëm për katër prej tyre që i përkasin grupit bërthamë.

Diskutoi edhe L. Mulliqi, i cili tha se pajtohet plotësisht që të angazhuarit nëpër projekte duhet të paguhet, sepse në këtë mënyrë mundësohet përfshirja e personave edhe nga jashtë Akademisë që kanë vullnet të kontribuojnë në projekte të rëndësishme.

Kryesia në kuadër të kësaj mbledhjeje mori vendim për nisjen e procedurave të tenderimit për zgjedhjen e konsulentit për hartimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse për

punonjësit e Shërbimit profesional, administrativ e teknik (SHPAT) të ASHAK- ut, sipas Ligjit të ri për zyrtarët publikë të Republikës së Kosovës dhe akteve të tjera nënligjore që dalin nga ky Ligj.

U tha që procedurat të zhvillohen sipas disponueshmërisë së mjeteve financiare.

Në fund Kryesia:

- Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të Kryetarit Kraja me bashkëpunëtorë për qëndrimin e tyre në Shqipëri me qëllim të realizimit të takimeve të rregullta me ASHSH- në, më 17- 20 maj 2021.

- Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të F. Podvoricës për qëndrimin e tij në Shqipëri, me qëllim të pjesëmarrjes në ceremoninë solemne të organizuar nga ASHSH-ja, për ndarjen e diplomave të anëtarëve të jashtëm, më 27- 28 maj 2021.

- U njoftua nga Kryetari Kraja se pas konsultave të sekretarëve të seksioneve me anëtarët e propozuar nga Kryesia në mbledhjen e datës 11 maj 2021 për Këshillin kombëtar të shkencës, Kryesia i ka dërguar propozimet në MASHTI. Nga ASHAK- u janë propozuar: akademike Edi Shukriu, anëtare korrespondente Myzafere Limani dhe anëtar korrespondent Fetah Podvorica.

- E shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës, për deklarimin e kursimeve buxhetore. U tha se për shkak të pandemisë Covid- 19 edhe këtë vit ka ngecje në realizimin e disa aktiviteteve të parapara dhe se mund të deklarohen për kursim një pjesë e mjeteve buxhetore nga kategoria subvencione dhe transfere 13,000. 00€,

nga komunalitë 2,000. 00€, si dhe 7,000. 00€ nga kategoria mallra dhe shërbime.

- Vendosi që z. Ali Caka me rastin e pensionimit t'i blehet një orë dore dhe po me këtë rast të shtrohet një drekë ku do të marrin pjesë vetëm stafi i administratës.

X. Mbledhja LVIII u mbajt më 14 qershor. Në këtë mbledhje u diskutuan një varg çështjesh:

- Kryesia e shqyrtoi dokumentin e shpërndarjes së buxhetit për shpenzim sipas Qarkores së 1- rë buxhetore 2022- 2024. Kryetari Kraja tha se në mbledhjen e kaluar është shqyrtuar dokumenti në fjalë dhe janë dhënë disa propozime për plotësim të draftit. L. Pula me kërkesë të Kryetarit e njoftoi Kryesinë se në draft janë bërë ndryshimet sipas propozimit të Kryesisë, si më poshtë:

- Nga kategoria ekonomike 13470 janë hequr mjetet në vlerë prej 1,000. 00€;

- Nga kategoria ekonomike 13501 janë hequr mjetet në vlerë prej 1,000. 00€;

- Nga kategoria ekonomike 13610 janë hequr mjetet në vlerë prej 1,000. 00€;

- Nga kategoria ekonomike 14220 janë hequr mjetet në vlerë prej 5,000. 00€;

- Të gjitha këto mjete (8,000. 00€) janë transferuar në kodin ekonomik 13440.

Ajo po ashtu njoftoi se në aktin përcjellës që do t'i dërgohet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës, do të paraqitet kërkesa për mjete shtesë në vlerë prej 57,140. 00€, aq sa mungojnë nga buxheti për vitin 2022.

Njëherësh L. Pula njoftoi se në aktin përcjellës është paraqitur edhe njoftimi për projektet me ASHSH- në, pa

përcaktuar vlerën e mjeteve financiare, meqë në këtë fazë ajo nuk mund të dihet.

Kryesia e miratoi shpërndarjen e buxhetit për shpenzim sipas Qarkores së 1- rë buxhetore 2022- 2024.

- E shqyrtoi Programin e punës së Akademisë për vitin 2022 me rend sipas seksioneve. Diskutuan me radhë anëtarët e Kryesisë. U tha që të Seksioni i Shkencave Shoqërore të plotësohet arsyetimi për konferencën shkencore ndërkombëtare: "Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale", si dhe te projekti: "Zhvillimi i aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës", të plotësohet arsyetimi me CV- të për bashkëpunëtorët jashtë vendit. L. Mulliqi propozoi që në Program të specifikohen shënimet për anën financiare të aktiviteteve, kjo për shkak të planifikimit dhe shtrirjes më të mirë të mjeteve buxhetore.

Pas diskutimeve Programi i punës së ASHAK- ut për vitin 2022 u miratua dhe u tha që do t'i dërgohet për miratim përfundimtar Kuvendit të Akademisë.

- E shqyrtoi draftin final të Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK- ut 2022- 2025. M. Limani e njoftoi Kryesinë se drafti i Planit strategjik u është ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe u është lënë në dispozicion për 10 ditë për të paraqitur vërejtjet dhe sugjerimet eventuale. Brenda këtij afati dy anëtarë të Akademisë (M. Dushi dhe H. Islami) kanë paraqitur dy propozime dhe një tjetër propozim është paraqitur nga Seksioni i Shkencave të Natyrës. Të tri propozimet janë përfshirë në draftin që sot po shqyrtohet.

Kryesia u pajtua me draftin e plotësuar dhe u tha që ky dokument do t'i dërgohet për miratim Kuvendit të

Akademisë për miratim përfundimtar.

- Vendosi të thërrasë mbledhjen CIV të Kuvendit të Akademisë, më 30 qershor 2021, ora 11:00 me këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CIII të Kuvendit të Akademisë; Miratimi i Programit të punës të Akademisë, për vitin 2022; Miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës të Akademisë, 2022-2025 dhe çështje vijuese.

- Mori vendim të paguhen paushallet për të angazhuarit në projektet e ASHAK- ut: Raporti për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë dhe Platforma për rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë.

Me gjithë insistimin e Kryesisë J. SH. Pula, koordinatorë e projektit për arsimin, u deklarua se heq dorë vullnetarisht nga pagesa që i takon.

- U njoftua nga L. Pula se procedura e pensionimit të z. Ali Caka, drejtor i DPPTIK- ut, ka përfunduar sipas rregullave ligjore. Ajo më pas tha se në vijim duhet të fillojnë procedurat e reja për plotësimin e vendit të punës së tij. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe pas diskutimeve u tha që fillimisht të hartohet Rregullorja e re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, që është kërkesë ligjore, meqë ka hyrë në fuqi Ligji i ri për zyrtarët publikë, si dhe aktet e tjera normative përcjellëse. Kryetari Kraja tha se anëtarët e Kryesisë tani më e kanë në dispozicion Rregulloren që është në fuqi, prandaj secili le ta shqyrtojë dhe në një mbledhje të radhës të Kryesisë do të merremi bashkërisht me shqyrtimin e saj.

- Vendosi që veprat muzikore të shtypen në tirazh pre100 kopje;

- E shqyrtoi kërkesën SSHN (S. Gashit)

për kompensimin e mjeteve financiare për procesimin e punimit shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare, me qasje të hapur. Revista është e indeksuar në platformat SCOPUS dhe WEB of Science.

- U njoftua nga L. Pula se DPPTIK- u ka proceduar kërkesën për blerjen e një printeri vetëm për shtypjen e CD- ve dhe një klime lëvizëse që duhet të vendoset në dhomën e serverëve. Kërkesa për printer u miratua, ndërsa sa i përket klimës u tha të hartohen fillimisht specifikat dhe më pas të merret vendimi.

XI. Në mbledhjen e Kryesisë LIX që u mbajt më 17 qershor, Kryesia:

- Vendosi të paguhet paushalli për interpretim në piano me rastin e promovimit të botimit të akademik Rauf Dhomit: “Vepra për piano” dhe paushalli për rregullimin e pianos.

- Vendosi të fillojnë procedurat për blerjen e klimës lëvizëse për dhomën e serverëve në ASHAK.

- Diskutoi për tirazhin e botimeve të ASHAK- ut dhe vendosi që:

1.Veprat muzikore të shtypen në 100 kopje;

2. Katalogët e ekspozitave të shtypen në 300 kopje;

3. Vjetari të shtypet në 100 kopje.

Tirazhi për botimet e tjera mbetet i njëjtë.

Njëherësh u tha që anëtarëve të Akademisë t’u ndahen nga 100 katalogë të ekspozitave të tyre.

- U njoftua nga L. Pula, se e ka pranuar draftin e Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020. Raporti edhe këtë vit nuk përmban asnjë

rekomandim. Kryetari Kraja propozoi që pasi të pranohet Raporti final i Auditorit, të printohet dhe t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të Akademisë.

- U njoftua nga L. Mulliqi se me rastin e ekspozitës personale të anëtarit korrespondent Xhevdet Xhafa, duhet të bëhen disa ndërhyrje nëpër mure të cilat duhet të riparohen pas ekspozitës. Kryesia u pajtua që ekspozita të përgatitet ashtu që të plotësojë nevojat e autorit, por gjithnjë në përputhje me rregullat e ASHAK- ut.

XII. Në mbledhjen LX mbajtur më 28 qershor, Kryesia e shqyrtoi Platformën për Enciklopedinë Shqiptare. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se e ka hartuar Platformën në bashkëpunim me anëtarët e Grupit punues të ASHAK- ut (N. Daci, R. Dhomi, S. Hamiti dhe A. K. Berishaj) dhe se e ka marrë miratimin e tyre që kjo Platformë t'i dërgohet ASHSH- së. Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe u tha që Platforma duhet të diskutohet bashkërisht me ASHSH- në dhe në takimet që pritet të mbahen të sqarohen dhe të tejkalohen të gjitha paqartësitë dhe aty të mbahet procesverbal që do të shërbejë si dokument zyrtar për procedurat dhe hapat e radhës.

Platforma u miratua njëzëri nga Kryesia. Pasi të hartohet Platforma përfundimtare nga të dy grupet punuese (ASHAK- ASHSH), u tha që ajo t'i dërgohet për miratim Kuvendit të Akademisë.

XIII. Mbledhja LXI e Kryesisë, u mbajt më 2 shtator. Pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes pararendëse Kryesia:

- E shqyrtoi raportin e punës (prill-qershor) i prof. dr. Nebi Cakës, për kryerjen e punëve në QLE, për realizimin e projektit: "Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX". Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e pranishëm dhe pas diskutimeve u tha që:

- Sekretarja shkencore dhe sekretarja e Akademisë të bisedojnë me prof. Cakën çështjen e futjes në përdorim nga ana e tij të skanerit profesional në QLE.

- Pas përfundimit të kontratës aktuale (në tetor), përveç raportit përfundimtar të cilin prof. Caka e ka për detyrë t'ia paraqesë Kryesisë, të kërkohet nga bartësi i projektit akademik Rexhep Ismajli raport i detajuar për punët e kryera dhe punët që do të kryhen në vazhdim.

- E shqyrtoi kërkesën e Kolegjit të kirurgëve të Kosovës për dhurimin e botimeve të ASHAK- ut. Kërkesa u miratua, por u tha që të merret konfirmimi nga Kolegji se aktiviteti do të mbahet, meqë ka filluar zbatimi i masave të reja anti Covid- 19. U shqyrtua edhe kërkesa e zyrtarit të MASHTI-t për dhurim të librave. U tha që edhe kjo kërkesë miratohet pas konfirmimit se librat do të përdoren në MASHTI.

- U njoftua nga L. Pula se me kërkesa zyrtare gjatë kohës së pushimeve vjetore janë dhuruar botime të ASHAK- ut, si në vijim: Bibliotekës Presidenciale "Ibrahim Rugova"; Ambasadës së Republikës së Kosovës në Shkup- MV; Akademik Anton K. Berishaj dhe prof. Anton Vukpalaj (për promovim në Tuz).

- I miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare:

- Të akademik Mehmet Krajës për qëndrimin e tij në Tiranë në ASHSH, më 14 deri 16 korrik 2021.

- Të akademik Mehmet Krajës, për qëndrimin e tij në Ulqin, Mal të Zi, më 29 deri 30 korrik 2021.

- Të akademike Justina Pula, bashkë me akademikët Hivzi Islami, Anton K. Berishaj dhe Prof. Anton Vukpalaj, për qëndrimin e tyre në Tuz të Malit të Zi, më 18 deri 20 gusht 2021.

- U njoftua nga L. Pula për masat e reja anti Covid- 19 dhe veprimet që janë ndërmarrë dhe duhet të ndërmerren në vazhdim. Ajo tha se administrata i ka marrë njoftimet me kohë, orari i punës është reduktuar dhe të gjithë kanë paraqitur dëshmitë e vaksinimit. Përveç zyrtares së IZUM- it, e cila nuk është ende e vaksinuar (meqë e ka kaluar tani Covidin) të tjerët janë të gjithë të vaksinuar. Për anëtarët e Akademisë, tani më e dimë se të gjithë i kanë marrë vaksinat kohë më parë. Nga data 13 shtator ajo tha se do të vendosen në hyrje njoftimet përkatëse dhe zyrtari Petrit Bashota do të kujdeset që të mos e lejojë brenda askënd pa dëshmi përkatëse, sipas Vendimit të Qeverisë së RK.

- U njoftua nga Kryetari Kraja për disa sjellje të pahijshme të shoferit Alban Bytyqi. Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e pranishëm dhe të gjithë u deklaruan se atij duhet t'i tërhiqet vërejtja dhe nëse nuk përmirësohet të ndiqen procedurat ligjore përkatëse.

- Diskutoi për përgatitjen e specifikave për tenderin e ridizajnimit të faqesueb të ASHAK- ut. Kryetari Kraja tha se E. Basha dhe M. Limani janë caktuar nga Kryesia për hartimin e specifikave dhe kërkoi nga ata të fillojnë me punë në këtë drejtim. Furtuna Naka, Udhëheqëse e Prokurimit e cila u ftua në mbledhje gjatë diskutimit të kësaj pike, e njoftoi Kryesinë se nga data 10 shtator faqjaueb mbetet pa

mirëmbajtje dhe nuk është funksionale. Ajo tha se e ka për obligim ligjor të fillojë procedurën e tenderimit së paku dy javë para skadimit të kontratës dhe se po bëhet vonë. M. Limani tha se me këtë punë do të merret pasi E. Bashës t'i përmirësohet gjendja shëndetësore. Kryetari Kraja tha se kjo punë duhet të kryhet me kujdes, më mirë të vonohemi sesa të veprojmë me nguti.

- E shqyrtoi njoftimin e MKRS- së për anëtarin e Këshillit të librit. U tha se akademik Muahmedin Kullashi i propozuar nga ASHAK- u për arsye personale nuk mund të vazhdojë të jetë përfaqësues i ASHAK- ut. Kryesia vendosi që anëtar korrespondent Nysret Krasniqi të propozohet nga ASHAK- u për anëtar të Këshillit të Librit.

- Vendosi që prof. dr. Dukagjin Pupovcit t'i dërgohet një letër falënderimi nga ASHAK- u për punën e tij në projektin: " Platforma e rimëkëmbjes së arsimit në Kosovë", meqë ai ka hequr dorë vullnetarisht nga realizimi i kompensimit, pavarësisht nga vendimi i Kryesisë.

- E shqyrtoi kërkesën e anëtarit korrespondent Arsim Bajrami, për pjesëmarrjen në mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme të Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve (EASA) në Salzburg. U tha që kërkesa t'i dërgohet Kryetarit të KBN, akademik Rexhep Ismajli dhe Sekretares së KBN, anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, me shënimin se nëse ata e miratojnë kërkesën, Kryesia e miraton po ashtu.

- Vendosi që anëtarëve të Akademisë t'u dërgohet edhe një herë drafti i Planit strategjik gjithëpërfshirës. Drafti t'u lihet në dispozicion që të kenë mundësi t'i shqyrtojnë dhe vërejtjet e

sugjerimet eventuale t'i dorëzojnë me shkrim.

XIV. Mbledhja e Kryesisë LXII u mbajt më 21 shtator. U shqyrtuan një varg çështjesh:

- U shqyrtua shkresa e MASHTI- t, për delegimin e përfaqësuesit të ASHAK- ut në procesin për hartimin e strategjisë për arsim, për periudhën 2022- 2026. Kryetari Kraja e propozoi J. SH. Pulën. Propozimi u miratua njëzëri.

- U shqyrtua gjendja e mjeteve financiare të ASHAK- ut për vitin 2021. Me kërkesë të Kryetarit Kraja, L. Pula e njoftoi Kryesinë se në bazë të raportit të përgatitur nga DBF, deri më sot janë në dispozicion mjetet në vlerë prej 46,413. 74€. Do të alokohen mjetet edhe për tre muajt e fundit në vlerë prej 27,937. 00€, që në total mjetet në dispozicion deri në fund të vitit janë në vlerë prej 74,350. 74€. Kryetari Kraja tha në vazhdim se janë disa aktivitete të cilat pritet të organizohen, që varen nga situata me pandeminë.

- U njoftua nga Kryetari Kraja se është koha të mbahen mbledhjet e seksioneve të ASHAK- ut për shqyrtimin e shkallës së realizimit të Programit të punës për vitin 2021. Kryesia u pajtua që mbledhjet të mbahen në gjysmën e parë të muajit tetor.

- U shqyrtua dhe u miratua kërkesa e anëtarit korrespondent Bardh Rugova për angazhimin e lektorit/korrektorit për punët në QLE. Kryesia mori vendim që të angazhohet lektori/korrektori për punët përkatëse në Qendrën Leksikografike Enciklopedike të ASHAK- ut, për realizimin e projektit Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

- U njoftua nga L. Pula për takimin që ajo bashkë me znj. Vjollca Hykollin, kanë pasur në MFPT, për dëgjim buxhetor, më 20 shtator 2021. L. Pula tha se në takim i kanë përcjellë kërkesat, të cilat i ka miratuar Kryesia gjatë shqyrtimit të planifikimi buxhetor për periudhën 2022- 2024.

- Mori vendim që të gjitha punët e drejtorit të DPPTIK- ut, i merr përsipër znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë, deri në ndryshimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

- Diskutoi për caktimin e orarit të promovimit të botimeve të SSHSH. U tha që J. Pula të bisedojë me anëtarët e Seksionit dhe të caktojë datat e promovimeve.

- E shqyrtoi raportin e punës së prof. dr. Nebi Cakës (korrik- shtator) për punët e kryera në QLE. U tha se raporti duhet të plotësohet me shënime shtesë dhe të paraqiten materialet e punëve të kryera. Sa i përket çështjes së vazhimit të angazhimit të prof. dr. Nebi Cakës, Kryesia kërkoi që fillimisht bartësi i projektit të QLE- së, akademik Rexhep Ismajli t'ia paraqesë Kryesisë një raport për punët që janë kryer dhe punët që duhet të kryhen. Më pas Kryesia do ta shqyrtojë nevojën e vazhimit të angazhimit të Prof. Cakës.

- E miratoi raportin e anëtarit korrespondent Fetah Podvorica për pjesëmarrjen e tij në konferencën VI të përbashkët shkencore për vendet e Ballkanit Perëndimor të organizuar nga Akademia e Shkencave e Gjermanisë, në mënyrë virtuale, më 1 dhe 2 korrik 2021.

- U njoftua nga L. Pula për detajet e vizitës që ambasadorit të BE- së, në Kosovë, do t'ia bëjë ASHAK- ut, më 27 shtator, ora 10:30.

- U njoftua nga Kryetari Kraja se kemi pranuar një ftesë nga Kolegji i kirurgëve për pjesëmarrje në Kongresin shkencor klinik që do të mbahet më 23 shtator 2021. Ai kërkoi që të propozohet një anëtar nga SSHN-ja për pjesëmarrje në emër të ASHAK- ut. F. Podvorica e propozoi anëtar korrespondent Arsim Morinën dhe propozimi u miratua.

- U njoftua nga Kryetari Kraja për ftesën e Akademisë së Malit të Zi për pjesëmarrje në ceremoninë e shënimit të 50- vjetorit të themelimit të saj. Ai propozoi që nga ASHAK- u në Mal të Zi të shkojnë nënkryetari Jusuf Bajraktari dhe akademik Anton K. Berishaj. Pasi J. Bajraktari tha se nuk mund të shkojë në Mal të Zi për arsye shëndetësore, u vendos që ASHAK- un atje ta përfaqësojë Anton K. Berishaj.

- U njoftua nga L. Pula për disa blerje që duhet të bëhen dhe për riparimin e mobileve të dëmtuara.

XV. Në mbledhjen LXIII mbajtur më 12 tetor, Kryesia e shqyrtoi shkallën e realizimit të Programit të punës së ASHAK- ut për vitin 2021. Diskutuan me radhë të gjithë sekretarët e seksioneve, secili për seksionin e tij. Pas diskutimeve Kryesia konstatoi se Programi i punës së ASHAK- ut në përgjithësi është realizuar në shkallë të mirë. Deri në fund të vitit pritet të realizohen edhe pikat e mbetura.

L. Mulliqi e njoftoi Kryesinë se disa aktivitete të Seksionit të Arteve, si: koncerti me vepra të akademik Rauf Dhomit në Tiranë, Ekspozita personale e tij e paraparë të mbahet jashtë vendit, koncerti i Zeqirja Ballatës, nuk kanë arritur të mbahen dhe propozoi që ato të evidentohen në raportin e punës me konstatimin se shtyhen deri në krijimin e kushteve për realizimin e

tyre. Kryesia u pajtua me propozimin.

- Kryesia mori vendim që prof. dr. Nebi Cakës t'i vazhdohet angazhimi për kryerjen e punëve për realizimin e projektit: "Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX", për periudhën 15. 10. 2021- 15. 01. 2022. Për punët e kryera Profesor Caka do t'i paraqesë raport me shkrim Kryesisë së Akademisë pas përfundimit të punës dhe materialin e përpunuar i cili është pronë intelektuale e Akademisë, do t'ia dorëzojë Kryesisë së saj.

Detyrat e punës do të përcaktohen me kontratë, sipas propozimit të akademik Rexhep Ismajlit, bartës i projektit

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës u shqyrta shkresa e MASHTI-t Departamenti i Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë (DALSH) për delegimin e një anëtari nga ASHAK- u, në grupin punues që do të bëjë plotësim/ndryshimin e dy Udhëzimeve Administrative (UA), që janë në kuadër të DALSH: UA nr. 01/2017 për botimet dhe publikimet shkencore në revista me faktorë ndikimi dhe UA nr. 26/2016 për projekte të vogla shkencore.

Kryesia njëzëri e caktoi Fetah Podvoricën, ta përfaqësojë ASHAK- un.

Në vazhdim u mor vendim të realizohen pagesat për punët e kryera (dizajni dhe fotografitë) për botimin Xhevdet Xhafa- Monografi dhe për punët e kryera (kuratori) për realizimin e Ekspozitës personale të Xhevdet Xhafës, anëtar korrespondent i ASHAK- ut.

Po ashtu u mor vendimi edhe për pagimin e paushallit për punët e kryera të dizajnit të botimit të plotësuar Rexhep Ferri- Monografi, pjesa në gjuhën angleze.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

- E miratoi raportin e akademik Rexhep Ismajlit për pjesëmarrjen e tij online, në Konferencën shkencore “Aspekte dhe perspektiva ndërdisiplinore dhe tejkombëtare në albanologji.

Konferencë në kujtim të prof. . Wilfried Fiedler, organizuar nga Universiteti “Friedrich Schiller”, më 1 dhe 2 tetor 2021.

- E miratoi raportin e akademik Rexhep Ismajlit për pjesëmarrjen e tij në Konferencën shkencore ndërkombëtare “Akademiku Bahri Beci- Figurë poliedrike e gjuhësisë shqiptare” e cila u mbajt në Shkodër, më 8 tetor 2021.

- E miratoi raportin e Fetah Podvoricës, për pjesëmarrjen e tij në Konferencën shkencore ndërkombëtare të tendencave në nanoteknologji, e cila u mbajt në Tiranë, më 4- 8 tetor 2021.

- E shqyrtoi shkresën që prof. dr. Nazim Gruda, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ia ka dërguar Fetah Podvoricës, me qëllim të njoftimit për mundësinë që ASHAK- u të anëtarësohet në Unionin Europian të Akademive për Shkenca të Aplikuara në Bujqësi. Kryesia vendosi që Fetah Podvorica të merret me procedurat përkatëse e anëtarësimit.

- U njoftua nga L. Pula se janë realizuar disa blerje si: blerja e luleve, riparimi i mobileve dhe blerja e tepihëve për pjesën e jashtme të hyrjes në katin përdhese është në proces.

XVI. Më 18 tetor u mbajt mbledhja LXIV e Kryesisë, në të cilën u shqyrtua shpërndarja e buxhetit për shpenzim, sipas Qarkores së 2-të buxhetore 2022-2024. L. Pula me kërkesë të Kryetarit e njoftoi Kryesinë se kufijtë buxhetorë janë të njëjtë me Qarkoren e parë

buxhetore dhe shpërndarja nuk ndryshon. Meqë mjetet shtesë të kërkuara pas Qarkores së parë në vlerë prej 57,140. 00 €. nuk janë aprovuar, ajo tha se i duhet mendimi i Kryesisë për përsëritjen e kërkesës. Diskutuan edhe M. Limani, L. Mulliqi, F. Podvorica dhe pas diskutimeve u vendos që kërkesa të përsëritet. Shpërndarja e buxhetit u miratua pa ndryshime.

Pas miratimit të shpërndarjes së buxhetit L. Pula njoftoi po ashtu se, nga MFPT-i ka arritur edhe kërkesa për deklarimin e kursimeve buxhetore. Ajo propozoi që përpos deklarimit të mjeteve buxhetore në vlerë prej 12,000. 00€, në kategorinë paga dhe mëditje, tani për tani të mos deklarohen mjete të tjera si kursime, sepse ka shpresë që aktivitetet dhe punët e tjera të parapara të mbahen sipas planit. Kryesia u pajtua me propozimin.

Në fund L. Pula e njoftoi Kryesinë se me kërkesë të akademik Rexhep Ismajlit duhet të përmirësohet kontrata e prof. dr. Nebi Cakës, ashtu që përshkrimi i punëve të miratuara në mbledhjen paraprake të Kryesisë duhet të ndryshohet në disa pika. U tha që kontrata mund të përmirësohet pas paraqitjes me shkrim të detyrave të reja nga Akademik Ismajli

XVII. Në mbledhjen LXV që u mbajt më 26 tetor Kryesia pasi e miratoi Agjendën e aktiviteteve parazgjedhore për zgjedhjen e Kryesisë së ASHAK –ut, diskutoi çështjen e caktimit të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Seksionit të Arteve, duke marrë parasysh se kësaj radhe paraqiten pengesa ligjore, për shkak se pesë nga anëtarët e Seksionit të Arteve kanë kaluar moshën 75 vjeçare dhe L. Mulliqi, tani sekretar i Seksionit, i ka kaluar dy mandate. Diskutuan shumica

e anëtarëve të Kryesisë dhe pas diskutimeve u vendos të caktohet një grup punues në përbërje prej: Lendita Pula, anëtar korrespondent Arsim Bajrami dhe anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj. Grupi do të hartojë me shkrim propozimin dhe arsyetimin përkatës për rregullimin e çështjes në fjalë më së largu deri në fillim të javës vijuese.

Në vazhdim Kryesia:

- Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të Kryetarit Kraja me bashkëpunëtorë për qëndrimin në Tiranë, më 21- 23 tetor 2021, me qëllim të pjesëmarrjes dhe paraqitjes së botimeve të Akademisë në aktivitetin e organizuar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit.

- Vendosi që të caktohet vlera financiare për pagimin e karburantit, në rastet kur në mungesë të sigurimit të transportit zyrtar përdoren veturat private. U tha se vlera e pagesës të jetë deri në 60. 00€.

- Diskutoi për pjesëmarrjen e ASHAK- ut në Panairin e librit në Tiranë. U tha se anëtarëve të Akademisë t'u mundësohet pjesëmarrja në Panair dhe t'u mbulohen shpenzimet e akomodimit, qëndrimit dhe transportit për dy ditë, 18- 20 nëntor.

XVIII. Në mbledhjen LXVI të Kryesisë që u mbajt më 28 tetor Kryesia vendosi që t'i vazhdohet angazhimi korrektorit/lektorit për punët përkatëse për realizimin e projektit "Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX", deri më 15 janar 2022. Materiali i përpunuar konsiderohet i përfunduar dhe mund të procedohet për llogaritjen e tabakëve të autorit dhe për pagesë, pas aprovimit të prof. dr. Nebi Cakës.

XIX. Më 2 nëntor u mbajt mbledhja LXVII e Kryesisë, në të cilën fillimisht u shqyrtua propozimi i Grupit punues për procedurën e zgjedhjes së Sekretarit të Seksionit të Arteve të ASHAK- ut. J. Bajraktari, E. Basha e F. Podvorica në diskutimet e tyre thanë se pajtohen me propozimin në fjalë. L. Mulliqi propozoi që Seksioni të marrë vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës, emri i tij të mos vendoset tani dhe të mos procedohet në Kuvend, por t'i lihet Seksionit më pas të caktojë me rotacion ushtruesin e detyrës. L. Pula me kërkesë të Kryetarit Kraja paraqiti rrjedhën e punës së Grupit punues dhe tha që grupi punues ka rekomanduar që ushtruesi i detyrës të caktohet në mbledhjen e rregullt të Seksionit për periudhën deri në zgjedhjen e Kryesisë së re, sipas Statutit të Akademisë e jo çdo gjashtë muaj, meqë në këtë rast nuk mund të ketë mbështetje në Ligjin e punës apo në Ligjin për zyrtarët publikë.

Pas diskutimeve u tha që Seksioni në mbledhjen e rregullt me vendim e cakton njërin nga anëtarët e tij për ushtrues detyre, ndërsa Kuvendi i Akademisë e miraton në parim vendimin e Seksionit.

Kryesia e miratoi propozimin si më poshtë:

“PROPOZIMI PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES SË SEKRETARIT TË SEKSIONIT TË ARTEVE TË ASHAK- ut
Me Vendim të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, (Vendimi nr. 806/2, dt. 26 tetor 2021), jemi caktuar në Grupin punues për paraqitjen e propozimit për procedurën e zgjedhjes së Sekretarit të Seksionit të Arteve të ASHAK- ut.

Si grup jemi mbledhur dhe i kemi shqyrtuar aktet normative të ASHAK-ut: Ligjin, Statutin dhe Rregulloren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë.

Unanimisht kemi konstatuar si vijon:

Seksioni i Arteve i ASHAK- ut ka gjashtë anëtarë, prej tyre katër anëtarë të rregullt dhe dy anëtarë korrespondentë.

Pesë nga anëtarët e Seksionit (akademikët Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtari korrespondent Xhevdet Xhafa) i kanë mbi 75 vjeç dhe anëtari korrespondent Luan Mulliqi i kalon tani dy mandate si Sekretar i Seksionit.

Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr. 05/L- 038 përmban dispozita të cilat paraqesin kufizime për zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë.

Neni 16 i Ligjit, paragrafët 5 dhe 7 precizojnë se:

“5. Anëtarët e Akademisë mbi moshën shtatëdhjetë e pesë (75) vjeçare nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse” dhe

7. Kryesia e Akademisë zgjidhet për një periudhë katër vjeçare (4) me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër”.

Të njëjtat dispozita i përmban edhe Statuti i Akademisë, por Statuti përmban edhe një dispozitë e cila mund të merret parasysh në rastin konkret.

Neni 14 i Statutit, paragrafi 3 precizon se:

“3. Në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit të seksionit, seksioni me vendim të veçantë cakton një anëtar të tij ushtrues detyre të Sekretarit të seksionit”.

Bazuar në atë që u cek më lartë grupi propozon:

1. Seksioni i Arteve në mbledhjen e rregullt të caktuar sipas Agjendës së aktiviteteve parazgjedhore, të caktojë me vendim të veçantë një anëtar të tij ushtrues detyre të sekretarit të Seksionit deri në zgjedhjet e reja të Kryesisë së ASHAK- ut.

Vendimi të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Seksionit që marrin pjesë në mbledhje dhe që e përbëjnë kuorumin. Caktimi i ushtruesit të detyrës së sekretarit të Seksionit të Arteve të miratohet në parim në mbledhjen zgjedhore të Kuvendit të Akademisë, në përputhje me Rregulloren e ASHAK- ut për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, neni 13, i cili precizon se:

“Kuvendi i Akademisë miraton në parim zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve”.

Propozimi për caktimin e ushtruesit të detyrës së sekretarit të Seksionit mbështetet në atë se Seksioni nuk mund të mbetet pa udhëheqje.

Sekretari i Seksionit përveç që udhëheq Seksionin e përfaqëson atë edhe në Kryesinë e Akademisë”.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

- Mori vendim të realizohet pagesa mujore për Alba –Soft, SH. P. K. për kryerjen e shërbimit të hostimit dhe të mirëmbajtjes së faqesueb të ASHAK- ut. Vlera e pagesës është 80. 00€ për çdo muaj dhe realizohet pas prezantimit të faturave përkatëse, deri në lidhjen e kontratës së re për dizajnimin, zhvillimin, migrimin dhe mirëmbajtjen e faqesueb;

- U njoftua nga M. Kraja për koncertin

që akademik Vasil Tole, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë do ta organizojë në ASHAK. Si datë e mundshme ai përmendi datën 15 dhjetor dhe tha se mbajtja e koncertit do të varet nga situata pandemike.

XX. Mbledhja LXVIII u mbajt më 10 nëntor. Në kuadër të kësaj mbledhjeje, Kryesia:

- U njoftua me pasqyrën e votimit të parë të seksioneve për propozimin e Kryetarit, Nënkyetarit, Sekretarit shkencor dhe zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve të ASHAK- ut. M. Kraja njoftoi se mbledhjet e para të seksioneve janë mbajtur sipas agjendës dhe pas procesit të votimit kemi këtë rezultat:

1. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË, ka propozuar:

1. Për Kryetar, akademik Mehmet Kraja
 2. Për Nënkyetar, akademik Sabri Hamiti
 3. Për Sekretar shkencor, anëtar korrespondent Bardh Rugova
- Akademik Sabri Hamiti është zgjedhur Sekretar i Seksionit.

2. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE, ka propozuar:

1. Për Kryetar, akademik Mehmet Kraja
2. Për Nënkyetar, akademike Justina SH. Pula
3. Për Sekretar shkencor, Seksioni nuk ka kandidat

Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj është zgjedhur Sekretare e Seksionit

3. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS, ka propozuar:

1. Për Kryetar, akademik Mehmet Kraja

2. Për Nënkyetar, Seksioni nuk ka kandidat

3. Për Sekretar shkencor, Seksioni nuk ka kandidat

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica është zgjedhur Sekretar i Seksionit

4. SEKSIONI I ARTEVE, ka propozuar

1. Për Kryetar, akademik Mehmet Kraja
 2. Për Nënkyetar, akademike Justina SH. Pula
 3. Për Sekretar shkencor, anëtar korrespondent Luan Mulliqi
- Akademik Rauf Dhomi është caktuar ushtrues i detyrës së Sekretarit të Seksionit, deri në zgjedhjen e Kryesisë së re.

U tha se propozimet do të kthehen për votim përfundimtar në mbledhjet e dyta të seksioneve, më 15 dhe 16 nëntor 2021.

- E shqyrtoi draftin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ASHAK- IZUM, për krijimin e sistemit bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Kosovë. Diskutuan M. Kraja, M. Limani dhe F. Podvorica. M. Kraja e M. Limani propozuan që zyrtarja e IZUM- it e angazhuar në ASHAK, t'i paraqesë raport me shkrim Kryesisë për punët e kryera deri më tani dhe ato që planifikohen të kryhen gjatë vitit 2022, ndërsa më pas të miratohet Marrëveshja. F. Podvorica në diskutimin e tij tha se ka informata se në nivel të Qeverisë, përkatësisht MASHTI- it, ka filluar ndërtimi i një baze të të dhënave të hulumtimit shkencor, pajisjeve shkencore dhe publikimeve shkencore për gjithë vendin. Me anë të kësaj platforme, CRIS (Current Research Information Sistem), ose KRIS (Kosova Research Information Sistem),

do të bëhet digjitalizimi i të gjitha informacioneve relevante shkencore në nivel të vendit, grumbullimi i të dhënave shkencore për të gjitha institucioneve shkencore, përfshirë edhe ASHAK- un. Nëse ka diçka të tillë, kjo na obligon që të shkëputemi nga COBISS dhe të aplikojmë për sistemin në fjalë.

Pas diskutimeve u tha që të merren informata nga MASHTI, raport me shkrim nga zyrtarja e IZUM-it dhe më pas të merret vendim për lidhjen e marrëveshjes për vitin 2022.

- E miratoi propozimin e Komisionit për blerjen e veprave artistike dhe mori vendim të blihet vepra artistike e anëtarit korrespondent Xhevdet Xhafa, pikturë me titull: "Autobiografia", dimensioni 100x105 cm, teknikë e kombinuar, 1983.

XXI. Në mbledhjen LXIX, mbajtur më 17 nëntor, Kryesia:

- Vendosi që pagesat për honorarët e autorëve të dorëshkrimeve: "Shqiptarët në përfundim të Luftës së Dytë Botërore (1944) sipas burimeve gjermane" me autorë: Jusuf Bajraktari, Frashër Demaj dhe Teki Kurti dhe "Shqiptarët gjatë vitit 1943 sipas dokumenteve ushtarake gjermane", me autorë: Frashër Demaj, Jusuf Bajraktari dhe Teki Kurti, të realizohen në bazë të Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese të ASHAK- ut, neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2.

- Vendosi të angazhohet përkthyesi për përkthimin e materialit të projektit: "Burimet njerëzore dhe zhvillimi i sektorit privat në Kosovë- Hendeku i shkathëtësive dhe kualifikimeve", nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe t'i

realizohet pagesa në bazë të Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese të ASHAK- ut, neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2.

XXII. Mbledhja LXX u mbajt më 23 nëntor. Në këtë mbledhje Kryesia vendosi të mbahet Koncerti festiv i grupit "Academia Albanica" nga Tirana, më 15 dhjetor 2021, ora 19:00, në mjediset e ASHAK- ut.

Pjesëmarrësve të grupit u vendos t'u paguhen honorarët dhe shpenzimet e akomodimit e të qëndrimit në Prishtinë.

Kryesia në kuadër të kësaj mbledhjeje po ashtu:

- E shqyrtoi kërkesën e Këshillit të Sigurisë së Kosovës për delegimin e një anëtari të ASHAK- ut në Këshill. U vendos që anëtar korrespondent Shkumbin Munishi të delegohet nga ASHAK- u për anëtar të Këshillit në fjalë;

- E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të anëtarëve të Akademisë për pjesëmarrje në Panairin e librit në Tiranë, më 18- 20 nëntor 2021.

XXIII. Mbledhja LXXI u mbajt më 2 dhjetor. Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia pas rishqyrtimit të vendimit të mbledhjes paraprake për pagesat e honorarëve për pjesëmarrësit e Koncertit festiv të grupit Academia Albanica nga Tirana, shqyrtoi një varg çështjesh të tjera.

Kryetari Kraja propozoi që drafti i Planit strategjik gjithëpërfshirës dhe draftet e rregulloreve për veprimtarinë botuese dhe honoraret e autorëve të veprimtarisë botuese të ASHAK- ut të rishikohen, të përfundohen, t'u dërgohen të gjithë anëtarëve të Akademisë që të japin vërejtje e

sugjerime eventuale dhe në mbledhjen e Kuvendit të vitit vijues të procedohen për miratim. Kryesia u pajtua me propozimin e Kryetarit dhe u tha që grupet punuese të fillojnë me punë sa më parë.

Në vazhdim Kryesia diskutoi për digjitalizimin e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës(FEK). Kryetari Kraja tha se kohë më parë Kryesia ka marrë vendim që Këshilli botues i ASHAK- ut, në krye me Sekretaren shkencore të merret me procedurat e korrigjimeve të domosdoshme të teksteve të FEK. Deri më tani nuk është arritur të bëhet ndonjë korrigjim, sepse nuk është punë e lehtë dhe nuk ka ndonjë vendim se si të bëhen korrigjimet. Ai propozoi që çështja e digjitalizimit t'i dërgohet për shqyrtim Redaksisë qendrore të FEK dhe aty të vendoset për hapat e radhës.

Kryesia mori vendim të nënshkruhet Marrëveshja ASHAK- IZUM për krijimin e sistemit bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Kosovë dhe znj. Arta Kqiku t'i vazhdohet angazhimi për periudhën 1 janar 2022- 31 dhjetor 2022, sipas kushteve të Marrëveshjes së lartpërmendur.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

- E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të pjesëmarrësve të ASHAK- ut në Kongresin e studimeve albanologjike, në Tiranë më 24- 28 nëntor 2021.

- E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të grupit punues për energjinë (I. Krasniqi, F. Krasniqi, M. Limani dhe F. Podvorica), për qëndrimin e tyre në Tiranë me qëllim të pjesëmarrjes në takimin me grupin përkatës për energjinë të ASHSH- së, më 21- 22 nëntor 2021.

- E propozoi Qamil Haxhibeqirin, Shkumbin Munishin e Besnik Krasniqin anëtarë të Komisionit të dorëzimit- pranimi për punët e dizajnit të faqesueb të ASHAK- ut, nga Operatori i përzgjedhur.

- E propozoi Justina Sh. Pulën, Salih Gashin dhe Fetah Podvoricën, anëtarë të komisionit për pranimin teknik të ndarjes së zyrave në ASHAK.

- U njoftua nga L. Pula se kanë filluar përgatitjet për rregullimin e sallës për mbajtjen e koncertit festiv, është blerë bredhi dhe gjërat e të tjera të nevojshme.

- Diskutoi për risistemimin e anëtarëve të Akademisë nëpër kabinete, pas ndarjes dhe krijimit të hapësirave të reja.

- Mori Vendim që Dorëshkrimi:” Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë”, të përfshihet në kontratën e botimit të librave për vitin 2021. Ky dorëshkrim botohet në vend të dorëshkrimit: “Dokumente dhe korrespondenca të veprimtarëve shqiptarë” –autor akademik Rexhep Ismajli.

XXIV. Mbledhja e fundit e Kryesisë LXXII u mbajt më 14 dhjetor. Në këtë mbledhje Kryesia:

- Diskutoi për risistemimin e anëtarëve të Akademisë nëpër kabinete. Kryetari Kraja njoftoi se pas renovimeve që janë bërë janë ndarë në dysh tri kabinete në katin e 3- të. U vendos që anëtarët e Akademisë të risistemohen si në vijim:

1. Salih Gashi dhe Qamil Haxhibeqiri në kabinetin nr. 315;
2. Arsim Morina në kabinetin 314;
3. Eqrem Basha në kabinetin 205;
4. Anton K. Berishaj në kabinetin nr. 302;

5. Sabri Hamiti në kabinetin 301.

Kabineti nr. 303 i mbetet Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe në të sistemohet Sekretari i SSHSH; në kabinetin nr. 304 sistemohet Sekretari i SSHN, ndërsa kabineti nr. 305 i mbetet SSHN.

- E mori në dijeni letrën e akademik Hivzi Islamit (nr. 1056, dt. 14. 12. 2021) dhe konsideroi se Shërbimi profesional i Akademisë nuk ka arsye ta bëjë shpërndarjen e saj, duke qenë se bëhet fjalë për një letër personale, ndërsa përmbajtja e saj do të shqyrtohet në Kryesinë me përbërje të re, në një nga mbledhjet e radhës.

Njëherësh në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës, Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se stafi i administratës (10 veta) do të shkojnë në takim pune në ASHSH, më 23- 25 dhjetor 2021.

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. – Me rrethanat që u krijuan me masat parandaluese kundër përhapjes së Pandemisë Covid 19, u imponuan vështirësi udhëtimesh e tubimesh, ndaj edhe Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, i riformatuar dhe i plotësuar me anëtarë të rinj, nuk arriti të takohet gjatë vitit 2021 për të hartuar një plan pune e veprimi. Puna e Këshillit që inkuadruar në Protokollin e ri të bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH për vitet 2020 – 2021, të nënshkruar që më 30 janar të vitit 2020. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, 7 nga ASHSH, 7 nga ASHAK-u dhe një

nga Maqedonia e Veriut. Anëtarë të këtij Këshilli nga ASHAK-u janë: akademik Rexhep Ismajli, bashkëkryetar, anëtarët korrespondentë Mehmet Halimi, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi, profesorët Rrahman Paçarizi, Naim Berisha dhe Imri Badallaj, si dhe Lumnije Jusufi nga Maqedonia e Veriut. Edhe ASHSH ka zgjedhur anëtarët e vet. Pritet që gjatë vitit 2022 të krijohen kushte më të favorshme pune.

2. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Pas kapërcimit të vështirësive teknike të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, me sigurimin e skanerit profesional dhe me vënien e tij në punë, si dhe me angazhimin e personit që merret me skanimin, digjitalizimin dhe përpunimin e materialeve të përzgjedhura, prof. dr. Nebi Cakës, ka vazhduar puna, kësaj here me revistën letrare Jeta e Re. Nga 1 tetori është angazhuar edhe një person teknik që merret me kontrollin dhe korrekturën e materialeve. Nga kjo periudhë dhe deri në përfundim të kësaj pjese të projektit, mbarëvajtjen e punës do ta drejtojë akademik Rexhep Ismajli.

3. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Projekti afatgjatë i botimit të veprës së albanologut austriak Norbert Jokl parashihet të përmbillet në vitin 2022. Deri tash janë botuar tre vëllime të konsideruara boshti i veprimtarisë së tij rreth gjuhës shqipe: Studim për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip /Studien zur Albanischen Etimologie und Wortbildung, (2011), përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli; Studime historiko- krahasuese për gjuhën shqipe / Historisch- Vergleichende untersuchungen über das Albanische (2017) përgatitur nga akademik Rexhep

Ismajli e Heiner Eichner nga Akademia Austriake dhe Gjurmime linguistike historike- kulturore në fushë të shqipes / Linguistisch- Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (2019), përkthyer nga Skënder Gashi dhe përgatitur nga Rexhep Ismajli e Heiner Eichner. Është paraparë mbledhja, sistemimi, përkthimi dhe botimi i artikujve dhe studimeve të Joklit që nuk janë përfshirë në tri vëllimet e botuara deri tash. Vëllimi IV është përgatitur në përmbajtjen e tij, tekstet gjermanisht, kryesisht, si dhe një pjesë e përkthimeve shqip janë gati. Janë kontaktuar përkthyesit për ato tekste që nuk janë përkthyer. Një pjesë e studimeve do të riskanohen për shkak të cilësisë teknike. Me përgatitjen e këtij vëllimi, ashtu si te tre vëllimet e mëhershme, do të merret akademik Rexhep Ismajli.

4. Korpusi i shqipes së folur në Kosovë. Projekti ka përmbyllur tërësisht fazën e mbledhjes së materialit. Janë dorëzuar në shërbimin teknik të administratës së ASHAK- ut mbi 1800 intervista të realizuara në terren nga një ekip prej 20 personash. Materiali i regjistruar, me shënimet përkatëse të të intervistuarve, vendbanimi, mosha, gjinia, profesioni, përmban 12. 000 minuta. I iniciuar nga fundi i vitit 2017, i inkadruar në programin e punës të vitit 2018, Korpusi shërben për matje kuantitative në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të morfologjisë e të sintaksës si dhe të leksikut e të sociolinguistikës. Trajnimet e kuadrit që u angazhua në këtë projekt u realizuan në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë të UP- së dhe me Universitetin e Humboldt (Berlin). Pritet që shërbimet teknike t'i hedhin

në publik, me mundësinë e kërkimit sipas të dhënave të folësve. Bartës të projektit janë Bardh Rugova dhe Rexhep Ismajli.

5. Leksikonët e termave të gjuhësisë. – Gjatë vitit 2021 ka qenë paraparë hartimi i fjalësit dhe ndarja e punëve autorëve që do të angazhohen të hartojnë Leksikonin e termave të gramatikës. Tashmë është hartuar fjalësi me rreth 1500 terma, që do të zgjerohet edhe më shumë gjatë punës dhe në proces janë kontaktet me autorët që do të merren me hartimin e zërave. Botimi i Leksikonit të termave të gramatikës është paraparë me planin e punës së Seksionit për vitin 2022.

TUBIME SHKENCORE

1. Studimet për shqiptarët në Francë, konferencë shkencore ndërkombëtare, organizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në bashkëpunim me Seksionin e Shkencave Shoqërore të ASHAK- ut. - E paraparë për muajin tetor 2020, me ndërhyrjen e masave parandaluese kundër pandemisë Covid 19, që shtyrë për muajin tetor të vitit 2021. Këshilli organizues, me në krye akademik Rexhep Ismajlin, me gjithë vështirësitë, arriti të marrë konfirmimin e rreth 48 pjesëmarrësve. Konferenca u mbajt në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 29 dhe 30 tetor 2021, me praninë e pothuaj të gjithë atyre që kishin konfirmuar pjesëmarrjen dhe me paraqitjen online të 3- 4 pjesëmarrësve të tjerë nga Franca dhe Rumania, që paraqitën kumtesat e tyre dhe morën pjesë aktivisht në diskutime. Konferenca erdh në vazhdimësi të tri aktiviteteve të mëhershme: "Studimet

albanistike në Amerikë", (2015), "Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht", (2017) dhe "Studimet albanistike në Itali", (2019). Synohet një pasqyrë më e afërt e studimeve shqiptare në botën frankofone me qëllim që t'u jepet shtysë zhvillimeve të mëtejme dhe përdëgjimit të këtyre kontakteve në të gjitha rrafshet e veprimtarisë kulturore- intelektuale. Konferenca, e vlerësuar shumë e suksesshme, edhe në këto rrethana, u ndoq me interes edhe në kanalën zyrtar të ASHAK- ut në Youtube, praktikë e dëshmuar e nevojshme në kohët e kufizimeve nga pandemia.

2. Konferenca (Kuvendi) Ndërkombëtare e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 25- 27 nëntor 2021. – Inicuar nga ASHSH dhe realizuar në bashkëpunim me ASHAK-un, Konferenca u mbajt në Tiranë, me mbi 150 pjesëmarrës. Në Këshillin organizues të Konferencës nga ana e ASHAK-ut bënë pjesë akademikët M. Kraja, E. Basha, A. Aliu, Kujtim Shala, si dhe prof. Lindita Sejdiu Rugova dhe Hysen Matoshi. Anëtarë të Komitetit shkencor nga ASHAK-u ishin akademikët E. Basha, S. Hamiti, K. Shala dhe J. Bajraktari, ndërsa anëtarë të Bordit të nderit akademikët R. Ismajli, E. Shukriu, R. Qosja. Nga anëtarët e Seksionit me kumtesa në këtë konferencë u paraqitën akademikët Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Kujtim Shala dhe anët. korr. Bardh Rugova, Nysret Krasniqi dhe Shkumbin Munishi.

BOTIME

1. Rexhep Ismajli, Për historinë e gjuhës shqipe. - I planifikuar me programin e punës të vitit 2021, libri i akademik

Rexhep Ismajli, studiues me rezultate të çmuara mbi të gjitha nga historia e gjuhës shqipe, vendi i saj në familjen indoeuropiane, raportet me fqinjësinë ballkanike, çështje të normës e standardit, problemet e planifikimit të shqipes, gjuhësia e përgjithshme, sociolinguistika, doli prej shtypi nga mesi i qershorit. Në këtë vëllim janë përfshirë studime të kohëve të ndryshme për historinë e gjuhës shqipe dhe studimet e saj, që lidhen tematikisht me çështjet e historisë së hershme të gjuhës dhe me fillimet e shkrimeve të shqipes. Libri është ndarë në 12 kapituj: Ndarja dialektore e shqipes, e parë nga aspekti ballkanik, Prejardhja e gjuhës shqipe e parë nga Italia, Shqipja dhe rumanishtja, Nga gjuha e sotme te prejardhja e saj, Studimet albanistike në Amerikë, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht, Në traditën e madhe të albanologjisë gjermane, Nga shqipja te gjuhësia e përgjithshme (Rasti i Selman Rizës), Studimet për Buzukun pas viteve '50, Botimet e "Mesharit" të Buzukut, Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes dhe Zanoret hundore të Pjetër Bogdanit. Libri ka 515 faqe.

2. Sabri Hamiti, Enigma e poezisë. – Akademik Sabri Hamiti vjen kësaj radhe me një botim me rreth 327 faqe që i kushtohet fund e maje poezisë shqipe, poezisë më të re, por edhe rrënjëve, Fishtës, Kanunit, Shantojës, Koliqit e Camajt. I planifikuar me programin e punës të këtij viti, i dorëzuar dhe i përgatitur me kohë, dorëshkrimi doli nga shtypi nga mesi i qershorit. Libri është i ndarë në dy pjesë, Enigma e poezisë I, që mbyllet me magjinë e përkthimit, me portretin e gjuhëtarit dhe akademikut R. Ismajli, kësaj here si përkthyes e njohës i poezisë europiane

e botërore dhe Enigma e poezisë II, që nis me një fil rouge të poezisë moderne shqipe, të shekullit XX e XXI, nga Zef Zorba, Frederik Reshpja, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja, Fatos Arapi e deri te Romeo Çollaku, Luljeta Lleshanaku, Abdullah Konushevcu, Demë Topalli, Mimoza Ahmeti, Arben Idrizi, Agron Tufa e Eqrem Basha. Problematizimi i thurjes së enigmës poetike.

Problematizimi i zgjidhjes së enigmës. Të gjitha këto kërkime çojnë domosdoshmërisht në aktin e krijimit: nga nisja, nëpër tundimet irracionale, për të përfunduar formën. Aventura e artit modern në pamje të poezisë, në të cilën poezia është Pararojë e Pasrojes, kurse leximi i saj është Pasrojë e Pararojës, thuhej nga autori në paraqitjen e projektit të këtij libri.

3. Bardh Rugova, “Ideologjia e gabimit gjuhësor”. – I dorëzuar në qershor të vitit 2020 dhe i planifikuar me Programin e punës për vitin 2021, libri i anëtarit korrespondent Bardh Rugova, gjuhëtar, studiues e profesor i rregullt i gjuhës shqipe në Fakultetin e Filologjisë të UP- së, autor i disa librave nga gjuhësia dhe publicistika, doli nga shtypi në qershor të 2021- shit. Siç thuhej në paraqitjen e dorëshkrimit, libri është një diskutim mbi ideologjitë e ndryshme që lidhen me procesin e standardizimit gjuhësor përgjithësisht dhe ideologjitë që kanë të bëjnë me standardizimin e shqipes në veçanti. Libri, me rreth 205 faqe, mbështetet mbi shpjegime gjuhësore strukturore, duke vazhduar në konceptime sociolinguistike dhe tekstore e diskursive, duke shpjeguar edhe kontekstet shoqërore dhe psikologjike që lidhen me standardin dhe nxënien e tij. Ai përfshin një kombinim të dhënash empirike dhe diskutimesh teorike. Ka rreth 205 faqe.

Karakterizohet me referencë në formë të endnotave, me indeks të termave dhe një bibliografi të pasur.

4. Poezia shqipe, fillimi i shekullit XXI. – Materialet e Konferencës shkencore, të paraparë për qershor të vitit 2020, e cila nuk u mbajt për shkak të masave parandaluese të Covid 19, u mblodhën dhe u përgatitën për shtyp dhe dolën nga mesi i qershorit i vitit 2021. U konsiderua që kjo ishte mënyra më e përshtatshme për të mos humbur kontributet e studiuesve të letërsisë dhe autorëve që ishin paraqitur me tema të hartuara për këtë Konferencë. Janë gjithsej 16 autorë nga rreth 20 të paraqiturit për të marrë pjesë në Konferencë, të cilët, me kërkesë të Këshillit organizues, dërguan versionet për shtyp të kumtesave dhe mundësuan të mos humbet qëllimi i organizimit të një konference të tillë, që rezultoi me botimin e një vëllimi prej rreth 270 faqesh.

5. Studimet albanologjike në Francë. – Ishin paraparë që në këtë periudhë të botoheshin materialet e Konferencës shkencore organizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Seksioni i Shkencave Shoqërore, e cila për shkak të masave parandaluese kundër pandemisë Covid 19 ishte shtyrë. Me riprogramimin e Konferencës ajo u mbajt më 29 dhe 30 tetor të vitit 2021. Materialet e saj parashihen të botohen gjatë vitit 2022.

6. Kujtim Shala, Kryevepra e Fishtës. - I planifikuar për vitin 2021, është dorëzuar për shtyp në janar të vitit 2022.

7. Revista “Studime 27”. – Numri 27 i revistës “Studime” ka dalë nga shtypi në fillim të vitit, siç ishte paraparë me dinamikën e botimit të saj. Ka 320 faqe dhe në të janë përfshirë artikuj e studime të 17 autorëve si dhe

recensionet për dy botime të Akademisë. Është bërë gati për botim numri 28 i revistës Studime.

PROMOVIME

1. Më 23 prill 2021, në mjediset e ASHAK- ut u promovuan disa nga botimet e SGJL- së me kontribute të albanologëve të huaj. Fillimisht u paraqitën dy nga veprat e albanologut austriak Norbert Jokl, pjesë e projektit për botimit të veprës së plotë të tij: Studime historiko- krahasuese për gjuhën shqipe / Historisch- Vergleichende untersuchungen über das Albanische (2017) përgatitur nga akademik R. Ismajli dhe prof. dr. H. Eichner nga Akademia Austriake dhe Gjurmime linguistike historike- kulturore në fushë të shqipes /Linguistisch- Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (2019), përkthyer nga S. Gashi, përgatitur nga R. Ismajli dhe H. Eichner. Lidhur me projektin dhe veprën e N. Joklit foli akademik Rexhep Ismajli. Anëtar i korrespondent Bardh Rugova foli për botimin " Studime albano- ballkanologjike", të Brian D. Joseph- it nga SHBA-ja, specialist i greqishtes, i gjuhësisë ballkanike dhe i shqipes, anëtar i jashtëm i ASHAK- ut, kontributet e të cilit në këto studime i zgjodhi dhe përgatiti për shtyp akademik R. Ismajli dhe i përktheu ant. korr. B. Rugova. Për librin "Studimet albanistike" në vendet ku flitet gjermanisht / Albanistische Forschungen in den Deutschsprachigen Ländern, materialet e konferencës shkencore (2017), përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli, foli prof. dr. Milote Sadiku, nga katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane , ndërsa për

Studimet albanistike në Itali /Gli studi albanistici, materialet e Konferencës shkencore (2019), foli ant. korr. Shkumbin Munishi. Përfundimin e drejtoi sekretari i Seksionit, akademik Eqrem Basha.

2. Më 18 qershor 2021, në ambientet e ASHAK- ut, u përurua "Leksikoni i termave të sociolinguistikës", i autorëve Rexhep Ismajli, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi, pjesë e projektit afatgjatë për hartimin dhe botimin e Leksikonit të termave të Gjuhësisë. Lidhur me botimin folën akademikët Sabri Hamiti, Kujtim Shala, Rexhep Ismajli, ant. korr. Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi. Promovimin e drejtoi sekretari i Seksionit, akademik Eqrem Basha.

3. Më 15 shtator 2021, në ambientet e ASHAK- ut, u promovua libri më i ri i akademik Rexhep Ismajlit, "Për historinë e gjuhës shqipe", që doli nga shtypi në qershor të vitit 2021, në kuadër të botimeve të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të ASHAK- ut. Fjalën e hapjes e mbajti Sekretari i Seksionit, akademik Eqrem Basha. Vlerësimet lidhur me botimin në fjalë i paraqitën recensentët e librit, anëtarët korrespondentë Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi. Në mbyllje të promovimit foli edhe autori i librit, akademik Rexhep Ismajli.

4. Më 22 shtator 2021, në ambientet e ASHAK- ut, u promovua libri i akademik Sabri Hamitit "Enigma e poezisë". Fjalën e hapjes e mbajti akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit. Të ftuar për të folur rreth kësaj vepre më të re të Akademik Hamitit, ishin pedagoget dhe studiueset nga Universiteti i Tiranës, prof. dr. Persida Asllani dhe prof. dr. Dhurata Shehri, si dhe ant. korrespondent Nysret

Krasniqi, profesor në Katedrën e Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filologjisë të UP- së dhe recensent i dorëshkrimit. Një fjalë falënderimi në fund paraqiti edhe autori i librit, akademik Sabri Hamiti.

Të gjitha promovimet në ambientet e ASHAK- ut u mbajtën konform masave parandaluese për pandeminë Covid 19, me numrin e kufizuar të pjesëmarrësve në sallë dhe me mundësinë e ndjekjes në kanalën zyrtar të ASHAK- ut në Youtube.

AKTIVITETE TË TJERA TË ANËTARËVE TË SEKSIONIT

- Akademikët R. Ismajli, S. Hamiti dhe ant. korrespondent B. Rugova u paraqitën me ligjërata në Seminarin e sivjetshëm Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, të cilin në këtë edicion e drejtonte ant. korrespondent Shkumbin Munishi;

- Akademik R. Ismajli mbajti kumtesë në Konferencën e organizuar nga ASHSH-ja në Tiranë, në shënim të 100 - vjetorit të lindjes së akademik Shaban Demirajt, anëtar i jashtëm edhe i ASHAK- ut;

- Akademik Sabri Hamiti mbajti fjalë në promovimin e botimit të veprës së Fishtës në Shkodër. Ai gjithashtu mori pjesë me kumtesë në Simpoziumin Shkencor për At Gjergj Fishtën organizuar në Lezhë me rastin e 150 - vjetorit të lindjes së poetit;

- Akademik R. Ismajli mbajti fjalën hyrëse (online) në Konferencën shkencore "Aspekte dhe perspektiva ndërdisiplinore dhe tejkombëtare në albanologji" në kujtim të prof. Wilfried Fiedler, organizuar nga Universiteti "Friedrich Schiller" i Vjenës.

- Në Konferencën shkencore "Letërsia dhe institucionet", organizuar nga

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i Universitetit të Tiranës, morën pjesë me kumtesa akademik Sabri Hamiti, akademik Rexhep Ismajli, akademik Kujtim Shala dhe ant. korr. Nysret Krasniqi.

- Në Konferencën shkencore ndërkombëtare për akademik Bahri Becin, anëtar i jashtëm i ASHAK- ut, në 85 vjetorin e lindjes, organizuar nga Universiteti "Luigj Gurakuqi" dhe ASHSH, u paraqit me kumtesë akademik Rexhep Ismajli;

- Akademik Mehmet Kraja mori çmimin letrar "Azem Shkreli" për vepër jetësore që ndan Ministria e Kulturës.

Sekretar i Seksionit

Akademik Eqrem Basha, d. v.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. "Burimet njerëzore dhe zhvillimi i sektorit privat në Kosovë- Hendeku i shkathtësive dhe kualifikimeve", projekt njëvjeçar.

Bartës të projektit: akademik Isa Mustafa dhe anëtare korrespondente Justina Shiroka Pula.

Projekti në fjalë ka përfunduar dhe raporti i tij është miratuar në mbledhjen e rregullt të Seksionit.

TUBIME SHKENCORE

1. Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale. - Konferencë shkencore ndërkombëtare

Bartës të aktivitetit, anëtar korrespondent Muhamedin Kullashi dhe akademik Anton K. Berishaj.

Konferenca ishte e paraparë të mbahet në vitin 2020, por për shkak të situatës me pandeminë Covid- 19, ajo nuk arriti të mbahet dhe u bart në Programin e punës për vitin 2021 dhe më pas në atë për vitin 2022.

Për arsye të njëjta nuk arriti të mbahet, prandaj hiqet edhe nga Programi i punës për vitin 2022.

2. Studimet për shqiptarët në Francë. - Konferencë shkencore: në bashkëpunim me Seksionin e Gjuhësisë dhe të letërsisë të ASHAK- ut.

Konferenca është mbajtur më 29 dhe 30 tetor 2021 dhe ka përfunduar punimet me sukses.

Detajet për punën e konferencës në fjalë janë përfshirë në raportin e punës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

BOTIME

1. Akademik Jusuf Bajraktari, anëtar korrespondent Frashër Demaj dhe prof. dr. Teki Kurti. - Shqiptarët në përfundim të luftës së Dytë botërore (1944) sipas burimeve gjermane.

Dorëshkrimi është botuar.

2. Akademik Hivzi Islami. “Demografia e Kosovës- Evolucionin e Popullsisë, Migrimet dhe Spastrimet Etnike të Shqiptarëve”.

Dorëshkrimi është botuar dhe është përruar më 4 shkurt 2021

Përrurimi i librit u bë në prezencën e një auditoriumi të gjerë.

Për rëndësinë e librit foli sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademike Justina Shiroka- Pula, si dhe recensentët e librit akademik Isa Mustafa dhe akademik Anton Kolë Berishaj. Për librin foli edhe bashkëpunëtori shkencor i autorit të librit, prof. Arsim Ejupi, si dhe përfaqësuesja e Kompanisë “Ekologu” të z. Lazim Destani që përkrahu shtypin e librit, znj. Pranvera Kasami.

3. Akademik Anton K. Berishaj. “Në botën e përbashkët: Tradita, Tranzicioni, Anomia”.

Dorëshkrimi është botuar dhe promovimi i tij është bërë në Tuz- Mal të Zi, më 18 gusht 2021.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë nga ASHAK- u: akademike Justina SH. Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Hivzi Islami, recensentët i parë i botimit dhe autori, akademik Anton K. Berishaj.

4. Anëtar korrespondent Muhamedin Kullashi. - Çështja e Kosovës në hapësirën publike të Francës.

Dorëshkrimi është botuar.

5. Anëtare korrespondente Justina Shiroka Pula. - Mjedisi i biznesit në Kosovë (Analizë krahasuese në vendet e Ballkanit Perëndimor).

Dorëshkrimi është botuar.

6. Anëtar korrespondent Frashër Demaj, akademik Jusuf Bajraktari dhe prof. dr. Teki Kurti. - Shqiptarët gjatë vitit 1943 sipas dokumenteve ushtarake gjermane.

Dorëshkrimi është botuar.

7. Prof. dr. Anton Vukpalaj. - Fshehja e krimimit- Politika serbe e gënjeshtrave të mëdha.

Edhe ky dorëshkrim është botuar dhe është promovuar në Tuz- Mal të Zi, më 18 gusht 2021.

8. Burimet njerëzore dhe zhvillimi i sektorit privat në Kosovë- Hendeuku i shkathtësive dhe kualifikimeve. Titull pune. Rezultatet e projektit janë botuar në një libër të veçantë.

9. Revista Studime shoqërore, nr. 8 është botuar.

PROMOVIME

1. Më 17 mars 2021 në mjediset e Akademisë u bë promovimi i një botimi ndër më të rëndësishmit të ASHAK- ut “Leksikoni i vendbanimeve të Kosovës - Tabloja fizike- hapësinore, demografike dhe funksionale”, në tri vëllime, që kapin 2. 023 faqe. Për botimin folën sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademikja Justina- Shiroka- Pula, kryetari i Akademisë akademik Mehmet Kraja, recensenti akademik Anton K. Berishaj dhe kryeredaktori akademik Hivzi Islami. Në përrurim morën pjesë anëtarë të Akademisë, ekspertë nga gjeoshkencat dhe shumë të interesuar të tjerë.

2. Më 15 qershor u promovua botimi: “Analiza e Ekonomisë në hije në Kosovë”.

Përrurimi u bë në praninë e anëtarëve të Akademisë, ekspertë të fushës dhe të ftuar të tjerë.

3. Më 22 dhjetor 2021 u promovua libri i akademik Muhamedin Kullashit,

“Kthesa e dramës moderne (shek. XIX- XX)”.

Aktivitetin e shpalli të hapur me një fjalë rasti akademike Justina SH. Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Për librin folën recensentët: akademik Eqrem Basha dhe prof. dr. Haqif Mulliqi.

Në fund autori paraqiti një përmbledhje të shkurtër të librit dhe falenderoi Akademinë për mbështetjen dhe të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.

Sekretare e Seksionit
Justina SH. Pula, d. v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Modifikimi i sipërfaqes së qymyrit me shtresa të holla organike, i paraqitur nga anëtar korrespondent Fetah Podvorica, projekt 2-vjeçar (2019- 2020). Ky projekt është në kuadër të fushës së kimisë së materialeve. Projekti ishte paraparë të përfundojë gjatë vitit 2020, por për shkak të pandemisë Covid 19 puna laboratorike e planifikuar për vitin e dytë të projektit nuk ka qenë e mundur të realizohet fare, prandaj projekti ka vazhduar dhe është realizuar në vitin 2021.

Objektivat kryesore të projektit ishin:

I. Veshja e sipërfaqes së qymyrit me grupe alkile gjatë reaksionit në mes alkilhalogjenureve dhe radikaleve arile të krijuara me anë të reduktimit të kripërave arildiazonium.

II). Vërtetimi i pranisë së shtresave të

holla me grupe alkile në sipërfaqe të qymyrit me anë të metodave të ndryshme të analizës së sipërfaqeve. Këto metoda do të shërbejnë, njëkohësisht, për të gjetur kushtet optimale të formimit të këtyre shtresave: lloji i molekulës së alkil halegjenurit, lloji i kripës së arildiazoniumit, raporti i përqendrimeve të tyre; kohëzgjatja e modifikimit, përdorimi i ndonjë mjeti reduktues etj.

III) Përdorimi i qymyrit të modifikuar në sipërfaqe me grupet alkile për përgatitjen e membranave asimetrike heterogjene qymyr i modifikuar – acetat celuloze. Veshja e sipërfaqes së qymyrit do ta bëhet me grupe të ndryshme alkile, të cilat dallojnë si në përbërje kimike për shkak se ato mund të përmbajnë edhe grupe funksionale specifike po ashtu edhe në gjatësi të vargut karbonik.

IV) Përgatitja e shtresave të përziera organike me grupe alkile dhe arile të lidhura në sipërfaqe të qymyrit duke përdorur si gjenerator të radikaleve alkile, kripëra të aril diazoniumeve, radikalet arile të cilave lidhen edhe vet për sipërfaqe të qymyrit.

V) Testimi i efikasitetit të membranave asimetrike heterogjene qymyr i modifikuar – acetat celuloze.

VI) Optimizimi i performancës së këtyre membranave të cilat përmbajnë qymyrimin e modifikuar me shtresa të holla alkile.

Gjatë vitit 2021, prej muajit maj kur ka filluar lehtësimi i masave anti Covid është punuar intensivisht dhe janë përmbushur të gjitha objektivat. Aktualisht janë duke u përgatitur për t'u dërguar për publikim dy punime shkencore ku njëri përfshin rezultatet e arritura në kuadër të objektivave I, II dhe IV, kurse tjetri përfshin rezultatet e

arritura në kuadër të objektivave III, V dhe VI.

TUBIME SHKENCORE

Për shkak të rrethanave tani më të njohura të shkaktuara nga pandemia Covid 19 tri aktivitetet e paraprapra më poshtë në lidhje me tubimet shkencore nuk janë realizuar dhe do të jenë pjesë e Programit të punës së Seksionit për vitin 2022.

1. Mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezeve të reja frekuencore UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela. Tryezë shkencore.
2. Integriteti, etika dhe besueshmëria e institucioneve kërkimore shkencore. Tryezë shkencore.
3. Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Simpozium shkencor.

BOTIME

1. Është bërë promovimi i librit “Komforti termik”, i akademik Fejzullah Krasniqi dhe prof. dr. Rexhep Selimaj.
2. Libri “Sfidat e planifikimit multiparametrik të rrjeteve komunikuese pa tela” i anëtares korrespondente, prof. Myzafere Limani me bashkautorët Mimoza Ibrani, Zana Limani- Fazliu, Hëna Maloku- Berzati është botuar në nëntor të 2021.
3. Revista “Resarch- Kërkime” nr. 25 është botuar në nëntor të 2021.

AKTIVITETE TË TJERA

1. Anëtarët e Seksionit të SHN-së kanë vazhduar të përfaqësojnë ASHAK- un në konferencat e rregullta vjetore që mbahen në kuadër të iniciativës gjermane për Ballkanin Perëndimor që udhëhiqet nga Akademia gjermane e shkencave “Leopoldina”. Konferenca VI shkencore për Ballkanin Perëndimor është mbajtur më 1- 2 korrik 2021 e udhëhequr nga Akademia e Shkencave Gjermane. Ajo është mbajtur në mënyrë virtuale.

2. Anëtarët e Seksionit të SHN-së kanë marrë pjesë në kuadër të projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta shkencore me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë që janë në kuadër të bashkëpunimit të rregullt midis tyre:

a) realizim të pilot projektit: Studimi i ndryshimeve mjedisore me përdorimin e imazheve satelitore në një segment të zonës ndërkufitare Shqipëri – Kosovë i propozuar si pjesë e Protokollit për Zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës 2020- 22, (pika 14: Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhet satelitore (përfundimi i studimit aktual dhe mundësisht shtrirja në zona të tjera).

b) Organizim dhe kontribut në kuadër të konferencës ndërkombëtar për nanoteknologji me titull “Trendet në nanoteknologji” të organizuar prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit “NanoAlb” prej 4 deri më 8 tetor 2021 në Tiranë. Në konferencë kanë marrë pjesë rreth 210 shkencëtarë nga 21 vende të botës.

c) Anëtarët e Seksionit të ShN të ASHAK- ut të grupit punues për energjinë kanë marrë pjesë në Forumin

e organizuar për Energjinë nga Seksioni i SHNT-së, më 22 nëntor 2022 ku e kanë bërë prezantimin e studimit të potencialeve të energjisë në Kosovë.

d) Anëtarët e Seksionit të ShN-së së bashku edhe me anëtarët e Seksioneve të tjera të ASHAK- ut, më 22 tetor 2022, kanë marrë pjesë në promovimin e botimeve të ASHAK- ut në Ekspozitën e botimeve të ASHAK- ut në kuadër të “Tetorit të librit” në Tiranë.

SEKSIONI I ARTEVE

BOTIME

1. Akademik Zeqirja Ballata: “Përzgjedhje e një cikli veprash kamerale (muzikë dhome) dhe një cikli veprash vokalo- instrumentale kamerale, (muzikë dhome), të ekzekutuara me sukses në festivale dhe koncerte qendrash e vendesh të ndryshme muzikore (Kosovë, Slloveni, Kroaci, Itali, Shqipëri, Çeki, Bullgari. . .).

- Cikli I prej veprash kamerale instrumentale.

- Cikli II prej veprash vokalo- instrumentale.

Dorëshkrimi është dorëzuar për t’u përgatitur për shtyp, por autori ka kërkuar plotësimin e tij, prandaj shtypja e tij shtyhet për kohë të pacaktuar.

2. Monografi Xhevdet Xhafa, autore Suzana Varvarica Kuka, në gjuhën angleze dhe shqipe.

Monografia është botuar dhe është promovuar më 7 tetor 2021.

3. Monografi Rexhep Ferri e plotësuar edhe me pjesën në gjuhën angleze, është botuar.

EKSPOZITA

1. Ekspozitë personale me veprat e anëtarit korrespondent Xhevdet Xhafa. Ekspozita u hap me rastin e promovimit të Monografisë së autorit, më 7 tetor 2021.

2. Dy ekspozita me vepra të artit pamor të artistëve kosovarë dhe dy ekspozita personale të L. Mulliqit (Tiranë dhe Shkup), shtyhen derisa të krijohen kushtet për mbajtjen e tyre (përmirësimin e situatës pandemike).

Mbetet të vlerësohet situata për mbajtjen e tyre deri në fund të këtij viti apo vitin tjetër.

KONCERTE

1. Dy koncerte një për nder të ditës së çlirimit Kosovës dhe koncerti festiv i fundvitit- tradicional.

Koncerti i parë nuk ka arritur të mbahet për shkak të masave anti Covid- 19.

Koncerti i fundvitit është mbajtur më 15 dhjetor në mjediset e Akademisë. Në koncert performoi Ansambli i harqeve “Academia Albanica” nga Tirana, nën drejtimin e dirigjentit të mirënjohur Eno Koço. Në violina interpretuan Lorenc Radovani, Ednea Krasniqi, Fatos Bardulla, Edlira Shkurti, Jadvina Vani, Elda Dono dhe Lorin Lepuri; në viola Arian Paço Albana Kola dhe Albana Meneri; në violonçela Gëzim Belegu dhe Andi Alimemaj, si dhe në kontrabas Arben Basha.

U interpretuan “Ndjesi tradicionale shqiptare” nga Thoma Nasi, Suitë për orkestër harqesh nga Zeqirja Ballata, “Tingëllim epik” nga Çesk Zadeja, “Simfoni kamerale” të Rauf Dhomit, “Valle antike” nga Vasil Tole dhe

“Shpirti i traditës” nga Valton Beqiri.

Njëherësh, ka mbetur pa u realizuar edhe koncerti i akademik Rauf Dhomit, në Tiranë, pjesë e Protokollit ASHAK-ASHSH.

Mbetet të vlerësohet situata për mbajtjen e tyre deri në fund të këtij viti apo vitin tjetër.

Sekretari i Seksionit Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, d. v.

SHËRBIMI PROFESIONAL, ADMINISTRATIV E TEKNIK

Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik (SHPAT) i ASHAK- ut, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative e teknike u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës së Akademisë.

DEPARTAMENTI PËR BUXHET DHE FINANCA – DBF

Raport financiar për kufijtë buxhetor dhe ndryshimet e pësuara gjatë vitit fiskal 2021

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit Nr. 07/L- 041 për ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2021 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ka qenë në vlerë totale prej 1,221,272. 00 €.

(Shihni tabelën Nr. 1 të ndarjeve buxhetore në kategori ekonomike)

Buxheti fillestar i ASHAK- ut sipas Ligjit nr. 07/L- 001 (1. 262. 916,00 €)		
Pagat dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale
162,176,00€	338,937,00€	715,159,00€

Me Ligjin Nr 07/L- 041 për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2021, të realizuar në muajin gusht 2021, buxheti i ASHAK-ut zvogëlohet për vlerat e paraqitura në tabelën nr. 2

Buxheti sipas Ligjit nr. 07/L- 014 – Rishikimi buxhetor – vlerat e zbritura			
Pagat dhe mëditje	Malla dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe Transfere
0. 00€	- 7,000. 00€	- 2,000. 00€	- 13,000,00

Pas ndryshimeve sipas Ligjit të Rishikimit të buxhetit për vitin 2021, vlerat monetare janë si vijojnë në tabelën e mëposhtme nr. 3:

Buxheti sipas Ligjit nr. 07/L- 014 – Rishikimi buxhetor – mjetet në dispozicion (1. 199,272,00 €)			
Pagat dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencionet dhe transferet
162. 176,00€	331. 937,00€	3. 000,00€	702. 159,00

Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës në fund të vitit fiskal 2021 ka marrë vendime edhe për kursime buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike, ka bërë kursime të mëtejme në Paga e mëditje në vlerë prej 12,058. 01€, në kategorinë Mallra e shërbime 2,006. 22 € dhe në kategorinë Subvencione dhe transfere në vlerë prej 566. 04 €. (Vendimi i Qeverisë Nr. 21/50 dt. 24. 12. 2021 dhe Nr. 11/52 dt. 29. 12. 2021).

Mjetet monetare të kursyera në fundvit sipas Vendimeve të Qeverisë Nr. 21/50 (24. 12. 2021) dhe Nr. 11/52 (29. 12. 2021)			
Pagat dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencionet dhe transferet
- 12. 058,01€	- 2. 006,22€	0,00€	- 566,04€

Buxheti final për ASHAK për vitin 2021, ka qenë gjithsej 1,184,641. 72 €.

(Shihni tabelën Nr. 4 të ndarjeve finale buxhetore në kategori ekonomike)

Buxheti final për ASHAK- un për vitin 2021 - mjetet në dispozicion (1. 184. 641,72 €)			
Pagat dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencionet dhe transferet
150. 117,98€	329. 930,78€	3. 000,00€	701. 592,96€

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, ASHAK- u ka pasur depozita mjetesh nga Donatori Salbatring Internacional të bartura nga viti 2020, si dhe donacionin nga IZUM i Sllovenisë në vlerë prej 6,000. 00 € për pagesën e punonjësës së angazhuar rreth programit COBIS. (Shihni tabelën Nr. 5)

Mjetet në dispozicion - të përfituara nga donacionet		
Salbatring International - Kosovë	8. 636,99€	4. 636,00€ - për blerjen e librave; 4. 000,00€ - për ndarjen e Shpërblimeve mbështetëse;
IZUM - Slloveni	6. 000,00€	Biblitoteka e ASHAK- ut – kompenzimi financiar për punonjësën e angazhuar rreth Programit COBISS

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE DHE I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT E KOMUNIKIMEVE - DPPTIK

Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe i Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve – DPPTIK i ASHAK- ut, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të teknologjisë së informacionit e komunikimeve, dhe të veprimtarisë botuese, përpunoi rreth 694 tabakë shtypi (10,542 faqe), dhe organizoi botimin e 24 titujve të librave e publikimeve, me 6050 kopje.

DPPTIK ka përditësuar vazhdimisht regjistrin e veprimtarisë botuese.

Faqe	Tabakë shtypi	Kostoja në €	Tabakë autori	Kostoja në €	Tabakë shtypi i autorit, gjithsej €	Tirazhi
7,940	529. 26	33,765. 50	500. 18	95. 269,98	129. 032,48	6,050

DPPTIK-u ndërlidhur me veprimtarinë botuese, aktivitetet e së cilës i përkrahu drejtpërsëdrejti dhe për shërbimet e tjera profesionale e teknike ia doli të angazhojë rreth 180,147. 86 € të të gjithë buxhetit të ASHAK- ut në kategorinë Mallra e Shërbime.

DPPTIK- u mbikëqyri dhe u përkujdes për funksionimin normal të sistemeve dhe të shërbimeve të TIK- ut dhe multimedive, si dhe për funksionimin normal të faqesueb duke e populluar atë me të dhënat e përditësuara. Gjithashtu u angazhua në nisjen e zhvillimit dhe dizajnit të faqesueb të re të ASHAK- ut.

DPPTIK- i përkrahu profesionalisht punën e akademikëve dhe të Administratës. Në bashkërenditje me shërbimet e tjera të ASHAK- ut, DPPTIK- u përkrahu profesionalisht drejtpërsëdrejti 16 (gjashtëmbëdhjetë) aktivitete të Akademisë (promovime, konferenca, tubime, ekspozita, koncerte, ligjërata, ceremoni, etj.).

DPPTIK- u përgatiti specifikimet teknike dhe inicoi rreth 20 aktivitete prokurimi të ASHAK- ut, dhe menaxhoi 7 kontrata afatgjate dhe kontratat e tjera, të cilat kishin të bëjnë me aktivitetet e DPPTIK- ut.

DPPTIK- u realizoi projektin e Sistemit të evidencimit të ardhjes në punë të ASHAK- ut.

DPPTIK- u realizoi projektin e rifunksionalizimit të sistemeve të projektimit të ASHAK- ut.

DPPTIK- u mirëmbajti dhe realizoi projektin e përditësimit të sistemit të vëzhgimit me kamera.

DPPTIK- u realizoi lidhje virtuale komunikuese të drejtpërdrejta e online me bashkëpunëtorë dhe pjesëmarrës të jashtëm sipas nevojave të ASHAK- ut.

DPPTIK- u vazhdoi me organizimin dhe rregullimin e depove të librit si dhe të materialeve të tjera të harxhimit të nevojshme për funksionimin normal të Administratës dhe Akademisë. Gjithashtu shpërndau librin sipas kërkesave dhe nevojave të ASHAK- ut. Organizoi dhe mbikëqyri edhe mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të shërbimeve logjistike për Administratën dhe Akademinë.

DPPTIK- u vazhdoi të kontribuojë në standardizimin e mëtejshëm të bërjes së Librit të ASHAK- ut, dhe përgatiti specifikimet teknike të produkteve të veçanta të nevojshme për punën e ASHAK- ut. DPPTIK- u shtyu aktivitetet në drejtim të përgatitjes profesionale të shkresave zyrtare duke ndihmuar me gjedhet përkatëse dhe me udhëzimet profesionale.

DPPTIK-u u angazhua në kryerjen e punëve dytësore e alternative profesionale për departamentet e tjera të Administratës sipas vendimeve përkatëse.

DPPTIK- u mori pjesë në të gjitha aktivitetet profesionale të Administratës dhe të ASHAK- ut, nëpër komisione profesionale, të pranimit të mallit, të përcaktimit të cilësisë etj.

DPPTIK-u përfundoi fazën e dytë të riorganizimit të rrjetit strukturor kabllor.

DPPTIK-u përfundoi riorganizimin e domenit dhe futjen në domenin e ASHAK- ut të stafit administrativ.

DPPTIK-u me përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin dhe mbindërtimin e kapaciteteve lokale profesionale zbatoi metodat e përkrahjes së drejtpërdrejtë dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe të baraspeshuar me akademikët dhe me departamentet e tjera, si edhe me operatorët ekonomikë të jashtëm duke e përmirësuar dhe ngritur vazhdueshëm cilësinë e shërbimeve teknike profesionale dhe të shërbimeve të tjera të përkrahjes profesionale.

DEPARTAMENTI I BIBLIOTEKËS DHE ARKIVIT – DBA

Gjatë vitit 2021 kanë vazhduar aktivitetet e rregullta që lidhen me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe riorganizimin e bibliotekës. Ka filluar riorganizimi i fondit bibliotekar sipas kodeve të katalogimit të sistemit COBISS. Për shkak të nevojës së vendosjes së materialit bibliotekar sipas kodeve unike të sistemit COBISS, i gjithë fondi i bibliotekës është zhvendosur nga raftet.

Ka vazhduar regjistrimi i të gjithë librave dhe revistave që janë blerë, këmbyer apo të pranuar në rrugë të ndryshme (kryesisht dhurata). Gjatë vitit 2021, biblioteka e ASHAK-ut është pasuruar me rreth 900 (893) tituj të rinj. Biblioteka është pasuruar po ashtu me një numër të konsiderueshëm të revistave.

Ka vazhduar aplikimi i sistemit COBISS të katalogimit dhe përpunimit bibliografik në bazën Conor të fondit bibliotekar nga zyrtarja e DBA- së, Rejhane Islami, e trajnuar dhe licencuar nga Instituti i Shkencave të Informacionit (IZUM) nga Sllovenia për katalogimin e monografive, dhe Arta Kqiku, e licencuar nga IZUM për katalogimin e monografive dhe revistave dhe krijimin e koleksioneve të bibliotekës dhe bibliografive.

- Në bazën e përbashkët të katalogimit COBISS. KS janë kryer 3,612 regjistrime bibliografike,
- Rreth 4,000 libra janë inventarizuar;
- Në bazën lokale BASHAK janë shkarkuar 1,355 regjistrime bibliografike;
- Në bazën Conor janë regjistruar 1,263 autorë;

- Në bazën për regjistrimin e termave të njësuar CONOR janë kryer 406 regjistrime
- Ka vazhduar katalogimi i revistave/serialeve dhe artikujve më qëllim të krijimit të bibliografive tematike (përparësi u është dhënë revistave Kërkime, Studime dhe Studime Shoqërore të ASHAK).
- Ka filluar faza e parë e krijimit të bibliografive personale të akademikëve;
- Për nevoja të krijimit të bibliografive në sistemin COBISS. KS janë krijuar listat lokale të kodeve për renditjen e kontributeve sipas fushave nëpër bibliografi.
- Në të njëjtin sistem janë krijuar edhe listat lokale të kodeve për renditjen e materialeve nëpër rafte sipas fushave, përkatësisht sipas numrit të KDU- së.
- Është bërë procesverbali për ndarjen e dhomave/vektorëve në bibliotekë dhe ka filluar renditja e materialeve sipas klasifikimit lëndor decimal (KDU).
- Është instaluar moduli "Koleksionet e bibliotekës" dhe printeri për shtypjen e etiketave (vendndodhjen e materialeve, numri i KDU, autori). Instalimi i këtij moduli ka mundësuar fillimin e inventarizimit të materialeve bibliotekare sipas numrit të KDU- së dhe shkronjës së parë të mbiemrit të autorit.
- Janë krijuar rreth 2000 etiketa për modulin "Koleksionet e bibliotekës".

Salla e leximit është hapur pjesërisht për lexues të jashtëm për shkak të pandemisë. Një numri të konsiderueshëm të lexuesve u është mundësuar (me gjithë kufizimet që ekzistojnë) të nxjerrin jashtë bibliotekës botime të ndryshme për kohë të shkurtër, të cilat i kanë kthyer.

Projekti: Botimet për Kosovën në gjuhë të huaja

Ka vazhduar realizimi i projektit afatgjatë për identifikimin, gjetjen dhe mbledhjen e botimeve për Kosovën në gjuhët e botës, të cilat do të jenë pjesë e një koleksioni të veçantë të bibliotekës. Procesi ka vazhduar përmes blerjes, këmbimit, dhurimit, fotokopjimit, etj.

Janë fotokopjuar rreth 350 libra të huazuara nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës (BKK) sipas marrëveshjes për lejin e fotokopjimit (për nevoja të brendshme të ASHAK).

Janë blerë 50 libra të tjerë në gjuhët e huaja përmes aktivitetit të prokurimit.

Fokusi kryesor gjatë vitit 2012 ka qenë identifikimi i botimeve për Kosovën në gjuhë të huaja, të cilat mund të shkarkohen nga interneti dhe të shtypen. Ky proces ka marrë shumë kohë, sepse numri i botimeve që mund të shkarkohen për printim është shumë i vogël (ka raste kur kontrollohen mbi 100 tituj dhe vetëm një apo asnjë botim është i shkruar për printim).

Deri më tani janë mbledhur rreth 700 tituj në gjuhë të ndryshme, shumica në anglisht. Do të vazhdohet me gjetjen e rrugëve të tjera për të siguruar sa më shumë të jetë e mundur botime për Kosovën në të gjitha gjuhët e botës.

Gjatë vitit 2021 nuk është botuar asnjë gazetë ditore, prandaj regjistrimi i artikujve që lidhen me Akademinë nuk ka mundur të vazhdojë.

Për shkak të rrethanave të shkaktuara nga pandemia, shumica e panairëve në të cilat Akademia merr pjesë rregullisht nuk janë mbajtur. ASHAK-u ka marrë pjesë në vetëm dy panairë gjatë vitit 2021 - Panairi i Tiranës dhe Panairi i Frankfurtit.

Në panairin e Tiranës (16- 21 nëntor) ASHAK-u është prezantuar me botimet e veta si çdo vit tjetër (raporti i plotë është përgatitur pas panairit).

Botime e ASHAK-ut janë prezantuar po ashtu në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Frankfurt, më i madhi i këtij lloji në Evropë, nga data 20- 24 tetor. Nën përkujdesjen e Shoqatës së Botuesve të Kosovës, 22 botime të ASHAK-ut janë prezantuar në një stendë të përbashkët me botuesit kryesorë të Kosovës.

Gjatë vitit 2021, si rrjedhojë e pandemisë, bashkëpunimi dhe këmbimi i botimeve me biblioteka të akademive të ndryshme dhe më institucione kosovare dhe të vendeve të rajonit ka qenë më i ulët krahasuar më vitet paraprake. Me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë dhe Qendrën për Studime Albanistike të Shqipërisë janë këmbyer shumica e botimeve të reja.

Arkivi

Zyrtarja e rekrutuar e Arkivit, pas punës përgatitore, ka filluar procesin e arkivimit të dokumentacionit zyrtar të ASHAK-ut, sipas strukturës organizative të ASHAK- ut, të miratuar nga kryesia e ASHAK- ut (klasifikimit bazik i dokumenteve zyrtare të papërpunuar, ndarja e kopjeve origjinali dhe të fotokopjuara, ndarja sipas viteve, klasifikimi sipas shenjave unike, regjistrimi në tabelat Excel.

Shënim plotësues: Shënimet e SHPAT- it janë marrë nga drejtorët dhe zyrtarët e departamenteve përkatëse.

Sekretare e Akademisë

Lendita Pula, d. v.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2022



SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

1. Këshilli Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. –Veprimtaria e Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe u inkadrua sërish në Protokollin e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitet 2020 – 2021, të nënshkruar më 30 janar 2020. Në takimet e dy kryesive që vendosur që Këshilli të ketë 15 anëtarë, 7 nga ASHSH, 7 nga ASHAK dhe një përfaqësues nga Maqedonia e Veriut. ASHAK-u zgjodhi anëtarët e vet në përbërje: akademik Rexhep Ismajli, bashkëkryetar, anëtarët korrespondentë Mehmet Halimi, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi, profesorët Rrahman Paçarizi, Naim Berisha, Imri Badallaj si dhe Lumnije Jusufi nga Maqedonia e Veriut. Edhe ASHSH zgjodhi anëtarët e vet të këtij Këshilli, duke caktuar bashkëkryetar akademik Ethem Likën. Të zgjedhur që në fillim të vitit 2020 anëtarët e Këshillit nga ASHAK- u mbajtën takimin e parë të konstituimit vetëm sa për të diskutuar Rregulloren, pastaj u intensifikuan zhvillimet me pandeminë covid 19, u shpallën masat parandaluese dhe më tutje nuk pat mundësi të takohet për të hartuar një plan veprimi. Pritet që gjatë vitit 2022 të krijohen kushte më të mira për mbarëvajtjen e punës së këtij Këshilli.

2. Historia e letërsisë shqipe. - Projekt afatmesëm për hartimin e Historisë së letërsisë shqipe. - “Historia e letërsisë shqipe” është projekt afatmesëm për hartimin e tekstit “Historia e letërsisë shqipe”. Mungesa e një veprë sintetizuese të nivelit akademik për letërsinë shqipe shtrou nevojën e domosdoshme kulturore, për hartimin e një teksti të Historisë së letërsisë shqipe gjithëpërfshirëse, që nga fillimet deri në kohën e tashme. Trajta e veprës do të jetë e nivelit akademik, duke tejkaluar sprovat e përparme të trajtave të doracakëve shkollorë apo universitarë. Kriteret e hartimit të veprës do të jenë kriteret letrare dhe estetike. Kriteret e parashtruara nënkuptojnë evidencat/të dhënat letrare në një shtrirje kohore pesëshkullore, që nuk do të thotë krijimin e një kronologjie letrare. Kriteret e parashtruara nënkuptojnë trajtim autorësh, veprash e fenomenesh letrare shqipe, që synojnë krijimin e një sistemi letrar. Po këto kriteret bëjnë të mundshme zbulimin e fenomeneve letrare shqipe, trajtimin e shndërrimeve letrare dhe theksimin e përhershmerive letrare, që paraqet një proces letrar të mbrendashkruar. Përfundimisht, një vepër e këtyllë sintetizuese e gjithëpërfshirëse përfshin dhe përmban komunikimet e brendshme të letërsisë shqipe dhe komunikimet e jashtme të kësaj letërsie, me letërsitë dhe kulturat e tjera. Përgjatë udhëtimit ditunor vepra Historia e letërsisë shqipe rizbulon aktin krijues letrar të letërsisë identitare, për të takuar e sprovuar

universaliet letrare, në nivel të komunikimit, krijimit të formave që shpalojnë idetë e domethëniet/kuptimet. Për realizimin e projektit kapital Historia e letërsisë shqipe, në Akademinë e Shkencave e të Arteve të Kosovës është ngritur paraprakisht një Grup i punës, i përbërë nga Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Ali Aliu, Kujtim Shala e Nysret Krasniqi, për të krijuar themelet/bërthamën e platformës e të kriterëve të hartimit të veprës, po ashtu për të udhëhequr punën për përfundimin e veprës.

3. “Leksikonët e termave të gjuhësisë”. - Projekti është inkuadruar në programin e punës së Seksionit që në vitin 2018. Rëndësia e tij mbështetet te shpjegimi dhe interpretimi i termave të gjuhësisë. Krijimi i fjalorëve (leksikonëve) me vështrim enciklopedik të gjuhësisë, duke e pasur në mend të parë gjuhësinë shqiptare, ndihmon normëzimin e terminologjisë së gjuhësisë në gjuhën shqipe. Duke i pasur brenda vetes termat e fushave të ndryshme të gjuhësisë, leksikonët do t’u shërbejnë studentëve, studiuesve dhe të interesuarve të tjerë. Që paraparë të realizoheshin sipas fushave: a. fonetikë, b. sociolinguistikë, c. gramatikë. Në qershorit të vitit 2019 u botua Leksikoni i termave të fonetikës dhe të fonologjisë hartuar nga Bardh Rugova me mbi 500 termanjësi në një vëllim prej 260 faqesh. Në fillim të vitit 2021 u botua Leksikoni i termave të sociolinguistikës, me autorë Rexhep Ismajlin, Bardh Rugovën dhe Shkumbin Munishin, një dorëshkrim me 387 faqe. Projekti do të vazhdohet me Leksikonin e termave të gramatikës që parashihet të realizohet gjatë vitit

2022 dhe të botohet në pjesën e parë të vitit 2023. Meqenëse do të jetë më i madhi dhe më kompleksi nga fjalorët e hartuar deri tash, për shtrirjen, zërat e përfshirë, mënyrën e realizimit dhe shpërndarjen e zërave në një grup më të madh hartuesish do të angazhohen, Rexhep Ismajli, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi. Në vitet në vijim parashihet që të tri këto vëllime të botohen në një të vetëm, përmbyllës.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Viti 2022 parashihet të jetë vit përmbyllës i botimit të veprës së albanologut austriak Norbert Jokl. Projekti parasheh edhe mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e artikujve dhe studimeve të Joklit që do të jepen në përkthim të disa përkthyes me qëllim që të arrihet të përmbledhen edhe kontributet e tjera të tij në një vëllim, me qëllim që vepra të dalë sa më e plotë. Deri tani kanë dalë tre vëllime: Studim për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip /Studien zur Albanischen Etimologie und Wortbildung, (2011), përgatitur nga Rexhep Ismajli; Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe /Historisch- Vergleichende Untersuchungen über das Albanische (2017) përgatitur nga Rexhep Ismajli dhe Heiner Eichner nga Akademia Austriake dhe Gjurmime linguistike historike- kulturore në fushë të shqipes/ Linguistisch- Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (2019), përkthyer nga Skënder Gashi dhe përgatitur nga Rexhep Ismajli dhe Heiner Eichner. Botimi i vëllimit të katërt, përmbyllës, parashihet në pjesën e dytë të vitit 2022.

5. Arbnishtja e Zarës – rreziku i zhdukjes dhe gjasat e rimëkëmbjes. Arbnishtja e Zarës është një varietet i rrezikuar i shqipes. Folësi më i ri i saj është në të dyzetat. Kjo gjendje e bën këtë varietet përfundimisht të rrezikuar të zhdukët. Gjasat për rimëkëmbjen e këtij varieteti varen nga gjasat që fëmijët e komunitetit të nisin ta mësojnë ta flasin. Arbneshët e Zarës janë një komunitet që ka migruar nga zonat shqiptare të territoreve përreth Liqenit të Shkodrës e që tash gjenden brenda kufijve shtetërorë të Malit të Zi. Komuniteti është i vendosur në një pjesë të Zarës dhe, sipas regjistrimeve jozyrtare, ka rreth 2000 pjesëtarë. Sipas vlerësimeve të mbështetura në vëzhgimet në terren rreth 250 syresh ende e flasin arbnishten, kryesisht si gjuhë komuniteti dhe për nevoja të amvisërisë. Të gjithë folësit e arbnishtes janë, së paku, bilingë (kroatishtja) ose trelingë (kroatishtja dhe italishtja). Ndonëse kanë identitet të fortë etnik arbnesh, njëherësh e ndiejnë edhe identitetin shtetëror kombëtar kroat, sidomos pas luftës në Kroaci në vitet '90. Vitet e fundit ka pasur përpjekje të vazhdueshme për rikëndjelljen e arbnishtes, përmes hapjes së kurseve për mësimin e arbnishtes, përpilimin e një teksti mësimor, të fjalorit dhe të ligjëratave që janë mbajtur për komunitetin. Ende nuk mund të flitet për rezultate të dukshme. Projekti parasheh realizimin e një vizite kërkimore në terren për të vjelë një sërë intervistash me pjesëtarë të komunitetit për të nxjerrë të dhëna të strukturës së gjuhës dhe të qëndrimeve të tyre mbi komunitetin dhe identitetin. Do të realizohet një vizitë në Vjenë për të hulumtuar materialet e arkivuara historike mbi komunitetin. Do të publikohet një

shpjegues i arbnishtes. Do të publikohet një studim që do të nxjerrë në pah gjasat dhe mundësitë e rimëkëmbjes së këtij varieteti. Varianti i detajuar i Projektit është hartuar nga Bardh Rugova. Bartës janë Bardh Rugova e Rexhep Ismajli.

6. “Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX”. – Gjatë dy viteve të fundit nuk ka pasur lëvizje rreth këtij projekti. Puna u vështirësua sidomos pas shpalljen së masave parandaluese kundër përhapjes së pandemisë. Në fillim të vitit 2021 ka rinisur punën prof. Nebih Caka, i angazhuar edhe më herët në projektet e skanimit dhe digjitalizimit, si dhe botimit të fjalorëve të lematizuar të Fjalorit serbo-kroatisht- shqip të Sokol Dobroshtit dhe të revistës “Përparimi”. Skanimi, digjitalizimi i materialeve dhe puna rreth Korpusit ka kërkuar angazhime të specialistëve të fushave dhe kompletimin e kushteve teknike, tashmë kur janë kapërcyer disa nga vështirësitë rreth aftësisimit teknik e profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, para së gjithash me sigurimin e skanerit dhe vënien e tij në punë. Me riangazhimin e specialistit janë krijuar rrethana të reja për vazhdimin e projektit me skanime të reja të revistave, librave, shtypit dhe periodikut. Mbase në këtë periudhë do të parashihet edhe angazhimi i personave teknikë që do të merren me punët e skanimeve dhe digjitalizimit të materialeve. Synohet hartimi i një fjalori të shqipes së shkruar në Kosovë.

TUBIME SHKENCORE

1. Kritika letrare shqipe / Fillimi i shekullit XXI. - Konferencë shkencore,

që do të mbahet në Prishtinë në muajin maj ose në muajin qershor të vitit 2022. Pjesëmarrës do të jenë kritikët shqiptarë bashkëkohorë apo të huaj që merren me letërsinë shqipe. Në themel të kërkimeve do të jenë çështjet lidhur me shkrimin e komunikimin letrar në kohën e tashme; natyrën e kritikës dhe shndërrimet e saj në ballafaqim me letërsinë aktuale apo të traditës, duke interpretuar format, strukturat e domethëniet letrare. Në këtë proces komunikimi në botën e letrave shqipe do të shfaqet vetëdija për autorefleksion estetik që shpie kah sistematizimi e vlerësimi. Vetëdija që kritiku është, para së gjithash, lexues i pasionuar i letërsisë; për pasojë, vetëdija që kritika, as gjenetkisht as funksionalisht, nuk është as mbretëreshë as shërbëtore e letërsisë, por bijë e letërsisë. Punimet e Konferencës do të botohen në libër të veçantë, si përfundim i librave pararendës “Romani shqiptar dhe Poezia shqipe”, tashmë në qarkullim.

BOTIME

1. Norbert Jokl “Studime dhe artikuj mbi gjuhën shqipe” - Vëllimi IV i veprave të Norbert Jokl- it është përgatitur në përmbajtjen e tij, tekstet gjermanisht kryesisht dhe një pjesë e përkthimeve shqip janë gati. Është biseduar me disa prej përkthyesve të mundshëm dhe materialet do t'u ndahen. Për ta çuar botimin në shtyp ka nevojë që një pjesë e teksteve të skanuara të riskanohen, sepse nuk janë mjaft të pastra për botim. 2- 3 prej teksteve të përkthyer janë vetëm shqip, duhet skanimi i origjinalit. Gjithsej gjermanisht do të jenë rreth 400- 450 f. Po të llogaritet edhe

përkthimi shqip, vëllimi IV mund të shkojë deri në 800- 900 f. Varësisht nga vëllimi përfundimtar, mund të mendohet që disa nga studimet të mos përfshihen në këtë vëllim, kështu që i tërë vëllimi mund të zbritet për rreth 100 f në tërësi. Për ta bërë gati tërë vëllimin nevojiten skanimet e disa prej teksteve që nuk i kemi këtu. Me përgatitjen e këtij vëllimi, ashtu si te tre vëllimet e mëhershme, do të merret akademik Rexhep Ismajli.

2. Selman Riza, “Vepra”, Vëllimi VI. – ASHAK-u ka botuar deri tash 5 vëllime të veprës së S. Rizës. Tash janë siguruar tekstet e tij për Kanunin (1949) – frëngjisht e serbisht (tejshkruar dhe përkthyer shqip nga shkrimi me dorë R. Ismajli), përkthimi i Kanunit, serbisht, Fjalori terminologjik serbisht – frëngjisht – shqip, dorëshkrim i lënë në Institutin Albanologjik më 1955 dhe 10 faqet e traktatit për gjendjen dhe zhvillimet politike, ndoshta të vitit 1943 (të shikohet se mos gjendet në Arkivin e Kosovës pjesa tjetër e këtij dorëshkrimi). Pjesën e gjetur e ka tejshkruar tashmë Akademik Ismajli, që po merret edhe me përgatitjen e këtij vëllimi të veprave të S. Rizës. Në kërkim e sipër janë dhe disa nga dorëshkrimet e pabotuara dhe të papërfshira të S. Rizës në vëllimet paraprake. Vëllimi do të jetë i gatshëm për botim në pjesën e dytë të vitit 2022.

3. Sabri Hamiti, Letërsia e tashme. - Studimi për letërsinë aktuale shqipe të shkruar në botën shqiptare e në diasporë, duke përfshirë autorë e vepra të botuara në deceniet e para të shekullit XXI. Trajtimi i formave letrare sinkretike dhe kërkimi i tipologjizimit të stileve e të tematikave letrare. Në

pjesën e parë “Poezia” trajtohet poezia metafizike dhe poezia e rebelimit në rrafshin stilistik e tematik. Në pjesën e dytë “Proza”, trajtohet forma e romanit, si ego- roman, që sipërthekson subjektivitetin e personalitetin e autorit e të personazhit; pastaj trajta e romanit të qytetit, që objektivizon ambientin (toposin) e kohën, me tendencë dokumentaritetin; dhe romanin e diasporës shqiptare, të shkruar në gjuhë të tjera. Në pjesën e tretë, “Kritika”, trajtohet forma e metoda e leximit të letërsisë, që shfaqet si ese e interpretim, me synim për sistematizim; lexim i hapur për letërsinë e përparme dhe letërsinë e aktualitetit. Vepra, për shumëçka, ka trajtë introductive, sepse shqyrton fenomene letrare aktuale, në zhvillim e sipër. Libri do të ketë vëllimin 220 f. (20 TA).

4. Kujtim M. Shala: “Kënga e cjamin” - Është libër teorik mbi gjininë e tragjedisë, i shoqëruar dhe me interpretime të veprave konkrete të gjinisë së tragjedisë. Trajton tragjedinë nga pozicioni i filozofisë së letërsisë, pastaj si një ontos letrar, në të gjitha rrafshet gjinore, me një përqendrim te tematika, e cila cilësohet si një manifestim letrar ontologjik i tragjedisë. Trajtimi teorik shtrihet nga teoria estetike e Platonit e këndeje, me referenca themelore pikëpamjet e Aristotelit, Horacit, teoritë e Rilindjes, klasicizmin frëng, në radhë të parë, veprën e Bualosë, pastaj klasikën gjermane e Niçen, teoritë angleze etj. Provat konkrete të teorisë, në nivel interpretimi, lidhen me veprën e Eskilit, të Sofokliut, tragjeditë romake, “Makbethin” e Shekspirin, tragjedi të

klasicizmit frëng etj. Po ashtu, libri trajton edhe vepra shqipe, nga De Rada te Hamiti, përfshirë Fishtë, Haxhiademin, Pashkun etj. Libri ka 350 faqe dhe do të dorëzohet për botim në pjesën e dytë të vitit 2022.

5. Skënder Gashi “Shtresime gjuhësore në leksikon e në toponiminë e Kosovës”. Dorëshkrimi që inkuadruar në programin e punës së Seksionit për vitin 2020 dhe u recensionua nga anëtarët korrespondentë Bardh Rugova dhe Mehmet Halimi. Por, në këtë kohë ndërroi jetë autori dhe mbetën disa vështirësi teknike të pasqaruara, të cilat ai kishte premtuar se do t’i mbikëqyrte gjatë përgatitjes së tekstit për shtyp. Bëhet fjalë për një përmbledhje prej 21 artikujve që trajtojnë tema të ndryshme të emrave të vendbanimeve, por edhe të njerëzve apo të emërtimeve të tjera në truallin e sotëm të Kosovës. Dorëshkrimi ka rreth 530 faqe.

6. Kritika letrare shqipe / Fillimi i shekullit XXI. – Botimi i punimeve të konferencës shkencore, që parashihet të mbahet në Prishtinë në muajin maj ose në qershor të vitit 2022. Pjesëmarrës do të jenë kritikët shqiptarë bashkëkohorë apo të huaj që merren me letërsinë shqipe. Në themel të kërkimeve do të jenë çështjet lidhur me shkrimin e komunikimin letrar në kohën e tashme; natyrën e kritikës dhe shndërrimet e saj në ballafaqim me letërsinë aktuale apo të traditës, duke interpretuar format, strukturat e domethëniet letrare. Vëllimi me versionet për shtyp të kumtesave që do të paraqiten në këtë Konferencë do të përgatitet për shtyp deri nga fundi i muajit tetor. Pritet një vëllim

përafërsisht i ngjashëm me ata të dy konferencave pararendëse, “Romani shqiptar” / fillimi i shekulli XXI dhe “Poezia shqipe” / fillimi i shekullit XXI.

7. Studimet albanistike në Francë. – Botimi i kumtesave të Konferencës shkencore “Studimet albanistike në Francë” që parashihet të mbahet në fund të tetorit të vitit 2021. Konferenca fillimisht qe planifikuar në muajin tetor të vitit 2020 dhe qe shtyrë për shkak të masave parandaluese të pandemisë covid 19. Duke marrë parasysh formatin e konferencës, si dhe pamundësitë e udhëtimeve dhe komunikimeve në rrethana të tilla, mbajtja e Konferencës u riprogramua të mbahet në javën e fundit të muajit tetor, 2021 ndaj është e udhës të parashihet dhe publikimi i versioneve për botim të kumtesave të paraqitura në këtë Konferencë.

8. Studime, nr. 28. – Revista “Studime” që boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, me kontribute, studime shkencore e artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip dhe në gjuhë të tjera, del një herë në vit. Përmbillet në fund të vitit kalendarik dhe del në muajt e parë të vitit. Përgatitet nga redaksia e drejtuar nga kryeredaktori Zejnullah Rrahmani. Numri 27 tashmë ka dalë nga shtypi, ndaj pritet që edhe numri i ardhshëm, 28, i paraparë për vitin 2022, të arrijë me kohë. Revista publikohet edhe në faqen web të Akademisë.

Sekretari i Seksionit Akademik Eqrem Basha, d. v.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. Zhvillimi i aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës (Projekt dyvjeçar).

Ekipi i projektit: akademike Justina Shiroka- Pula udhëheqëse dhe akademik Isa Mustafa e anëtar korrespondent Besnik Krasniqi.

Fushat tematike: Studime ekonomike dhe sociale

Qëllimi dhe objektivat e projektit

Qëllimi i këtij projekti është që t’i kontribuojë ndërtimit të një qasjeje integruese të masave në fushën e politikëbërjes, kërkimeve shkencore dhe aktiviteteve biznesore për nxitjen e inovacioneve dhe rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, si dhe sektorëve të caktuar brenda saj me kapacitete strategjike të dallueshme dhe relevante, përmes aplikimit të inovacioneve. Objektivat specifike të këtij projekti janë:

(1) Përmirësimi i informacionit lidhur me nivelin e aftësisë konkurruese të Kosovës në nivel të ekonomisë dhe sektorëve të caktuar;

(2) Ndërtimi i indeksit të konkurrueshmërisë së Kosovës dhe analiza krahasimore me vendet në rajon e më gjerë.

(3) Propozimi i rekomandimeve lidhur me masat dhe politikat për zhvillimin e aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës.

Metodologjia e studimit

Metodologjia e studimit është e bazuar në metoda kërkimore të përziera (cilësore dhe sasiore). Hulmtimi sasior do të bazohet në anketë me biznese dhe mostër reprezentative sektorale për të vlerësuar ku qëndron Kosova sa i përket aftësisë konkurruese duke përfshirë treguesit e produktivitetit dhe inovacioneve. Ky hulmtim duhet të përfshijë: analizën se cili është potenciali konkurrues dhe inovativ i sektorëve të caktuar më qëllim të identifikimit të sektorëve /degëve/grupacioneve që kanë ose mund të ndërtojnë kapacitete të veçanta, të dallueshme (distinktive) për konkurrencë? Sa është i përshtatshëm mjedisi biznesor dhe sa janë konsistente dhe të qëndrueshme (dhe jo të fragmentuara) politikat ekonomike?

Anketa me biznese prodhuese mbi kapacitete konkurruese dhe inovacione do të mundësojë vlerësimin e zhvillimeve në industrinë e Kosovës në 7- 8 vitet e fundit. Për të bërë analiza sektorale mostra do të jetë e stratifikuar sipas sektorëve dhe do të përfshijë 1200 respondentë (biznese). Të dhënat nga anketa me biznese do të përdoren për ndërtimin e indeksit të konkurrencës së ekonomisë së Kosovës, sipas praktikave ndërkombëtare të studimit, si The Global Competitiveness Index. Kjo do të mundësojë që Kosova të bëhet pjesë e rangimeve ndërkombëtare që do të mundësonte edhe krahasimet me vendet e tjera të botës. Rrjedhimisht krahasimet ndërkombëtare do të kontribuojnë në identifikimin më të lehtë të sektorëve dhe pozicionit konkurrues të Kosovës.

Hulmtimi cilësor përfshin intervista

cilësore me aktorët kyçë, si përfaqësuesit e biznesit, qeverisë dhe asociacioneve të biznesit. Disa grupe të fokusit do të organizohen me sektorët specifikë të ekonomisë për të identifikuar sfidat dhe mundësitë për të ndërtuar kapacitete konkurruese.

Mbi bazë të raportit do analizohen edhe politikat dhe praktikat më të mira për zhvillim të aftësive konkurruese, inovacioneve dhe ndërmarrësisë për të rekomanduar opsionet për nxitjen e inovacioneve dhe kërkimeve aplikative që vazhdojnë më zbatim dhe komercializim. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet ndërlidhjes institucionale në mes të ndërmarrjeve dhe atyre kërkimore dhe qeveritare. Rekomandimet do të përqendrohen sidomos tek infrastruktura institucionale dhe rekomandimet për politikat për zhvillim të kërkimeve dhe dijës në funksion të inovacioneve dhe aftësisë konkurruese me theks të veçantë në institucione qeveritare/akademike/institute/ndërmarrje, financimi dhe fondet për zhvillim të aftësive konkurruese.

Plani i hulmtimit përmban aktivitete të shtrira në dy vjet për shkak të kompleksitetit të fushës së studimit dhe punës në terren. Në vitin e parë do të realizohet rishikimi i literaturës dhe dokumenteve relevante, përpilimi i instrumentit hulmtues/pyetësorit, implementimi i hulmtimit në terren, ndërtimi i indeksit të konkurrencës së ekonomisë së Kosovës, si dhe hartimi i raportit kërkimor. Në vitin e dytë do të realizohet hulmtimi cilësor me grupe të fokusit të bizneseve dhe politikëbërësve, analiza e rasteve dhe përvoja ndërkombëtare, organizimi dhe diskutimi i rezultateve, finalizimi i raportit të dytë kërkimor.

TUBIME SHKENCORE

1. Tryezë shkencore: "Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992. - Tryeza planifikohet të mbahet më 24 maj të vitit 2022, në përvjetorin e 30 jubilar të organizimit të zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992 në Republikën e Kosovës. Në këtë aktivitet parashihet të marrin pjesë rreth 15 studiues, prej tyre rreth 7 studiues nga jashtë Kosova, për të cilët duhet të mbulohen shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit për dy ditë.

Bartës të aktivitetit do të jenë akademik Jusuf Bajraktari dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj.

2. Konferencë shkencore ndërkombëtare: "Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale. – Kjo konferencë është përfshirë edhe në Protokollin e bashkëpunimit ASHAK- ASHSH dhe ka qenë pjesë e Programit të punës për vitin 2020.

Realizimi i saj ka qenë i pamundur për shkak të rrethanave pandemike, prandaj do të përfshihet në programin e punës për vitin 2022.

Bartës të aktivitetit janë: akademik Muhamedin Kullashi dhe akademik Anton K. Berishaj.

Tema e dhuratës është njëra nga temat karakteristike të mendimit filozofik, sociologjik e antropologjik bashkëkohor, ndonëse kjo dukuri hulumtohet më shumë në shoqëritë paramoderne të së kaluarës dhe në shoqëritë e ashtuquajtura "primitive" (fisnore) të së tashmes.

Konferenca ka për qëllim që duke

marrë parasysh hulumtimet e deritashme mbi aspekte të ndryshme të temës së dhuratës dhe dhurimit të tematizojë çështje e probleme që vejnë në pah karakterin sfidues të kësaj çështje për shoqëritë e sotme dhe për relacionet midis tyre. Në këtë konferencë do të ftoheshin, përveç studiuesve të vendit, edhe disa studiues nga rajoni dhe disa qendra të tjera.

BOTIME

1. Muhamedin Kullashi: "Kosova në fushën e diplomacisë në Francë 2008-2016. Ky libër synon të analizojë vendosjen, funksionimin dhe aktivitetet e përfaqësive diplomatike të Kosovës në Francë në periudhën 2008- 2016. Do të shqyrtohet roli i kësaj përfaqësie në ndërtimin e lidhjeve dhe të bashkëpunimit midis ministrive të Kosovës dhe ministrive të Francës, midis instancave qeveritare të dy vendeve, në nivelin e presidencës dhe të qeverisë. Do të analizohen aktivitetet diplomatike në zhvillimin e bashkëpunimit midis dy vendeve në lëmenjtë e arsimit, shkencës, kulturës dhe ekonomisë.

Do të trajtohet zhvillimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të vendosura në Francë, si dhe roli i diplomacisë franceze në realizimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare në Francë: me Parlamentin Evropian, Këshillin e Evropës, Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës, Organizatat ndërkombëtare si ajo e frankofonisë(OIF), e OKB- së për arsim, shkencë dhe kulturë (UNESCO) etj. Do të analizohet bashkëpunimi me

diplomacinë franceze rreth njohjeve nga shtetet frankofone (në Afrikë e Azi sidomos) dhe shtete të tjera të cilat Franca kishte një ndikim të theksuar politik e ekonomik; e njëherësh edhe bashkëpunimi me përfaqësitë diplomatike të më se 180 vendeve, nga kontinente të ndryshme, të vendosura në Paris. Të rikujtojmë këtu se në ligjërimet politike e diplomatike në Francë personalitete të shquara e kanë mbështetur pavarësinë e Kosovës në sajë të analogjisë me themelimin e BE-së pas Luftës së Dytë Botërore: që të mos rikthehen në Evropë krimet masive mbi popullsitë civile në emër të ideologjive anakronike. Do të trajtohet edhe çështja e rolit të diplomacisë franceze rreth vendimit të GJND- së për Kosovën më 2010 e njëherësh edhe qëndrimi i diplomacisë franceze ndaj dialogut dhe negociatave midis Kosovës dhe Serbisë në Bruksel. Në këtë libër do të analizohen po kështu edhe perceptimet për Kosovën pas pavarësimit të saj, nga qarqet diplomatike të vendeve të ndryshme me seli në Francë. Këto shqyrtime e analiza do të kenë parasysh traditën teorike e praktike të diplomacisë në Francë dhe në disa vende të tjera të Evropës (Itali, Britani e Madhe dhe Gjermani). Do të merren parasysh teoritë dhe praktikat diplomatike në kohën e formimit të sistemit shtetëror evropian dhe të formimit të së drejtës ndërkombëtare.

Do të merren parasysh refleksionet teorike në analizat për diplomacinë brenda suazave kulturore e socioprofesionale të shekullit XX në veçanti, me theks të veçantë të negociatat për vendosjen e paqes dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Ky libër do të trajtojë edhe qasjet krahasuese ndaj kulturës, ligjërimet dhe teorive e praktikave diplomatike në Francë, Britaninë e Madhe dhe Gjermani. Kjo qasje do të përqendrohet tek analizat e shumëfishta të lidhjeve midis literaturës për diplomacinë me atë mbi të drejtën ndërkombëtare, sikurse edhe të lidhja e teorive mbi ritualet e ceremonitë diplomatike, kryesisht ato që merren me shtetin. Do të analizohen teoritë dhe praktikat e ndërtimit të drejtpeshimit midis shteteve.

Dorëshkrimi përafërsisht do të ketë deri në 250 faqe (16 tabakë shtypi).

2. Akademik Isa Mustafa, akademike Justina Shiroka- Pula, anëtar korrespondent Besnik A. Krasniqi: “Ekonomia në hije: trajtim teorik dhe empirik”

Objekti i studimit

Ekonomia në hije mbulon një gamë të gjerë të aktiviteteve ekonomike si tregti mallrash dhe shërbimesh që nuk janë pjesë e ekonomisë zyrtare të një vendi. Si e tillë ka implikime të mëdha për buxhetin e shtetit, si dhe për ndërtimin e një sektori privat konkurrent. Ekonomia në hije është një nga sfidat më të mëdha për ekonominë botërore, sidomos për vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion. Ekonomia në hije ka pasoja të mëdha për ekonominë e një vendi, si rritjen e evazionit fiskal, shtrembërimin e tregut të punës, konkurrencës së pandershme, dhe shpërndarjen joefikase të burimeve. Studimi do të fokusohet në trajtimin e teorive më bashkëkohore të ekonomisë në hije që do të shërbejnë për të ndërtuar një kornizë konceptuale për matjen empirike të ekonomisë në hije në Kosovë.

Qëllimi i studimit

Në shumë vende në tranzicion dhe në Kosovë ekonomia në hije paraqet një pengesë kryesore për zhvillimin e një sektori të fortë biznesi dhe për të ndërtimin e një ekonomie funksionale të tregut. Në Kosovë, bazuar në studime të ndryshme, ekonomia në hije përlllogaritet të jetë rreth 35- 40% të bruto produktit vendor. Kjo pjesëmarrje e lartë e ekonomisë në hije ka pasoja të mëdha për buxhetin e Kosovës, dhe rrjedhimisht edhe në mundësinë e shteti për të financuar dhe ofruar shërbime publike. Në anën tjetër, në literaturën ekzistuese në fushën e ekonomisë në hije ekziston një debat lidhur me trajtimin e saj, metodologjinë e matjes në aspektin empirik, si dhe në veçanti lidhur me politikat për të ndikuar në zvogëlimin e saj. Prandaj, qëllim i këtij studimi është të trajtojë aspektet teorike të ekonomisë nën hije dhe modelimin empirik për rastin e Kosovës, dhe do të kontribuojë në literaturën ekzistuese në Kosovë dhe më gjerë. Në aspektin aplikativ, studimi do të kontribuojë në ofrimin e politikave për zvogëlimin e ekonomisë në hije.

Metodologjia

Studimi do të bazohet në analizën kritike të literaturës ekzistuese në fushën e ekonomisë në hije: teoritë e hershme neoklasike, teoria e dualizmit/modernizimit (dualistic/modernization theory, teoritë strukturaliste, teoria institucionale, modelet e evazionit fiskal, teoritë e moralit tatimor. Analiza kritike e këtyre teorive do të mundësojë ndërtimin e një qasjeje integrative dhe modeli të testueshëm empirikisht për ekonominë e Kosovës. Për këtë qëllim do të përdoret metodologjia e bazuar në të

dhënat e anketës për të konstruktuar indeksin e ekonomisë në hije dhe për të matur madhësinë e ekonomisë në hije bazuar në anketën me menaxherët e kompanive. Të dhënat nga anketa e realizuar nga projekti paraprak i ASHAK-ut në vitin 2019 do të përdoret për të prodhuar analiza të thelluara empirike mbi ndikimin e ekonomisë në hije dhe faktorët që ndikojnë në madhësinë e saj. Ky indeks, shkaqet dhe pasojat e tij do t'u japin politikëbërësve informacione për marrjen e vendimeve të bazuara në evidencë empirike. Për më tepër, studimi ofron prova mbi faktorët kryesorë përcaktues që ndikojnë te sipërmarrësit, përfshirjen në ekonominë në hije dhe ofron disa rekomandime për politika publike.

Struktura e studimit

Libri do të përmbajë gjashtë pjesë kryesore. Në pjesën e parë trajtohen çështjet lidhur me kuptimin, definimin dhe matjen e ekonomisë në hije. Në pjesën e dytë bëhet një vështrim kritik i teorive kryesore në fushën e ekonomisë në hije, të cilat shërbejnë për ndërtimin e kornizës konceptuale që do ta informojë modelin ekonometrik. Pjesa e tretë ofron një krahasim të tregueseve kryesorë të ekonomisë në hije në shume vende të botës, përfshirë edhe Kosovën. Në pjesën e katërt, do të zhvillohet një model ekonometrik i bazuar në të dhëna të Kosovës, në veçanti do të modelohen përcaktuesit e moralit tatimor. Pjesa e pestë ofron rekomandime dhe propozime konkrete për politikëbërës për parandalimin e ekonomisë në hije. Pjesa e gjashtë përfundon me konkluzione përfundimtare dhe rekomandime për studime të ardhshme në këtë fushë.

Audienca

Ky studim u dedikohet studiuesve, ekonomistëve, studentëve në fushën ekonomisë, shkencave politike dhe sociale. Në aspektin praktik dhe aplikativ, studimi u dedikohet politikëbërësve, si agjencioneve qeveritare dhe shtetërore të përfshira në kontrollin e ekonomisë në hije si dhe ndërmarrësve dhe menaxherëve për ta kuptuar më mirë kontekstin e të bërit biznes në Kosovë dhe vendet në tranzicion.

Dorëshkrimi përafërsisht do të këtë deri në 200- 220 faqe (14 tabakë shtypi)

3. Arsimit Bajrami: "Aspekte juridike të gjenocidit serb në Kosovë".

Objekti i studimit

Objekt i studimit Aspekte juridike të gjenocidit serb në Kosovë është politika gjenocidale e Serbisë ndaj Kosovës, duke u fokusuar në dimensionin juridik të trajtimit diskriminues të shqiptarëve në ish Jugosllavi, shkeljen e të drejtave elementare dhe diskriminimit në baza etnike, deri tek analiza e akteve juridike për përgatitjen dhe implementimin e gjenocidit serb në Kosovë. Në mënyrë të veçantë do të analizohen aktet dhe ligjet diskriminuese serbe që rrënuan rendin kushtetues në Kosovë dhe instaluan okupimin serb që rezultoi me gjenocidin serb në Kosovë.

Qëllimet e studimit

Studimi ka tri qëllime kryesore shkencore: Të trajtojë në mënyrë shkencore shkeljen sistematike të të drejtave kombëtare të shqiptarëve në Kosovë; të vërë në spikamë aspektet juridike të veprimeve gjenocidale serbe në Kosovë dhe të vërë në pah elementet dhe argumentet juridike të

padisë eventuale të Kosovës ndaj Serbisë për gjenocid.

Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi do të realizohet përmes metodave tipike të shkencave juridike dhe politike, metodave krahasuese, analitike, historike dhe statistikore.

Struktura e studimit

Ky studim do të sistemohet në tri pjesë, gjashtë kapituj, tituj dhe nëntituj që paraqesin një kompozicion logjik të këtij hulumtimi shkencor. Pjesa e parë përfshin dimensionin juridik të diskriminimit të shqiptarëve të Kosovës në ish-Jugosllavi. Pjesa e dytë përfshin rrënimin e rendit kushtetues në Kosovë në vitin 1989, okupimin e Kosovës dhe aktet juridike, kushtetuese dhe ligjore që përbëjnë elementet e gjenocidit serb në Kosovë. Pjesa e tretë do të fokusohet në elementet legale që duhet të përfshihen në padinë eventuale të shtetit të Kosovës kundër Serbisë për gjenocid.

Dorëshkrimi përafërsisht do të këtë deri në 30 tabakë shtypi.

4. Zhvillimi i aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës. - Rezultatet e fazës së parë të projektit do të botohen në një vëllim në gjuhën shqipe dhe angleze.

5. Revista "Studime shoqërore", nr. 9. - Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2022. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencorë, tekste ligjëratash inauguruese, vështrime, recensione e kritika, etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore.

Sekretare e Seksionit

Anëtare korrespondente Justina Shiroka Pula, d. v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik Kosovë- Shqipëri.

Projekt i përbashkët dyvjeçar në mes ASHAK- ut dhe ASHSH- së në sektorin e energjisë.

Kosova dhe Shqipëria aktualisht janë shtete që nuk i plotësojnë të gjitha nevojat e tyre me energji elektrike, prandaj, për sigurimin e mjaftueshëm të saj, ato e importojnë atë në shkallë 10 %. Viteve në vazhdim kërkesat për energji normalisht se duhet të shënojnë rritje qoftë për shkak të zhvillimit të sektorit industrial dhe për shkak të zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëroro- ekonomik. Kosova dhe Shqipëria shfrytëzojnë burime të ndryshme të prodhimit të energjisë elektrike: Kosova bazohet në masë rreth 90 % në përdorim të thëngjillit, kurse Shqipëria në burimet hidrike të saj.

Kohëve të fundit janë ngritur shqetësime në nivel botëror për shkak të ndotjes së mjedisit nga shfrytëzimi i burimeve fosile për të prodhuar energjinë elektrike dhe për këtë arsye kërkohet nga shtetet e botës që të rriten kapacitetet për prodhim të energjisë elektrike duke i shfrytëzuar burimet e ripërtëritshme. Konform urgjencës që imponon një situatë e tillë, Kosova dhe Shqipëria është e nevojshme që të bashkërendojnë hapat e tyre në shfrytëzim sa më efikas të burimeve të tyre ekzistente të energjisë, duke shfrytëzuar rrjetin e shpërndarjes që ekziston midis dy

vendeve, pastaj duke bërë investime të përbashkëta strategjike në këtë sektor, qoftë në zgjerim të kapaciteteve të prodhimit, në shfrytëzim të burimeve ekzistuese ose në diversifikim të burimeve të energjisë.

ASHAK- u dhe ASHSH- ja do të punojnë në një projekt të përbashkët fillestar dyvjeçar për të hulumtuar dhe analizuar në shkallë të gjerë kapacitetet prodhuese energjetike në të dy vendet së bashku me ekspertët e lëmenjve të ndryshëm dhe me institucionet relevante qeveritare me qëllim të përgatitjes së një platforme të përbashkët energjetike për zhvillim të qëndrueshëm të sistemit energjetik në të dy vendet.

Për këtë qëllim do të formohet një grup punues me nga 5 pjesëmarrës nga të dy akademitë.

Nga ana e Seksionit për anëtarë të grupit punues janë propozuar: akademik Isuf Krasniqi, koordinator, akademik Fejzullah Krasniqi, zëvendëskoordinator, akademik Nexhat Daci dhe anëtarët korrespondentë Myzafere Limani e Fetah Podvorica, ndërsa nga ana e ASHSH- së janë propozuar akademik Ilirjan Malollari, koordinator dhe akademik Jorgaq Kaçani, zëvendëskoordinator. Pjesa tjetër e grupit pritet të konfirmohet në vazhdim.

TUBIME SHKENCORE

1. Organizimi i tryezës shkencore “Mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezeve të reja frekuencore UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela “.

Bartëse e aktivitetit, anëtare korrespondente Myzafere Limani.

Organizimi i kësaj tryeze lidhet me përfundimin e projektit me të njëjtin titull. Organizimi i saj do të përfshihet në Programin e punës së Seksionit për vitin 2022, meqë nuk ka arritur të organizohet për shkak të pandemisë Covid 19. Me kalimin nga transmetimet televizive analoge në ato digjitale, një brez i konsiderueshëm i frekuencave është bërë i disponueshëm për shfrytëzim. Brezi frekuencor i alokuar për transmetime televizive është: VHF 30- 300 MHz dhe UHF 300- 1000 MHz përveç frekuencave që janë të rezervuara për shërbimet emergjente, si dhe mikrofonave që përdoren në ngjarje të ndryshme shoqërore. Ky spektër është shumë i përshtatshëm për rishfrytëzim, për shkak të karakteristikave shumë të mira të përhapjes së valëve gjatë komunikimeve pa tela, me ç'rast mundësohet mbulueshmëri shumë e madhe, si dhe për shkak se infrastruktura e nevojshme për këto komunikime është minimale, e që është ideale për zona rurale dhe vende të pazhvilluara si Kosova. Brez tjetër i rëndësishëm së veçantë dhe me potencial për t'u shfrytëzuar për nevoja të komunikimeve brezgjera pa tela është edhe brezi i valëve milimetrike (30- 100 GHz). Ky brez deri vonë është konsideruar i papërshtatshëm për këto lloje të komunikimeve për shkak të karakteristikave të dobëta të shpërndarjes së sinjalit, por me zhvillimin e hovshëm të sistemeve të antenave me shumë elementë dhe komunikimeve MIMO, shumica e humbjeve të sinjalit mund të kompensohen përmes antenave direksionale me përforsim të madh. Qëllimi i tryezës shkencore që do të organizohet, është prezantimi i rezultateve të fituara, përfundimet dhe

vlerësimet e rezultateve të publikuara, si dhe idetë e reja për punën e mëtutjeshme. Në tryezë do të marrin pjesë ekipi i realizimit të projektit si dhe të gjitha palët e interesuara (ASHAK, FIEK, ARKEP, PTK, IPKO, RTP, etj.). Koha e mbajtjes së tryezës do të përcaktohet varësisht nga rrethanat.

Këshilli organizativ është caktuar nga Seksioni i Shkencave të Natyrës të ASHAK- ut dhe përbëhet nga: anëtare korrespondente Myzaferë Limani, akademik Isuf Krasniqi dhe anëtar korrespondent Qami Haxhibeqiri.

Shpenzimet e parapara për këtë aktivitet janë të miratuara me planin e përgjithshëm buxhetor të projektit.

2. Organizimi i tryezës shkencore “Integriteti, etika dhe besueshmëria e institucioneve kërkimore shkencore”.

Organizimi i tryezës ka qenë e paraparë për vitin 2020 dhe 2021, por për shkak të pandemisë Covid 19, tryeza do të bartet dhe do të jetë pjesë e Programit të punës së Seksionit për vitin 2022. Kjo tryezë do të organizohet në bashkëpunim me të gjitha seksionet e ASHAK- ut, të cilat janë të përfaqësuara në Këshillin organizues, që e ka propozuar Kryesia e Akademisë dhe përbëhet nga: anëtare korrespondente Myzaferë Limani, kryesuese dhe akademik Eqrem Basha, akademike Justina SH. Pula, anëtar korrespondent Fetah Podvorica dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, anëtarë.

Puna në institucionet kërkimore shkencore dhe komuniteti i shkencëtarëve si pjesë e tyre janë të lidhur me një sërë vlerash, traditash dhe standardesh që përfshijnë ndershmërinë, integritetin, objektivitetin, besueshmërinë dhe

kolegjialitetin. Këto vlera, si dhe vlerat dhe praktikat e veçanta të disiplinave specifike shkencore, duhet të reflektohen në punën tyre në vazhdimësi. Arsimi, shkenca dhe përhapja e njohurive në shoqërinë kosovare tradicionalisht kanë gëzuar një pozitë të dalluar dhe kjo shoqëri ka mirëpritur kontributet krijuese dhe inovatore të shkencëtarëve në të gjitha fushat. Sot, fushat shkencore janë gjithnjë e më të ndërthurura me çështje sociale, filozofike, ekonomike dhe politike, prandaj prej shkencëtarëve pritet që të bëhen më të përgjegjshëm ndaj shoqërisë. Ky moment është shumë i rëndësishëm që shkencëtarët individualë dhe institucionet e tyre përkatëse t'i rivlerësojnë vlerat dhe praktikat profesionale që udhëheqin kërkimet e tyre, si dhe përpjekjet e tyre për kryerjen e punës me integritet.

Besimi i shoqërisë dhe mbështetja e kërkimit shkencor bazohet kryesisht në besimin e publikut në integritetin e kërkuesve individualë dhe institucioneve të tyre. Niveli i besimit që karakterizon shkencën dhe marrëdhëniet e tij me shoqërinë ka kontribuar në një periudhë të diskutimeve mediale të pashembullta. Por, ky besim i diskutuar imponon dialogun e hapur dhe të sinqertë, së pari nga bashkësia shkencore për të ilustruar dhe transmetuar vlerat që lidhen me sjelljen shkencore etike. Prandaj është detyrë e të gjithë shkencëtarëve dhe institucioneve shkencore që të krijojnë dhe edukojnë një mjedis kërkimor që promovon standarde të larta etike, kontribuon në zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe ruan besimin e publikut në kërkimet shkencore.

Qëllimet e tryezës së propozuar janë: njohja dhe identifikimi i sfidave etike me të cilat ballafaqohem të gjitha institucionet kërkimore shkencore; sqarimi i pritjeve dhe standardeve të sjelljes; pritjet dhe standardet e sjelljes; ndërtimi i vetëdijes së përbashkët për këto çështje dhe sigurimi i një kornize për diskutim dhe veprim në mënyrë që të ngritet vetëdija jonë e përbashkët për këto çështje.

Koha e mbajtjes së tryezës do të përcaktohet varësisht nga rrethanat. Shpenzimet e parapara për këtë aktivitet: rreth 60 pjesëmarrës dhe pubilikimi i materialeve të konferencës në përmbledhje të punimeve rreth 3200 euro.

3. Organizimi i simpoziumit shkencor “Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm”. Edhe ky simpozium ishte paraparë të organizohet gjatë vitit 2020 pastaj gjatë vitit 2021. Për shkak të rrethanave tani më të njohura edhe ky simpozium do të bartet dhe do të jetë pjesë e Programit të punës së Seksionit për vitin 2022.

Energjia është faktori kryesor për jetën dhe mirëqenien e njeriut dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të një vendi. Zhvillimi i hovshëm tekniko-teknologjik ka mundësuar shtimin e potencialeve për shfrytëzim të burimeve konvencionale dhe atyre jokonvencionale të energjisë. Megjithatë shfrytëzimi i madh i disa prej këtyre resurseve ka shkaktuar ndotje në shkallë të gjerë të mjedisit në kuadër të planetit për shkak të emitimit të madh të CO2 dhe mbetjeve të tjera kimike. Prandaj së fundmi janë shtuar në shkallë të gjerë kërkesat për energji të pastër dhe të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i

qëndrueshëm ekonomik i secilit vend duke kërkuar shtimin e shfrytëzimit të energjive të regjenerueshme të energjisë në periudhën afatshkurtër dhe sidomos atë afatmesme.

Qëllimi i simpoziumit është që të trajtohen të gjitha aspektet e shfrytëzimit të potencialeve energjetike të vendit tonë dhe të rajonit në kuadër të kërkesave globale për energji të pastër.

Në kuadër të konferencës do të ketë fokusim në burimet energjetike të vendit tonë dhe shfrytëzimin sa më efikas të tyre në pajtim me kërkesat për energji të pastër.

Organizator: Seksioni i Shkencave të Natyrës dhe ai i Shkencave Shoqërore të ASHAK- ut dhe Këshilli organizativ është caktuar nga Seksioni i Shkencave të Natyrës në përbërje prej akademikëve: Nexhat Daci, Isuf Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Justina SH. Pula dhe një anëtar nga ASHSH- ja.

Shpenzimet e parapara për këtë aktivitet: rreth 70 pjesëmarrës dhe pubilikimi i materialeve të simpoziumit në përmbledhje të punimeve rreth 3700 euro.

BOTIME

1. Revista “Resarch (Kërkime)” nr. 26. Numri 26 i revistës “Research (Kërkime)” mendohet të botohet në gjysmën e dytë të vitit 2022. Në këtë revistë botohen punimet origjinale shkencore, të cilat i përkasin Seksionit të Shkencave të Natyrës.

AKTIVITETE TË TJERA

1. Pjesëmarrja aktive e anëtarëve të Seksionit në aktivitete shkencore ndërkombëtare që organizohen nga institucionet akademike e shkencore, me të cilat ASHAK- u ka bashkëpunim e në veçanti me Akademinë Gjermane të Shkencave- Leopoldina dhe ALLEA.

Sekretari i Seksionit,
Anëtar korrespondent
Fetah Podvorica, d. v

SEKSIONI I ARTEVE

BOTIME

1. Akademik Rauf Dhomi: Tituj të veprave kamerale

Muzika klasike- serioze kryesisht studiohet dhe interpretohet nga artistët - instrumentistët apo solistët, si dhe nga institucionet artistiko muzikore. Këto institucione apo shkolla shqipe janë të përhapura në të gjitha qytetet e Kosovës, Shqipërisë Maqedonisë, Malit të Zi e gjetiu dhe në të gjitha këto institucione kryesisht studiohen lëndët artistike interpretuese si kitara, piano forte, violina, violonçela, flauti, klarineta, solo këndimi, këndimi koral, si dhe shumë instrumente të tjera si frymoret, harkoret etj.

Numri i këtyre institucioneve muzikore është shumë i madh. Në të gjitha institucionet muzikore për studime dhe interpretime shfrytëzohen veprat e kompozitorëve të të gjitha kohërave dhe stileve të ndryshme duke i përfshirë prej antikës deri në ditët e sotme.

Meqë në të gjitha institucionet muzikore, por edhe në koncerte individuale- artistike është obligative dhe studimi i literaturës shqipe të kompozitorëve shqiptarë, dhe kjo literaturë, për fat të keq, është shumë e mangët për të gjithë artistët interpretues të lartcekur, është e nevojshme të kontribuohet në plotësimin e kësaj mangësie numerike.

Botimi i një numri të veprave kamerale do të jetë një kontribut i vogël në këtë drejtim.

Veprat e përzgjedhura për botim janë nga këto instrumente:

1. Kitarë
2. Violinë
3. V. Çelo
4. Solo kengë+pf.
5. Korale acappello
6. Flaute+pf.
7. Duet. Trio. Kuartet.
8. Muz. kamerale

Dorëshkrimi do të këtë rreth 500 faqe.

2. Akademik Zeqirja Ballata: "Punime studimore për artin muzikor". - Titull pune.

Studimi në fjalë, me mbi 20 punime, ka për trajtim tema esenciale të artit dhe studimit të tij muzikor, përfshirë këtu mbi 20 studime, të gjitha të krijimtarisë muzikore të kompozitorëve fazash të gjera krijuese përbrenda Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, por edhe prej vendeve të tjera, ku veprojnë e krijojnë kompozitorët shqiptarë. Një pjesë e këtyre punimeve, por tani të zgjeruara, janë botuar më parë, kryesisht, në revista të ndryshme, para së gjithash në Kosovë, pastaj në

Shqipëri, por edhe në disa republika të ish-Jugosllavisë, madje – shumë prej tyre në Slloveni.

Gjatë kësaj periudhe, krahas ekzekutimeve dhe botimeve të veprave të mia, jo vetëm në Kosovë e republika të tjera të ish-Jugosllavisë, më janë ekzekutuar edhe një varg veprash me sukses jashtë Jugosllavisë: Itali, Austri, Çeki, Bullgari, SHBA, Turqi. . .

Punimet studimore, para së gjithash, mbi krijimtarinë e kompozitorëve tanë dhe përgjithësisht shqiptarë, më janë botuar edhe në vijimësi. . . Kështu, kanë rezultuar edhe këto punime të shkruara mbi veprat e kompozitorëve tanë.

Së këndejmi krahas, si kompozitor, më janë botuar edhe një mori punimesh muzikologjike, para së gjithash, mbi kompozitorët tanë nga kudo që janë.

Dorëshkrimi do të këtë rreth 350 faqe.

3. Akademik Vasil Tole: "Zadeja, fenomeni muzikor shqiptar"

Jeta dhe vepra e Çesk Zadejës, botohet në 95 -vjetorin e lindjes dhe 25 vjetorin e ndarjes nga jeta.

Ky libër studimor i kushtohet Çesk Zadejës, kompozitorit dhe personalitetit më të rëndësishëm të muzikës shqiptare, pa rolin, veprimtarinë dhe krijimtarinë e të cilit nuk mund të kuptohet muzika profesioniste shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX, e më pas. Shkrimi i këtij punimi për të, i quajtur "profesor i profesorëve", "më i madhi kompozitor shqiptar i shek. XX", e mbi të gjitha "babai i muzikës shqiptare" erdhi natyrshëm, i kushtëzuar nga rrethanat dhe i ndikuar nga fakti, që ende nuk kemi një botim shterues për këtë personalitet unik të muzikës sonë edhe pse shkoi mbi një çerek shekulli nga vdekja e tij.

Deri më sot studimet e fushës i janë kushtuar kryesisht eksplorimit të muzikës shqiptare në qasjen historike, të etapave të saj, deri diku të analizave të ngushta të veprave muzikore të kompozitorëve, e fare pak përmes shqyrtimit dhe konsiderimit të rolit vendimtar që ka në krijimtarinë muzikore të një vendi, modeli krijues i një kompozitori të caktuar ose i një grupi syresh. Rëndësia e rolit të kompozitorit në kulturën tonë muzikore është bërë deri diku kur janë theksuar rëndësia e veprave të para të mëdha të muzikës sonë profesioniste, ku krahas veprës është folur disi edhe për krijuesin e saj, dhe vetëm kaq. Më pas, historia vazhdon rrugën e saj pa kthim pas, në rend kronologjik, veprat dhe krijuesit i zënë vendin njeri-tjetrit dhe gradualisht zërat e përveçëm, ata që kanë bërë realisht dhe cilësisht ndryshimin, fillojnë e shuhen brenda sasisë së konsiderueshme të veprave muzikore që u shkruan në Shqipëri për gati 50 vjet.

Muzika ashtu si artet e tjera nuk mund të bëjë dot pa hierarkinë e autorëve. Edhe në muzikën botërore, nga dhjetëra e qindra emra kompozitorësh, janë disa që i japin frymën epokës së tyre, përmes veprave dhe gjenialitetit që mbartin. Të tillë ishin Bahu, Mozarti, Hajdeni, Beethoveni, Bramsi, Wagneri, Çajkovski, Shopeni, Raveli, Skriabini, Stravinski, Bartoku, Prokofievi, Shostakoviçi etj, etj. Një i tillë për muzikën tonë ishte Zadeja. Ai nuk ishte thjesht një ndër kompozitorët më të mirë shqiptarë të shek. XX, por figura qendrore e muzikës së kultivuar shqiptare për atë shekull, e jo vetëm. Në këtë libër Zadeja dhe krijimtaria e tij trajtohet së bashku me rrethanat kulturore, historike e politike që ndikuan kohën kur ai jetoi. Posaçërisht

një vend të rëndësishëm zë trajtimi i figurës së Zadejës si themelues i parimeve të “Shkollës kombëtare në muzikë” dhe raporti i krijuesit gjatë diktaturës me ndikimet ideologjike dhe me metodën e “realizimit socialist”. Ndër të tjera, për të parën herë në libër vjen i plotë opusi i gjerë i krijimtarisë së tij shoqëruar me analiza të veprave kryesore, si dhe kontributi i tij muzikologjik përmes evidentimit të të gjitha shkrimeve dhe artikujve të botuara në shtypin shqiptar etj. Prandaj menduam që ta trajtonim figurën dhe veprën e tij të jashtëzakonshme në këtë libër në titullin “Çesk Zadeja në muzikën shqiptare”, (Jeta dhe vepra), i cili duke u fokusuar te personaliteti dhe vepra që la pas, do të na bëjë të kuptojmë më mirë edhe muzikën shqiptare, para dhe pas kohës së tij. Dorëshkrimi do të këtë rreth 650 faqe.

AKTIVITETET ARTISTIKE

1. Ekspozita me vepra të artit pamor, të artistëve kosovarë. Për secilën ekspozitë do të përgatitet katalogu.
2. Koncert artistik me vepra të kompozitorit të mirënjohur Çesk Zadeja, me rastin e promovimit të botimit: “Zadeja, fenomeni muzikor shqiptar”.

Koordinatorë të këtij aktiviteti janë propozuar akademik Rauf Dhomi dhe akademik Vasil Tole.

Sekretari i Seksionit Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, d. v.

PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS



PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

PROCESVERBAL

Nga mbledhja CIII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 24 shkurt 2021, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Edi Shukriu, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Justina Pula, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Bardh Rugova, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Luan Mulliqi, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Shumbin Munishi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, i cili e propozoi rendin e ditës dhe kërkoi miratimin e Kuvendit.

H. Islami në diskutimin e tij kërkoi që pika 4 (Shqyrtimi dhe miratimi i projekt- idesë dhe propozimi i anëtarëve të grupeve punuese për hartimin e platformave për Enciklopedinë shqiptare, Fjalorin e madh të gjuhës shqipe dhe Kuvendin e studimeve albanologjike) të hiqet nga rendi i ditës. Ai tha se kjo pikë e rendit të ditës të kthehet për diskutim së pari nëpër seksione e më pas të diskutohet

në një mbledhje tjetër të Kuvendit. Kryetari Kraja tha se sqarimin pse duhet të diskutohet kjo pikë sot në Kuvend e ka paraqitur në shkresën e cila fillimisht është miratuar nga Kryesia e Akademisë dhe u është dërguar me materiale të gjithë anëtarëve të Akademisë. Ai tha se është mirë që sot të caktohen grupet punuese të cilat do t'i hartojnë platformat e më pas miratimin e platformave e bën Kuvendi i Akademisë. Diskutuan edhe R. Ismajli, A. Aliu, S. Hamiti dhe pas diskutimeve Kuvendi vendosi që pika 4 të hiqet nga rendi i ditës, diskutimi për projektet e paraqitura në pikën 4 të kthehet nëpër seksione dhe më pas në Kuvend.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CII të Kuvendit të Akademisë;
2. Miratimi i Raportit të punës së Akademisë për vitin 2020;
3. Miratimi i Raportit financiar të Akademisë për vitin 2020;
4. Çështje vijuese.

Ad. 1. -

Procesverbali i mbledhjes CII të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2. -

Pra fillimit të shqyrtimit të Raportit të punës së Akademisë për vitin 2020, kryetari Kraja paraqiti një rekapitullim të punës për vitin 2020. Ai në fjalën e tij tha:

“Sikundër që tashmë është e njohur, viti i shkuar, për shkak të pandemisë, ka qenë një vit i vështirë për të gjithë ne, një vit i vështirë për të gjithë institucionet e vendit dhe, vetëkuptohej, edhe për Akademinë. Prandaj programi i punës, të cilin po e shqyrtojmë sot, ka mungesat e veta krejtësisht të arsyeshme dhe të paevitueshme.

Megjithatë, edhe përkundër kësaj vështirësie, Akademia ka arritur të ruajë vazhdimësinë e punës dhe të aktiviteteve të saj, të ruajë qëndrueshmërinë institucionale dhe të zhvillojë një aktivitet ndonjëherë gati alternativ, në mënyrë që, për aq sa ishte e mundur, të mos binte në vakuum programor.

Mbështetja kryesore e Akademisë, edhe në këtë rast ka qenë puna individuale e anëtarëve të saj. Vepra të rëndësishme janë realizuar nga anëtarët e Akademisë dhe unë me këtë rast dua t’i përgëzoj ata për përkushtimin dhe profesionalizmin, që edhe në një kohë të këtillë kanë pasur kurajë t’i përkushtohen punës së tyre shkencore dhe artistike.

Por pavarësisht nga kjo, programi i punës i Akademisë gjatë vitit të shkuar i ka pasur mungesat e veta, veçmas në format paraqitjes publike, siç janë konferencat dhe tryezat shkencore, pastaj ekspozitat, koncertet, promovimet dhe aktivitetet tjera, të cilat implikojnë përfshirje më të madhe të një audience më të gjerë shkencore dhe artistike.

Ideja për ta hapur Akademinë ndaj një audience më të gjerë shkencore dhe artistike natyrisht që ka pësuar një goditje të rëndë, por jo të pariparueshme. Synimi për të mbajtur një komunikim intensiv të Akademisë

me opinion publik po ashtu pësoi shumë, sepse reduktimi i veprimtarive ose pezullimi i tyre e la këtë komunikim pa një subjekt substancial.

Ishte vetëm politika ajo që funksionoi pa ndonjë pengesë të madhe, por Akademia si institucion arriti të mbahej jashtë ndikimeve dhe përdorimit të saj për kauza të politikës ditore.

Megjithatë, me gjithë vështirësitë, gjatë vitit të kaluar ne arritëm të zhvillonim një proces normal, përgjithësisht të suksesshëm, të zgjedhjeve të anëtarëve të rinj dhe të përparimit të anëtarëve korrespondentë në anëtarë të rregullt të Akademisë. Me këtë rast nuk mendoj se nuk duhet të komentohen rezultatet, por vetëm procesi, i cili i përmbushi të gjitha standardet dhe parametrat e rregullativës ligjore dhe statutore.

Por, më lejoni të them këtu se, nga rrethanat e pandemisë u godit edhe njëra nga shtyllat themelore të programit të punës së Akademisë, që është veprimtaria botuese, e cila pësoi vonesa të mëdha, një herë për shkak të pandemisë, deri në qershor të vitit 2020, dhe pastaj për shkak të procedurave të tenderimit, të cilat u tërhoqën zvarrë për disa muaj me radhë, zvarritje kjo që nuk u tejkalua as me ndërhyrje në OSHP. Kjo bëri që dalja e pothuajse të gjithë botimeve të Akademisë të vitit 2020 të zhvendosen në dy muajt e parë të këtij viti. (Sot mbërrijnë në Akademi 16 vepra, tashmë të shtypura dhe të përfunduara.)

Ndërkohë, edhe përkundër kësaj situatë, Akademia arriti të realizojë tre projekte alternative: një raport për dialogun me Serbinë; raportin për energjinë dhe të hartojë një platformë

gjithëpërfshirëse për arsimin, e cila tashmë është gati.

Ndryshe nga “Raporti për energjinë”, ne realizimin e të cilit u përfshinë pothuajse të gjithë anëtarët e Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe si rezultat doli një studim i plotë dhe gjithëpërfshirës, raporti për dialogun me Serbinë u refuzua nga seksioni përkatës dhe nga synimi për të qenë një punë ekipore, u desh të përfundonte në një projekt autorial.

Afërsisht e njëjta gjë ndodhi edhe me platformën për arsimin, e cila tashmë është realizuar (mbetet vetëm të caktohet koha kur do të bëhet publike), por me një vërejtje substanciale, se hartimi i kësaj platforme u bë nga sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore (i shpreh mirënjohje për punën e bërë) dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, me një pjesëmarrje dhe ndihmë minimale të anëtarëve të Akademisë.

Një projekt tjetër alternativ është edhe biblioteka: është në realizim e sipër ideja që biblioteka e Akademisë të bëhet bibliotekë e specializuar për botimet për Kosovën në gjuhët e ndryshme të botës. Projekti është ambicioz dhe kërkon kohë që të realizohet.

Dua të tërheq vëmendjen tuaj edhe për disa çështje që lidhen me këtë raport vjetor:

- E para, efikasiteti i administratës. Ende nuk është arritur që shërbimet e administratës të vihet në funksion të plotë të stafit akademik. Administrata ende synon të bëhet një akademi më vete brenda Akademisë. Për ta evituar këtë situatë, është vendosur që të gjitha vendimet financiare, me transparencë të plotë, të kalojnë në vendimmarrje të plotë të Kryesisë,

pavarësisht se për çfarë niveli të shpenzimeve bëhet fjalë. Më anë tjetër, të gjitha daljet financiare, blerjet, tenderimet etj., përveç që duhet të miratohen nga Kryesia, ato duhet të mbikëqyren nga stafi akademik.

(Megjithatë, kësaj administrate i duhet njohur merita dhe vullneti i mirë, për të rritur financiarisht të ardhurat e stafit akademik, përmes gjetjeve ligjore, që bënë që shpërblimet e akademikëve të mos përfshihen në tatimin e të ardhurave).

- E dyta, mirëmbajtja e objektit, i cili, për shkak të punimeve jocijësore tashmë kishte filluar të degradonte. Janë bërë disa ndërhyrje, që duhet të vazhdojnë dhe të cilat bëhen kryesisht pa shpenzime financiare, sepse merren përsipër nga ministria përkatëse, por kërkojnë impenjim të vazhdueshëm.

- Në të ardhmen duhet të evitohet përfshirja në programin e punës së Akademisë të projekteve që nuk realizohen;

- E treta, duhet nxitur një kohezion më të madh dhe bashkëpunim ndërmjet seksioneve. Seksionet dhe as individët (çdo respekt për punën e tyre), nuk duhet të bëhen akademi brenda Akademisë;

- E katërta, është një e arritur e mëhershme që botimet e Akademisë, shumica syresh, tashmë janë të një niveli të mirë shkencor, por tani mbetet të bëhet një punë më e madhe redaktoriale dhe në standardizim i aparaturës shkencore dhe i paraqitjes së saj përmbajtësore dhe grafike. Në këtë pikë kërkohej angazhim më i madh i sekretarëve të seksioneve, të cilët njëkohësisht janë edhe redaktorë të botimeve;

- E pesta, mbetet të bëhet një punë më e madhe në standardizimin e revistave, të cilat gjithashtu kërkojnë redaktim dhe përzgjedhje të teksteve, pajisje me aparaturë shkencore etj. ;

- E gjashta, aktivizimi dhe përditësimi i faqes së internetit, qoftë i biografive dhe bibliografive të akademikëve, përfshirë edhe botimet e tyre dhe aktivitetin e tyre akademik, shkencor dhe artistik.

- E shtata, mungon një elaborat për një projekt konkret për funksionalizimin e Qendrës Leksikografike Enciklopedike, nuk mungojnë as mjetet financiare as pajisjet teknike.

- Dhe e teta, këtij raporti të punës i mungojnë raportet e komisioneve, të cilat edhe për aq sa kanë punuar, nuk kanë paraqitur përshkrim të punës së tyre në formë të përmbledhur”.

Më pas filloi shqyrtimi i Raportit të punës me radhë duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet dhe SHPAT-i. Në diskutimin e tij M. Dushi paraqiti disa vërejtje, së pari për procesin e zgjedhjeve për anëtarë të Akademisë. Ai tha se zgjedhjet nuk është dashur të mbahen në një situatë pandemike dhe se shqetësimin ia ka përcjellë edhe Kryetari Kraja. Po ashtu ai paraqiti edhe vërejtje për prurjet e reja. Më pas M. Dushi diskutoi edhe një herë për projektin “Vendbanimet e Kosovës” duke paraqitur vërejtje për raportin e paraqitur për projektin në fjalë, ku ka munguar pjesa e arsytimit financiar.

Sa i përket mbajtjes së zgjedhjeve Kryetari Kraja sqaroi se mbajtja e zgjedhjeve me kohë është kërkesë ligjore dhe se të gjitha procedurat janë mbajtur në përputhje me masat anti Covid, ndërsa për anëtarët e zgjedhur ai tha se kjo çështje tani më ka përfunduar nëpërmjet të një procesi të

rregullt, transparent dhe me votën e secilit anëtar të Akademisë. Lidhur me vërejtjet për projektin” Vendbanimet e Kosovës” reagoi J. Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore. Ajo në fjalën e saj tha se projekti në fjalë i përket Seksionit të SHSH-së dhe se në Seksion janë dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme të cilat i janë përcjellë edhe Kryesisë dhe Kuvendit të Akademisë. Kjo çështje është diskutuar disa herë edhe në Kuvend dhe konsiderohet e mbyllur tani më. Ajo tha se ky lloj diskutimi që po përsëritet në disa kuvende radhazi duhet të tejkalohet. Dokumentet për projektin në fjalë i ka të gjitha SSSH-ja dhe si sekretare e Seksionit jam e gatshme t’ju ofroj të gjitha sqarimet që kërkoni, por kjo mënyrë e komunikimit duke etiketuar vazhdimisht emra të anëtarëve të Seksionit tonë është e papranueshme. Ajo po ashtu reagoi edhe për vërejtjet për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë duke thënë se nuk ka kuptim të zhvillohet një diskutim i tillë, procesi zgjedhor ka përfunduar, secili prej nesh ka votuar sipas bindjes së vet dhe secili mban përgjegjësi për votën e dhënë.

Pas diskutimeve Kuvendi e miratoi Raportin e punës së Akademisë për vitin 2020, i cili do të botohet në revistën Vjetari 2020.

Ad. 3. -

Kuvendi e shqyrtoi në vazhdim edhe Raportin financiar për vitin 2020. Kryetari Kraja tha se viti 2020 ishte vit i vështirë për shkak të pandemisë Covid-19. Gjatë vitit ka pasur shkurtime buxhetore dhe deklarim të kursimeve për shkak të pamundësisë për realizimin e aktiviteteve të parapara, dhe se të gjitha janë paraqitur në Raport.

Raporti financiar i Akademisë për vitin 2020 u miratua pa vërejtje.

Mbledhja u mbyll në orën 12:20

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

PROCESVERBAL

Nga mbledhja CIV e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 30 qershor 2021, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Edi Shukriu, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Justina Pula, Kujtim Shala, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Muhamedin Kullashi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Bardh Rugova, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Luan Mulliqi, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafere Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Shkumbin Munishi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CIV të Kuvendit të Akademisë;
2. Miratimi i Programit të punës të Akademisë, për vitin 2022;

3. Miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës të Akademisë, 2022-2025;

4. Çështje vijuese.

Para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës Kryetari Kraja në fjalën hyrëse theksoi:

“Të nderuar anëtarë të Akademisë,

Më lejoni që në fillim të shpreh kënaqësinë time që jemi këtu sërish në një mbledhje të Kuvendit, të përfshirë nga një ndjenjë lehtësimi, meqë kaluam së bashku një periudhë të vështirë, pa përjetuar pasoja dhe dhembje të reja, të shkaktuara nga pandemia dhe pasojat e saj.

Me gjithë vështirësitë, gjatë këtyre muajve, që nga mbledhja e fundit e Kuvendit, mund të themi se Akademia ka arritur ta ruajë vazhdimësinë e punës dhe të aktiviteteve të saj, të zhvillojë veprimtaritë themelore dhe të ruajë qëndrueshmërinë e institucionit.

Edhe gjatë kësaj periudhe mbështetja kryesore e Akademisë ka qenë puna individuale e anëtarëve të saj, të cilët, me gjithë vështirësitë dhe atmosferën jo të përshtatshme, kanë arritur të realizojnë vepra të rëndësishme nga fushat e ndryshme të shkencës dhe të arteve. Ata dua t’i përgëzoj me këtë rast për përkushtimin dhe profesionalizmin.

Lehtësimi gradual i masave anti- covid bëri që Akademia, së fundi, të bëjë përpjekjet e para të kthimit në normalitet, duke rikthyer në agjendë aktivitete nga programi i punës, siç është veprimtaria botuese, por edhe disa projekte alternative, siç i kam quajtur unë, siç ishte paraqitje publike e platformës për arsimin dhe projekti për ekonominë në hije, pastaj radhazi promovimi i botimeve të reja nga të

katër seksionet: “Leksikoni i vendbanimeve”, pastaj “Demografia e Kosovës” e akademik Hivzi Islamit, vepra e Norbert Joklit “Studime historiko- krahasuese për gjuhën shqipe”, “Studime albano-ballkanologjike” të Brian D. Joseph- it, “Leksikoni i termave të sociolinguistikës”, promovimi i botimit të veprës muzikore të akademik Rauf Dhomit dhe, së fundi, paraqitja publike e veprës “Komforti termik” i akademik Fejzullah Krasniqit dhe prof. Rexhep Selimajt.

Ndryshe nga viti i kaluar, kur u paraqiten vështirësi administrative në punët botuese, sivjet mund të thuhet se kjo veprimtari është duke ecur më mirë, duke e pasuruar tashmë fondin e botimeve të Akademisë me vepra të reja dhe të rëndësishme nga fushat e ndryshme të shkencave dhe të arteve.

Përveç veprave që kanë qenë të përfshira në planin botues të vitit 2021, në planin botues kemi përfshirë edhe përmbledhjen e dokumenteve të GJND-së (Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë), dokumente që nuk janë botuar më herët në gjuhën shqipe. Besojmë se ky botim paraqitet me interes jo vetëm për specialistët e fushës, por edhe për opinionin e gjerë.

Pas kësaj periudhe të pandemisë, kam shpresë se Akademia do të intensifikojë edhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Më lejoni që me këtë rast të falënderoj Komisionin për Marrëdhënie Ndërkombëtare, i cili ka qenë aktiv dhe ka mbushur deri- diku vakuumin që është krijuar në komunikim ndërkombëtar, për shkak të rrethanave të pandemisë, duke iu përgjigjur ftesave të ndryshme qoftë nga ALLEA, qoftë nga akademitë evropiane, me të cilat Akademia jonë ka bashkëpunim të rregullt.

Më anë tjetër, më duhet të them se kemi bërë përpjekje, përmes anëtarit të jashtëm të Akademisë sonë nga Akademia e Maqedonisë së Veriut të rifillojmë bashkëpunimin me këtë Akademi, por deri më tani, ndoshta për shkak të ndërrimit të udhëheqjes së atjeshme, ende nuk kemi gjetur mirëkuptim për t’i rivendosur këto marrëdhënie në binarë normalë.

Me Akademinë e Shqipërisë puna kryesore është përqendruar në përgatitjen e Konferencës së Albanologjisë, e cila, ashtu siç është paraparë me protokollin e bashkëpunimit, do të mbahet në fund të nëntorit të këtij viti, në bashkëpunim të dy akademive dhe me një pjesëmarrje të gjerë të studiuesve të të gjitha fushave të studimeve albanologjike.

Ndërkohë, për projektin e Enciklopedisë shqiptare, siç e dini, është konstituuar grupi i punës, në përbërjen e të cilit janë përfshirë përfaqësuesit e të gjithë seksioneve. Ky grup i punës e ka hartuar një propozim-platformë, e cila është finalizuar, por me pak vonesë për t’u përfshirë në materialet e kësaj mbledhjeje të Kuvendit. Në procedurën e mëtejshme, pas shqyrtimit fillestar të bërë në Kryesi, do të kalojë për shqyrtim nëpër seksione, t’u dërgohet të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe më pas të harmonizohet edhe me platformën e korrigjuar dhe të ndryshuar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ajo nuk do të bëhet dokument i Akademisë, pa marrë miratimin e këtij Kuvendi, ashtu siç jemi marrë vesh në mbledhjen e kaluar.

Në fund, më lejoni t’i theksoj edhe dy gjëra: për vitin e ardhshëm kemi një zvogëlim të buxhetit për 58 mijë euro

në krahasim me këtë vit, prandaj programi i punës së Akademisë për vitin 2021 duhet të harmonizohet me këtë mundësi buxhetore, duke u përpjekur që disa veprimtari themelore të Akademisë të mos cenohen në asnjë mënyrë.

E fundit: raporti i auditorit për vitin 2020, ashtu si edhe ai për vitin 2019, nuk ka asnjë gjetje dhe asnjë rekomandim.

Ju faleminderit”

Ad. 1. -

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan M. Dushi dhe R. Ismajli.

M. Dushi në diskutimin e tij tha se procesverbalin është përmbytësor dhe pasqyron deri diku diskutimin e tij në mbledhjen e fundit. Ai po ashtu e lavdëroi punën e udhëheqjes së Akademisë dhe të Administratës së saj, në rrethana të rënda pandemike. Sa i përket pjesës për zgjedhjet e fundit në Akademi ai tha se nuk është paraqitur në procesverbalin e gjithë diskutimi i tij. Ai në vazhdim tha se nuk e mohon që zgjedhjet kanë kaluar mirë dhe sipas procedurave përkatëse, por se theksi i diskutimit të tij ka qenë çështja e kriterëve. Sipas tij në Seksionin e Shkencave Shoqërore janë shkëlqur kriteret, sepse anëtar i Akademisë nuk mund të zgjidhet personi që nuk e ka arritur gradën shkencore më të lartë në institucionin prej nga ka ardhur propozimi (UP apo institutet).

Lidhur me këtë reagoi Kryetari Kraja, i cili tha se Ligji dhe Statuti i Akademisë nuk përcaktojnë kriteret të tilla dhe e përsëriti edhe një herë se procedura e zgjedhjeve është zhvilluar në përputhje me aktet normative të Akademisë.

R. Ismajli në diskutimin e tij tha se në procesverbalin ka një shënim për QLE- në.

Ai tha se ka elaborat për QLE- në, ka rregullore por ajo duhet të rishikohet dhe të vazhdojnë procedurat e funksionalizimit të saj.

Kryetari Kraja tha se Kryesia ka marrë vendim për riangazhimin e punonjësve në QLE, për vazhdimin e punëve të projektit “Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX”, i cili ka filluar punën në muajin prill të këtij viti. Ai tha po ashtu se, Qendra mund të punojë vetëm kur ka projekte konkrete.

Pas diskutimeve Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes CIII, pa ndryshime.

Ad. 2. -

Kuvendi filloi shqyrtimin e Programit të punës për vitin 2022 me rend sipas seksioneve. Kryetari Kraja tha se sekretarët e seksioneve mund të japin sqarime nëse kërkohet. Gjatë shqyrtimit të programit të punës së SGJL- së, E. Basha tha se nuk ka asgjë për të shtuar, por se është i gatshëm të ofrojë sqarime nëse kërkohet.

H. Islami në diskutimin e tij tha se vitin që shkoi, kishte ngecje në realizimin e botimeve. Pavarësisht nga situata pandemike disa punë kanë mundur të shtyhen, por ka munguar angazhimi i Komisionit të vlerësimit për shtypjen e botimeve.

Sa i përket programit të SGJL- së ai tha se marrë në përgjithësi programi është i pasur, ka propozime të mira e sidomos propozimi për projektin Historia e letërsisë shqipe, është shumë i rëndësishëm dhe duhet të përkrahet, por paraqiti vërejtje për dy pika të propozuara: dorëshkrimin të Skender Gashit, duke thënë se ASHAK- u ka botuar disa herë libra të autorit në fjalë e meqë tani ai nuk jeton më ky propozim nuk do të duhej të përfshihej

në program dhe propozimi i Kujtim Shalës për të cilin tha se çdo vjet boton nga një libër. Ky oportunizëm, siç tha ai, duhet të ndalet nga Seksioni.

Lidhur me programin e punës së SSHN-së, H. Islami tha se është i varfër, nuk ka asgjë, vetëm bartje nga vitit paraprak. Në këtë Seksion ai tha se ka dukuri të nepotizmit, sepse në projekte përshihen familjarë të autorëve apo bartësve të projekteve. Lidhur me këtë ai shtroi dy pyetje për Kryesinë e Akademisë:

1. A është e vërtetë se Kyesia ka marrë vendim t'u paguhen shpenzimet e publikimeve në revista shkencore familjarëve të anëtarëve të Akademisë? dhe

2. A është e vërtetë se sekretarja Shkencore e Akademisë e dërgon vajzën e saj ta përfaqësojë Akademinë në konferenca ndërkombëtare me kompensim?

Lidhur me vërejtjet e H. Islamit për SGJL- në, Kryetari Kraja tha se dorëshkrimi i Skender Gashit është diskutuar disa herë dhe meqë recensentët kanë dhënë vlerësim pozitiv është vendosur të përfshihet në program, ndërsa sa i përket asaj që një autor boton çdo vit radhazi, kjo dukuri nuk është vetëm në SGJL, por ka edhe në seksionet e tjera autorë që botojnë vit pas viti radhazi. Edhe E. Basha për botimin e Skender Gashit e pohoi arsyetimin e Kryetarit Kraja.

Lidhur me pyetjen e parë të H. Islamit, Kryetari Kraja tha se përgjigjet do t'i paraqesë Sekretari i SSHN- së.

Pas këtyre diskutimeve u miratua programi i punës së SGJL- së, pa ndryshime dhe u shqyrtua programi i punës së SSHSH- së. J. SH. Pula paraqiti në pika të shkurtra arsyetimet për pikat

e propozuara dhe programi i punës së SSHSH- së, u miratua po ashtu pa ndryshime.

Gjatë shqyrtimit të programit të punës së SSHN- së, F. Podvorica tha se si Seksion jemi munduar t'i respektojmë masat për parandalimin e pandemisë Covid- 19 dhe me qëllim të kujdesit ndaj shëndetit të të gjithëve i kemi ndërprerë shumë punë dhe aktivitete. Ai tha se nuk ka këtë vit propozime për botime, sepse autorët nuk kanë arritur t'i dorëzojnë dorëshkrimet e gatshme ashtu siç kërkohet me rregullore. Sa i përket botimit të dy anëtarëve tanë në revista ndërkombëtare me qasje të lirë, kjo është shumë e rëndësishme për ne. Lidhur me pagesat e projektit të M. Limanit, ai tha se të gjitha pagesat janë realizuar ashtu siç janë paraqitur në arsyetimin e projektit, i cili është miratuar në Seksion, Kryesi dhe Kuvend.

Pas diskutimeve u miratua edhe Programi i punës së SSHN-së pa ndryshime.

Në fund u miratua edhe Programi i punës së Seksionit të Arteve.

Programi i punës së ASHAK- ut për vitin 2022 do të botohet në Vjetari 2021.

Pas miratimit të Programit të punës diskutoi S. Hamiti. Ai paraqiti vërejtje për formën e hartimit të programeve dhe propozoi që në të ardhmen të koordinohen seksionet, ashtu që bëhet një standard i programit të punës për të gjitha seksionet. Ai më pas tha se seksionet kanë paraqitur projekte afatmesme dhe afatgjate dhe këto projekte kanë shpenzime financiare, prandaj duhet të punojmë që të bëjmë planifikim të mirë për realizimin e tyre.

Në fund S. Hamiti foli edhe për projektin: "Historia e letërsisë shqipe"

duke thënë se realizimi i tij kërkon mjete financiare të konsiderueshme dhe njoftimi se në vitin vijues ka shkurtime buxhetore është paksa shqetësues.

Kryetari Kraja tha se pavarësisht nga shkurtimet buxhetore do të bëjmë përpjekje që ky projekt i rëndësisë së veçantë të realizohet sipas planit.

Ad. 3. -

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi e shqyrtoi Planin strategjik gjithëpërfshirës të Akademisë, 2022- 2025. Me kërkesë të Kryetarit Kraja, M. Limani, kryesuese e grupit punues për hartimin e Planit strategjik gjithëpërfshirës e njoftoi Kuvendin me rrjedhën e punës. Ajo tha se grupi punues e ka hartuar draftin e Planit strategjik gjithëpërfshirës dhe më pas atë ua ka dërguar të gjithë anëtarëve të Akademisë duke ua lënë në dispozicion për rreth 15 ditë për të paraqitur vërejtje e propozime. Nga të gjithë anëtarët e Akademisë propozime me shkrim kanë paraqitur M. Dushi dhe H. Islami dhe një propozim është paraqitur nga Seksoni i Shkencave të Natyrës. Të gjitha këto propozime grupi punues i ka miratuar dhe i ka përfshirë në draftin që sot e kemi përpara për shqyrtim.

Në diskutimet e tyre S. Hamiti dhe R. Ismajli, paraqitën disa vërejtje dhe propozuan që të bëhen përmirësime dhe kësaj radhe të mos miratohet Plani strategjik. Diskutoi edhe M. Dushi, i cili tha se Plani strategjik është përmbajtësor, por se tek objektivat duhet të përfshihen edhe disa kritere për polemikat shkencore.

Pas diskutimeve Kryetari Kraja tha se hartimi i Planit strategjik është kërkesë ligjore dhe si institucion duhet ta kemi, por meqë ka vërejtje, ai propozoi që

drafti në fjalë t'u lihet edhe për një kohë në dispozicion të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe të miratohet në një mbledhje tjetër të Kuvendit.

Mbledhja u mbyll në orën 12:35

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

PROCESVERBAL

Nga mbledhja CV e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 9 dhjetor 2021, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Edi Shukriu, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Justina Sh. Pula, Kujtim Shala, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Muhamedin Kullashi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Luan Mulliqi, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafere Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Shkumbin Munishi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CIV të Kuvendit të Akademisë;

2. Caktimi i Komisionit të zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë;

3. Votimi për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë: Kryetarit, Nënkyetarit, Sekretarit shkencor dhe shpallja e rezultateve të votimit;

4. Miratimi i zgjedhjes së sekretarëve të seksioneve të Akademisë;

5. Çështje vijuese.

Para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës Kryetari Kraja njoftoi se përveç akademik Rexhep Qosjes, i cili nuk përfshihet në kuorum, mungon edhe anëtar korrespondent Xhevdet Xhafa, i cili ka njoftuar me kohë, se për arsye shëndetësore gjendet jashtë vendit dhe nuk mund të jenë prezent.

Ai propozoi që Kuvendi të marrë vendim për mospërfshirjen në kuorum të Xh. Xhafës dhe kërkoi nga Sekretarja e Akademisë ta paraqesë bazën ligjore.

L. Pula e njoftoi Kuvendin se Statuti i Akademisë, neni 29, paragrafi 14, përcakton se:” Kuvendi në mbledhjen përkatëse mund të vendosë që në kuorum të mos përfshihen anëtarët, të cilët për shkak të sëmundjes së gjatë ose për ndonjë arsye tjetër janë të penguar të marrin pjesë në punën e Akademisë”.

Kuvendi e miratoi propozimin e Kryetarit dhe vendosi që përveç R. Qosjes edhe XH. Xhafa të mos përfshihet në kuorum.

Më pas L. Pula me kërkesë të Kryetarit Kraja njoftoi se në sallë janë të pranishëm 37 anëtarë të Akademisë nga 39 sa janë gjithsej. Pas vendimit të Kuvendit që në këtë mbledhje të mos përfshihen në kuorum dy anëtarë të Akademisë, konstatohet se kuorumi për sot është 19, pra për Kryetar, Nënkyetar dhe Sekretar shkencor të Akademisë konsiderohet i zgjedhur

kandidati që fiton 19 vota. Nëse për funksionin e caktuar asnjëri nga kandidatët nuk fiton mbi gjysmën e numrit të votave (19), votimi përsëritet për kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave, ose për kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave.

Ad. 1. -

Procesverbali i mbledhjes CIV të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2. -

Kuvendi caktoi Komisionin e zgjedhjeve me këtë përbërje: Eqrem Basha, Myzafere Limani dhe Arsim Bajrami.

Ad. 3. -

Më pas u shpërndanë fletëvotimet për Kryetar të Akademisë.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Kryetarit të Akademisë: votuan 37 anëtarë të ASHAK- ut. U gjetën 29 fletëvotime të vlefshme dhe 8 fletëvotime të pavlefshme.

Akademik Mehmet Kraja mori 29 vota dhe u zgjodh Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Në vazhdim u shpërndanë fletëvotimet për Nënkyetar të Akademisë.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Nënkyetarit të Akademisë: votuan 37 anëtarë të ASHAK- ut. U gjetën 31 fletëvotime të vlefshme dhe 6 fletëvotime të pavlefshme.

Akademie Justina Sh. Pula mori 31 vota dhe u zgjodh Nënkyetare e

Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Sipas radhës u shpërndanë fletëvotimet për Sekretar shkencor të Akademisë.

Pas votimit me vota të fshehta, Komisioni i zgjedhjeve i numëroi votat dhe konstatoi se votimi ka dhënë këtë rezultat:

Për zgjedhjen e Sekretarit shkencor të Akademisë: votuan 37 anëtarë të ASHAK- ut. U gjetën 35 fletëvotime të vlefshme dhe 2 fletëvotime të pavlefshme.

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi mori 19 vota.

Anëtar korrespondent Bardh Rugova mori 16 vota.

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi u zgjodh Sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Ad. 4. -

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me ngritje të dorës miratoi në parim unanimisht zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve:

1. Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.
2. Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.
3. Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës.

Para miratimit të caktimit të Rauf Dhomit si ushtrues i detyrës së sekretarit të seksionit të Arteve diskutoi H. Islami.

Ai tha se zgjedhja e Rauf Dhomit U. D. Sekretar është në kundërshtim me Statutin e Akademisë dhe se Kuvendi nuk duhet ta miratojë. Ai tha se Kryesia nuk është dashur të caktojë grup punues, sepse nuk ka qenë asnjëherë praktikë në Akademi një gjë e tillë. Këtë

çështje ka mundur ta rregullojë Sekretarja e Akademisë. Edhe në të kaluarën Akademia ka pasur jurist si p.sh. Esat Stavileci, por i cili nuk është përfshirë në raste të tilla, me arsyetimin se çështje të tilla i përkasin Sekretarit të Akademisë. Seksioni i Arteve ka mundur të bëjë zgjidhje më efikase, ashtu që më mirë të caktohej U. D. Sekretari i deritanishëm edhe për një mandat sesa të caktohet një anëtar që i ka kaluar 75 vjet. Ne kemi pasur rast të njëjtë me Kryetarin Daci, por e kemi respektuar Ligjin dhe Statutin dhe atij i është ndërprerë mandati.

Kryetari Kraja njoftoi se Kryesia e Akademisë duke marrë parasysh që asnjëri nga anëtarët e Seksionit të Arteve nuk i plotëson kushtet ligjore për t'u zgjedhur Sekretar dhe duke konsideruar që duhet të gjendet një zgjidhje që Seksioni të mos mbetet pa udhëheqje ka ngritur një grup punues prej tre juristëve (L. Pula, A. Bajrami dhe Gj. Mushkolaj) për të paraqitur një zgjidhje për këtë çështje. Grupi punues e ka hartuar një propozim të cilin e ka miratuar Kryesia e Akademisë. Ai më pas kërkoi nga L. Pula të njoftojë për rrjedhën e procesit.

L. Pula tha se në bazë të propozimit të grupit punues të miratuar nga Kryesia e Akademisë, Seksioni i Arteve në mbledhje të rregullt me vota të fshehta e ka caktuar R. Dhomin U. D. Sekretar të Seksionit për periudhën katër vjeçare.

Caktimi i u. d. Sekretarit të Seksionit është bërë në bazë të Statutit të Akademisë, neni 14, paragrafi 3, që precizon se:

“3. Në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit të seksionit, seksioni me vendim të veçantë cakton një anëtar të tij ushtrues detyre të Sekretarit të seksionit”.

Gj. Mushkolaj në diskutimin e saj tha se grupi punues ka bërë propozim që Seksioni të caktojë ushtruesin e detyrës së Sekretarit të Seksionit, por ky grup nuk ka pasur informacione të mjaftueshme dhe nuk ka qenë në dijeni se kjo do t'i paraqitet Kuvendit për votim. Meqë tani Kryetari kërkoi që të bëhet edhe miratimi i caktimit të U. D të SA, ajo tha se kjo çështje nuk mund të shtrohet për votim në Kuvend, sepse për U. D. nuk votohet.

R. Ismaji dhe S. Hamiti në diskutimet e tyre thanë se letra dhe propozime të tilla nuk mund t'i servohen Kuvendit për votim, me këto çështje le të merret Kryesia e Akademisë, ashtu siç edhe ka caktuar grup punues për punë të tilla. Ata theksuan edhe një herë se Kuvendi i Akademisë nuk duhet të merret me çështje të tilla. Që të dytë po ashtu rikujtuan ndërprerjen e mandatit të Kryetarit Daci, për shkak të kufirit të moshës. A. Bajrami tha se një situatë e tillë nuk është e lehtë, por duhet të bëhet një zgjidhje dhe si grup kemi bërë një propozim duke menduar se Seksioni do ta caktojë U. D. Luan Mulliqin dhe se kjo çështje do të zgjidhet më lehtë, por Seksioni i Arteve ka vendosur ndryshe.

Pas diskutimeve Kryetari Kraja konstatoi se caktimi i R. Dhomit, ushtrues i detyrës së Sekretarit të Seksionit të Arteve për periudhën 4-vjeçare nuk u miratua. Ai më pas bazuar në diskutimet e Kuvendit propozoi që R. Dhomi të caktohet U. D. për periudhën 6-mujore, ndërsa deri në zgjedhjen e Kryesisë së radhës, Seksioni i Arteve çdo 6 muaj të caktojë me vendim ushtruesin e detyrës së Sekretarit të Seksionit dhe me atë vendim të njoftohet çdo herë Kryesia e Akademisë. Propozimi u miratua.

Mbledhja u mbyll në orën 12:15

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

KRONIKA E VITIT 2021

AMBASADORI I HUNGARISË, JÓZSEF BENCZE VIZITON ASHAK-un



Më 15 janar 2021 Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e vizitoi ambasadori i Hungarisë në Kosovë z. József Bencze i shoqëruar nga znj. Krisztina Szabó, atashe për Ekonomi dhe Tregti.

Ambasadori Bencze u prit nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja dhe bashkëpunëtorët: akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar, anëtare korrespondente Myzaferim Limani, sekretare shkencore, akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar të ASHAK-ut dhe anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar.

Takimi u zhvillua në atmosferë miqësore. Ambasadori Bencze njoftoi për aktivitetet që po realizon Ambasada e Hungarisë në fushën e shkencës dhe të arsimit. Kryetari Kraja po ashtu e njoftoi Ambasadorin se ASHAK- u ka pasur bashkëpunim edhe më parë me Ambasadën e Hungarisë dhe shprehu gatishmëri për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit.

Kryetari Kraja i bëri ftesë zyrtare

Ambasadorit për Kryetarin e Akademisë së Hungarisë, që në një kohë të përshtatshme të vizitojë ASHAK- un, ashtu që të bisedojnë për realizimin e projekteve të përbashkëta.

CEREMONIA E PRANIMIT TË ANËTARËVE TË RINJ

Më 27 janar 2021 në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në përputhje me masat për parandalimin e Covid- 19 u organizua ceremonia solemne e ndarjes së fletëdëshmive për anëtarët e rinj të Akademisë, të zgjedhur në Kuvendin zgjedhor të saj më 22 dhjetor 2020. Në ceremoni ishin të pranishëm edhe kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Skënder Gjinushi me bashkëpunëtorë, akademik Shaban Sinani dhe profesor Irakli Koçollari.



Ceremoninë e shpalljes së hapur kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, i cili në fjalën e tij theksoi:

“Me lejoni që në fillim t’ju them se gjatë vitit të shkuar, gjatë vitit 2020, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka zhvilluar një proces të rëndësishëm, procesin e pranimit të

anëtarëve të rinj dhe të avancimit të anëtarëve korrespondentë në anëtarë të rregullt të Akademisë.

Sikundër e dini, i gjithë procesi është zhvilluar në përputhje me Ligjin për Akademinë, në përputhje me Statutin dhe aktet tona normative, përfshirë edhe rregulloren përkatëse.

Pavarësisht se viti i shkuar ishte vit i vështirë për një aktivitet të rregullt institucional, për shkak të pandemisë, ne u përpoqëm që edhe në këto rrethana të zhvillojmë një proces të drejtë, të hapur dhe transparent, duke respektuar deri në detaje të gjitha aktet ligjore që i përmendëm më lart. Institucionet e arsimit të lartë, fakultetet e Universitetit të Prishtinës, universitetet lokale dhe institutet, bënë një numër propozimesh për anëtarë të rinj të Akademisë, gjithsej 45 kandidatë, nga të cilët 38 i plotësuan kushtet që të futeshin në garë për 8 vende të shpallura nga Kryesia: 5 në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, 11 në Seksionin e Shkencave Shoqërore, 17 në Seksionin e Shkencave të Natyrës dhe 5 në Seksionin e Arteve.

Pas votimit nëpër seksione, ashtu siç ishte paraparë, 8 kandidatë kaluan për votim në Kuvendin e Akademisë, i cili, me numrin përkatës të votave vendosi të pranoheshin 3 kandidatë: Besnik Krasniqi, Nysret Krasniqi dhe Shkumbin Munishi, të cilët i kemi këtu dhe të cilëve me këtë rast solemn do t'ua dorëzojmë fletëdëshmitë si anëtarë të rinj të këtij institucioni prestigjioz të shkencës dhe të arteve.

Njëkohësisht, krahas këtij procesi, pra të pranimit të anëtarëve korrespondentë, u zhvillua edhe procesi i avancimit të 16 kandidatëve në anëtarë të rregullt të Akademisë.

Nga ky numër, 4 syresh morën titullin akademik: Edi Shukriu, Justina SH. Pula, Kujtim Shala dhe Muhamedin Kullashi.

Po me këtë radhë, përmes këtij procesi u pranuan edhe tre anëtarë të jashtëm të Akademisë: 1. Brian D. Joseph, Irena Sawicka nga fusha e albanologjisë dhe Abdylmenaf Bexheti nga fusha e shkencave shoqërore.

Për të gjithë këta kandidatë, për pranimin e anëtarëve të rinj dhe për avancimin e anëtarëve korrespondentë në anëtarë të rregullt, u shkruan recensionet nga anëtarët e Akademisë dhe vlerësimet për arritjet e tyre në fushën e shkencës dhe të artit qëndruan të ekspozuara për një javë në ambientet e Akademisë. U paraqit vetëm një vërejtje dhe disa sugjerime të cilat më pas u shqyrtuan nga Kryesia dhe iu proceduan seksioneve për shqyrtim përpara se të zhvillohej procesi i votimit.

Unë kam konsideruar se pranimi i anëtarëve të rinj, përveç që të zhvillohet i mbështetur në aktet tona normative, do të duhej të shoqërohej edhe me aktivitete të tjera, të cilët këtë vit nuk kishte mundësi të zhvilloheshin për shkak të pandemisë, por mendoj se në të ardhmen do të duhej të shoqëroheshin me një promovim dhe paraqitje publike të kandidatëve përmes ligjëratave, ekspozitave dhe formave të tjera të prezantimit, në mënyrë që edhe pranimi të zhvillohet në suaza të një konkurrence të hapur dhe Akademia këtë proces ta përjetojë si një aktivitet që pasuron performancën e saj publike".

Më pas Kryetari Kraja i ftoi me radhë anëtarët e rinj korrespondentë dhe ua ndau fletëdëshmitë, ndërsa e ftoi kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Skënder

Gjinushin t'ua ndajë fletëdëshmitë anëtarëve të rinj të rregullt.

Në emër të të gjithë anëtarëve të rinj të zgjedhur, një fjalë rasti e mbajti akademike Justina Sh. Pula, e cila e falënderoi Akademinë për besimin si dhe uroi të gjithë anëtarët e rinj për zgjedhjen e tyre.

TAKIM NË MES TË ASHAK-ut DHE ASHSH-së

Më 27 janar 2021, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Mehmet Kraja, i shoqëruar nga anëtarët e Kryesisë së Akademisë, akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar, anëtare korrespondente Myzafere Limani, sekretare shkencore, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, akademike Justina SH. Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, priti në takim delegacionin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Skënder Gjinushi, kryetar, akademik Shaban Sinani dhe profesor Irakli Koçollari.

Takimi u zhvillua në atmosferë miqësore. Delegacionet e dy akademive tona diskutuan për realizimin e projekteve të përbashkëta të parapara në Protokollin e bashkëpunimit ASHAK- ASHSH, me theks të veçantë për fillimin e punës për hartimin e Enciklopedisë shqiptare, Fjalorit të madh të gjuhës shqipe dhe Kuvendin e studimeve albanologjike.



U tha se takimet do të vazhdojnë, ashtu që të hartohen dokumentet përkatëse për fillimin e punës në projektet e lartpërmendura.

U paraqit botimi “Demografia e Kosovës” i akademik Hivzi Islamit

Më 4 shkurt 2021, në Sallën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në prani të Akademikëve, studiuesve dhe dashamirëve të librit u bë paraqitja e librit të Akademik Hivzi Islamit “Demografia e Kosovës - Evolucioni i popullsisë, migrimet, gjeopolitikat ekspansioniste serbe dhe spastrimet etnike të shqiptarëve”.

Për rëndësinë e librit foli sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore, Akademike Justina Shiroka- Pula, si dhe recensentët e librit akademik Isa Mustafa dhe akademik Anton Kolë Berishaj. Për librin foli edhe bashkëpunëtori shkencor i autorit të librit, prof. Arsim Ejupi, si dhe përfaqësuesja e Kompanisë “Ekologu” të z. Lazim Destani që përkrahu shtypin e librit, znj. Pranvera Kasami.

DEKLARATË E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS RRETH SYNIMEVE TË SERBISË PËR DESTABILIZIMIN E KOSOVËS DHE TË BALLKANIT PERËNDIMOR, 14 SHKURT 2021

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës e sheh të arsyeshme që përmes kësaj deklarate t'ia tërheqë vëmendjen opinionit të brendshëm dhe faktorit ndërkombëtar se politikat e Serbisë ndaj Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor kanë njohur së fundi një trend riciklimi, duke krijuar një vazhdimësi të politikave të hershme të Serbisë ndaj Kosovës. Perspektivat e errëta që ofron Serbia për rajonin mund të njohin përshkallëzim në ditët dhe muajt e ardhshëm, sepse shoqëria serbe, shteti dhe institucionet e tij, me gjithë mbështetjen e vazhdueshme të Perëndimit, nuk janë reformuar e demokratizuar dhe nuk janë dekontaminuar nga idetë nacionaliste serbomëdha.

Duke shfrytëzuar situatat e paqarta dhe ndonjëherë kontradiktore në Bashkimin Europian, përfshirë hezitimet e këtij blloku rreth zgjerimit të mëtejshëm dhe të një qëndrimi më të prerë ndaj Ruisë, pas shfaqjes së krizës së Ukrainës; duke shfrytëzuar edhe ambientin e pavolitshëm politik të shteteve të rajonit, politikat destabilizuese të Serbisë në Ballkanin Perëndimor së fundi kanë njohur përshkallëzim më të madh dhe janë bërë më agresive. Ngecjet në reforma dhe në demokratizim, krizat e njëpasnjëshme politike, korrupsioni dhe krimi i organizuar, në të cilat janë përfshirë shoqëritë ballkanike, kanë krijuar ambient të përshtatshëm për depërtim të papenguar të ndikimeve

politike të financuara nga fuqitë me ndikim në rajon, siç janë Rusia dhe Kina.

Eskalimi i situatës para disa muajve në veriun e Kosovës e ka bërë të domosdoshme edhe për bashkësinë ndërkombëtare një rikthim të vëmendjes te sinjalet e qarta që jep Serbia për të rindezur një konflikt të ri me Kosovën. Gjendja edhe më tej vazhdon të jetë e ngarkuar me retorikën luftënxitëse të Beogradit, me agjenda dhe premtime nacionaliste të liderëve serbë, me shqetësime rajonale në Republika Srpska në Bosnjë dhe në Mal të Zi, madje edhe në Maqedoninë e Veriut, si dhe me një trysni të fortë të Ruisë për shkak të pranisë së NATO- s në Ukrainë dhe të një mori faktorësh të tjerë ndërkombëtarë.

Kërcënimet e vazhdueshme të Serbisë, goftë me retorikë nacionaliste apo me vringëllimë armësh, kanë synime krejtësisht të qarta: i) t'i sigurojnë pushtet një klase politike nacionalistësh të korruptuar; ii) të krijojnë pasiguri në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në favor Ruisë dhe Kinës, në politikat e tyre kundër NATO- s dhe BE- së; iii) të nxisin elementin nacionalist serb në Bosnjë, Mal të Zi dhe Kosovë për destabilizim të shteteve përkatëse; iv) të shtrijnë ndikimin e Serbisë në vendet që kanë qenë dikur sferë e saj e interesit; v) të faktorizojnë Serbinë në të gjitha agjendat ndërkombëtare, duke i siguruar asaj primatin e dhunshëm në krye të shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Historikisht, Serbia është njëri nga shkaktarët kryesorë i gjithë prapambetjes ekonomike, shoqërore, infrastrukturore, arsimore dhe kulturore të shteteve të Ballkanit

Perëndimor, ndërsa aktualisht ajo është pengesa kryesore e avancimit të këtyre shteteve në reforma dhe në integrimet evropiane. Në Kosovë, Serbia është katalizator i të gjitha krizave politike, madje kuadri politik i brendshëm dhe i jashtëm, që aktualisht dikton profilizimet e spektrit politik të vendit.

Pas një përpjekjeje të gjatë dhe këmbëngulëse, e papenguar nga bashkësia ndërkombëtare, Serbia ka arritur ta instrumentalizojë komunitetin serb në Bosnjë dhe pakicën e kësaj popullsie në Mal të Zi dhe Kosovë. Ajo tashmë e ka fituar “të drejtën” për ta manipuluar politikisht këtë komunitet, për ta përdorur atë sipas interesave politike të Beogradit dhe Moskës. Faktorët politikë rajonalë dhe evropianë e kanë kuptuar se Serbisë i bëhen koncesione nga ana e BE- së dhe NATO- s për shkak të interesave të tyre strategjike, por gjithashtu është e qartë se këto koncesione kanë filluar të rrezikojnë seriozisht sigurinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe përreth tij.

*

Ndërkohë, elitat politike në Serbi, përfshirë Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, vazhdojnë me projeksionet e tyre nacionaliste. Pas “Memorandumit” të vitit 1986, i cili shkaktoi tragjedi të mëdha në hapësirat e ish- Jugosllavisë, Akademia Serbe, e paqortuar as nga ALLEA (Asociacioni i Akademive Evropiane), më 2011 hartoi “Memorandumin 2”, përmes të cilit angazhohet për “mbështetje strategjike” të Serbisë te Rusia dhe Kina, si dhe për nxitjen e konflikteve ndëretnike në shtetet e rajonit, në mënyrë që përmes destabilizimit të tyre të arrijë t’i realizojë interesat

serbomëdha. Ndërkohë, më 2017 është hartuar “Memorandum 3” i Akademisë Serbe, i cili ka promovuar togfjalëshin hiperbolik “bota serbe”. Në esencë ky togfjalësh përmbledh atë që thotë diplomati amerikan Eskobar, se “bota serbe” në të vërtetë është “bota ruse”.

Në këtë kontekst duhet parë edhe nismat e Serbisë për “mini- Shengenin” dhe projektin “Ballkani i hapur”, si obstrukcioni i hapur ndaj BE- së dhe si hapësirë për depërtime të reja politike dhe ekonomike të Ruisë dhe Kinës në Ballkan, duke fuqizuar rolin e Serbisë në rajon dhe duke anashkaluar Kosovën në të gjitha proceset rajonale.

Akademia konsideron se nisma “Ballkani i hapur” është minim i “Procesit të Berlinit”, se bën izolimin politik të Kosovës dhe se do të ketë pasoja largvajtëse për raportet e ardhshme mes shteteve të Ballkanit Perëndimor. Retorika nacionaliste e kreut politik të Shqipërisë për bashkim kombëtar, për heqje kufiri me Kosovën etj. , që gjoja përfshihen në projektin “Ballkani i hapur”, njësoj si diskutimi politikisht diletant në Kosovë për bashkim kombëtar, i shkojnë në favor politikës së Serbisë, duke e konsideruar “Serbinë e madhe” si pasojë logjike dhe kundërpeshë politike kundrejt “Shqipërisë së madhe” dhe duke vendosur shenjën e barazimit mes Kosovës dhe Republika Serpska, pavarësisht se bëhet fjalë për dy realitete krejtësisht të ndara politike dhe historike.

Akademia gjithashtu konsideron se nisma “Ballkani i hapur” dhe boshti asimetrik Beograd- Shkup- Tiranë do të ndikojë që shqiptarët e Maqedonisë së Veriut të mos jenë faktorë relevantë në politikat e brendshme dhe të e jashtme të këtij shteti, sepse peshën e tyre

qeveria e Shkupit po përpiqet ta zëvendësojë me një afrim të drejtpërdrejtë me Tiranën. Pranimi në NATO i Maqedonisë së Veriut nuk u lexua në Shkup vetëm si forcim i sigurisë dhe i pozitës ndërkombëtare të këtij shtetit, por edhe si mundësi për të bërë ndryshime strukturore në politikat e brendshme dhe të jashtme, siç është afrimi me Serbinë dhe anashkalimi i faktorit të brendshëm shqiptar, si përcaktues i konfigurimit politik të vendit.

Më anë tjetër, pavarësisht se çështja e Kosovës në të drejtën ndërkombëtare mori statusin e një çështjeje “sui generis”, pesë shtete të BE- së (Greqia, Spanja, Rumania, Qipro dhe Sllovakia) ende mbeten këmbëngulëse në mosnjohje. Shtetet që përbënin “Grupin e Kontaktit” për Kosovën, nuk bënë trysni të mjaftueshme mbi këto shtete evropiane, sikundër që nuk ushtruan trysni mbi Serbinë, e cila vazhdon t’ua kërkojë hapur të gjitha shteteve të mos e njohin Kosovën, ose ta ç’njohin atë. Një sjellje e këtillë e Serbisë, agresive dhe bllokuese ndaj Kosovës, nuk mori përgjigje më eksplicite nga këto shtete, apo nga ato që u shprehen në mbështetje të pavarësisë. Për shkak të këtyre pesë shteteve dhe të vendimmarrjes koncensuale në forumet e BE- së, Kosova mbeti pa liberalizim të vizave dhe me negociata të prapambetura për integrim.

Gjatë kësaj periudhe, ndërkohë, BE- ja i bëri Serbisë favore të mëdha, duke hapur vazhdimisht kapituj të rinj të bisedimeve për integrim, duke e ndihmuar financiarisht, duke nxitur investimet dhe duke mos e ndëshkuar në asnjë formë për politikat e saj destabilizuese në Ballkanin

Perëndimor. Kushtëzimi i BE- së se Serbia nuk mund të integrohet në BE pa njohjen e Kosovës, pak nga pak u zhvlerësua në fjalorin politik të diplomatëve europainë.

*

Akademia konsideron se në Bruksel, që më shumë se dhjetë vjet, zhvillohet një dialog jofrytëdhënës mes Kosovës dhe Serbisë, i sponsorizuar nga BE- ja dhe i mbështetur nga SHBA- ja, i cili deri tani ka dhënë rezultate minimale. Kjo ka ndodhur për arsye se Serbia nuk bën asnjë koncesion për Kosovën, duke mos pranuar të shkojë një hap më tej se Rezoluta 1244 e OKB- së. Përkundrazi, ajo punon pareshtur që ta minojë shtetin e Kosovës, si në planin rajonal, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Për këtë arsye, një numër marrëveshjesh që janë arritur në Bruksel nuk kanë gjetur zbatim dhe shpesh kanë mbetur pa domethënie. Nga fundi i vitit 2012 janë arritur shtatë marrëveshje: lëvizja e lirë, menaxhimi i integruar i kufirit, regjistrat kadastralë, regjistrat civilë, përfaqësimi rajonal dhe njohja e diplomave, por në të gjitha këto raste Kosova i bën koncesione Serbisë: lëvizja e lirë me dokumente të UNMIK- ut, përfaqësimi rajonal bëhet me fusnotë Kosova- UNMIK, në vulat doganore nuk shkruhet Republika e Kosovës, ndërsa Kosova ka marrë nga Serbia vetëm kopjet e regjistrave civilë dhe atyre kadastralë.

Ndërkohë, në pranverën e vitit 2013 Kuvendi i Kosovës me një rezolutë “shprehu pëlqimin” që të nënshkruhet një marrëveshje të parimeve që rregullojnë marrëdhëniet me Serbinë. Më 27 qershor 2013 marrëveshja pesëmbëdhjetë pikëshe u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me 2/3 e votave të deputetëve, duke shkaktuar krizë të

brendshme politike, ndërkaq Kuvendi i Serbisë e trajtoi atë si “informatë” dhe nuk e miratoi me votë parlamentare. Marrëveshja në tërësinë e saj trajton integrimin e komunitetit serb në Kosovë në këmbim të krijimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe, i cili, i tillë siç u miratua në Kuvendin e Kosovës, ka kompetenca në ekonomi, arsim, shëndetësi dhe planifikim hapësinor.

Për të tejkaluar situatën e krizës së brendshme që shkaktoi miratimi në Kuvendin e Kosovës i marrëveshjes për asociacionin e komunave serbe, më 30 tetor 2015 ajo u dërgua në Gjykatën Kushtetuese, me kërkesë për interpretim të përputhshmërisë së parimeve të asociacionit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila konstatoi se “parimet e përgjithshme” të kësaj marrëveshjeje nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, sepse asociacioni i komunave serbe do të merrte kompetenca ekzekutive, gjë që nuk e lejonte Kushtetuta. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese bllokojti të gjitha përpjekjet e BE- së për të çuar përpara procesin e dialogut. Së fundi, duke e parë se kjo çështje nuk mund të marrë një zgjidhje të përshtatshme, përfaqësuesit e BE- së filluan të bëjnë trysni mbi Kosovën, për të ndryshuar Kushtetutën e saj. Kjo është një qasje joadekuate e strukturave të BE- së, meqë është e ditur se një asociacion i tillë do ta bënte Kosovën shtet jofunksional dhe do të krijonte “hapësirë kushtetuese” për autonomi territoriale të komunave serbe në Kosovë, përfshirë edhe ndarjen e saj. Diplomacia e BE- së, ndërkaq, zhvilloi dialogun Kosovë- Serbi në dy paralele pothuajse të ndara: dialogun politik

dhe dialogun teknik. Deri së fundi janë arritur mbi 30 marrëveshje, të cilat synojnë të zgjidhin disa çështje praktike të marrëdhënieve Kosovë- Serbi. Në shumicën e rasteve tekstet e marrëveshjeve janë konfuze, me ambiguitet kuptimor, me mundësi të ndryshme interpretimi, pa nënshkrime, pa numër protokolli, pa përmendur mes kujt arrihen, vetëm e vetëm që me këtë mënyrë të dialogut të pajtohet Serbia, e cila nuk pranon ta trajtojë Kosovën si subjekt të ndonjë marrëveshjeje, por vetëm si pjesë të shtetit, e ndarë “përkohësisht” me kufi administrativ, sipas Rezolutës 1244 të OKB- së. Edhe marrëveshja e fundit “për targa”, e bërë nën trysinë e Brukselit, ishte kompromis që bëri Kosova ndaj Serbisë, duke lejuar sërish shkeljen e sovranitetit dhe ndërhyrjen e Serbisë në një pjesë të territorit të Kosovës.

Përveç kësaj, edhe Rusia vazhdon trysninë e saj të pandërprerë mbi Brukselin. Siç e pohoi së fundi ministri i Jashtëm rus, Lavrov, Rusia ia rikujton BE- së “në mënyrë periodike”, se cilat janë detyrat e saj si ndërmjetësuese e dialogut Kosovë- Serbi, në mënyrë që Serbia të jetë palë e favorizuar në këto bisedime. Ai theksoi se asociacioni i komunave serbe në Kosovë “parashikoi dhënien e të drejtave autonome serbëve”, duke tërhequr me këtë rast një paralele ndërmjet kësaj marrëveshjeje dhe asaj të Minskut, e arritur me ndërmjetësimin e BE- së për republikat Donjecit dhe Luhanskut në Ukrainën Lindore. Të dyja këto marrëveshje, thekson ai, kanë të bëjnë me të “drejtat e sllavëve, veçanërisht të ortodoksëve”.

Akademia gjithashtu ka konstatuar se Kosova është gjendur nën një presion

të madh ndërkombëtar për të themeluar Gjykatën Speciale, e cila ka shumë kontradikta brenda saj dhe vendos shenjën e barazimit midis agresorit dhe viktimës. Kosovarët nuk mund ta perceptojnë Gjykatën Speciale “si funksionim adekuat i drejtësisë ndërkombëtare”, që i barazon krimet serbe (13 mijë të vrarë, rreth njëmijë fëmijë; mbi një mijë të zhdukur, kryesisht kufoma të bartura nëpër Serbi; numër i paditur i grave të dhunuara; spastrimi etnik me dëbimin e gjysmës së popullsisë së Kosovës; një pasuri e paçmuar e shkatërruar në sektorin publik dhe privat etj.) me dëmet kolaterale të palës tjetër. Një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare me Gjykatën Speciale synon të japë mesazhin se lufta në Kosovë ka qenë konflikt ndëretnik dhe se palët ndërluftuese kishin bërë krime mbi njëra- tjetrën, perceptim ky eurocentrist dhe arrogant.

*

Akademia konstaton se situata e tanishme në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, do të duhej ta nxiste Perëndimin të formulonte një strategji më të qartë kundrejt Serbisë, ndaj synimeve të saj destabilizuese dhe të aleancave të saj me Rusinë dhe Kinën. Akademia gjithashtu konsideron se një zgjidhje e përshtatshme për rajonin e Ballkanit Perëndimor mund të jetë afrimi i shteteve të veçanta me BE-në dhe NATO-n.

Që nga rënia e Milosheviçit në vitin 2000, aleatët tanë perëndimorë (veçmas BE- ja), kanë bërë vlerësime të gabuara për hapat e Serbisë drejt Perëndimit, duke e ndihmuar atë në të gjitha fazat e procesit të integritetit. Ndonëse e bllokoi Kosovën në të gjitha nismat rajonale, Serbia është

mbështetur fuqimisht si në planin politik, ashtu edhe në atë ekonomik. Aleatët perëndimorë i kanë mbështetur pothuajse haptas të gjitha nismat rajonale të Serbisë, përfshirë edhe “mini- Shengenin” dhe “Ballkanin e hapur”, ndonëse qëllimet e Serbisë janë destabilizimi i Ballkanit Perëndimor dhe goditja e BE- së dhe e Aleancës Veriatlantike.

Është joproduktive dhe politikisht e gabuar që Kosovës t’i bëhet trysni ndërkombëtare për të arritur marrëveshje të dëmshme me Serbinë, duke kërkuar nga Kosova të relativizojë sovranitetin dhe integritetin e saj territorial dhe të defaktorizohet politikisht në planin e jashtëm, si dhe të bëhet shtet jofunksional në planin e brendshëm.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës mbështet fuqishme përfshirjen e SHBA- së në dialogun Kosovë- Serbi, veçanërisht qëndrimin e shprehur së fundi nga i dërguari i posaçëm, Gabriel Eskobar, i cili rikonfirmoi se SHBA- ja i jep mbështetje të palëkundur sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës.

Akademia gjithashtu mbështet fuqishëm perspektivën më të qartë të Kosovës drejt NATO- s, si strukturë themelore e sigurisë edhe në Ballkanin Perëndimor, e cila do ta zbrapste Serbinë nga synimet e saj të vazhdueshme për ta destabilizuar Kosovën dhe do të reflektonte pozitivisht në stabilitetin politik të mbarë rajonit.

Shqiptarët janë populli më properëndimor në Ballkan dhe ata, duke qenë përkrahës të pakontestueshëm të vlerave perëndimore, përbëjnë boshtin kryesor të mbrojtjes së këtyre vlerave në këtë rajon.

Klasa politike e Kosovës, veçanërisht

drejtuesit e institucioneve kryesore të shtetit e kanë obligim të marrin përsipër përgjegjësi të drejtpërdrejta lidhur me avancimin e proceseve politike, të cilat çojnë përpara aleancat tradicionale të Kosovës me shtetet që qëndrojnë në mbështetje të pavarësisë dhe të sovranitetin e saj dhe, përmes një diplomacie proaktive, të krijojnë aleanca të reja, veçmas me shtetet e rajonit që kanë avancuar në integrimet euroatlantike. Klasa politike e Kosovës duhet të mbajë përgjegjësi më të mëdha për zhvillimet e brendshme dhe të jashtme në Kosovë, duke tejkaluar konfliktet dhe interesat e ndara dhe duke marrë vendime përbashkëta për çështje me rëndësi për vendin dhe të ardhmen e tij.

U PARAQIT LEKSIKONI "VENDBANIMET E KOSOVËS"

Më 17 mars 2021 në mjediset e Akademisë u bë paraqitja e një botimi ndër më të rëndësishmit të ASHAK- ut "Leksikoni i vendbanimeve të Kosovës - Tabloja fizike- hapësinore, demografike dhe funksionale", në tri vëllime, që kapin 2. 023 faqe. Për botimin folën sekretarja e Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademikja Justina-Shiroka- Pula, kryetari i Akademisë akademik Mehmet Kraja, recensenti akademik Anton K. Berishaj dhe kryeredaktori akademik Hivzi Islami. Në përurim morën pjesë anëtarë të Akademisë, ekspertë nga gjeoshkencat dhe shumë të interesuar të tjerë.

Në hartimin e këtij botimi u angazhuan dhjetëra ekspertë të shkencave gjeohapësinore, sociologë, urbanistë, ekonomistë, demografë, historianë, etnologë, planerë etj. , të udhëhequr nga akademik Hivzi Islami. Botimi

përmban të dhëna, fakte dhe informata relevante nga terreni për dimensionin fizik- hapësinor, demografik, funksional, historik, kulturor, ekonomik, gjeopolitik, pastaj të dhënat për dhunën, krimet, masakrat dhe dëmet materiale që i shkaktoi regjimi fashisoid e gjenocidal i Serbisë etj.

Të dhënat burimore dhe origjinale shkencore- enciklopedike për evolucionin cilësor dhe sasior të vendbanimeve të Kosovës mundësuan ndërtimin e tablosë së vërtetë të krijimit, të dinamikës së jetës dhe të rrjedhave zhvillimore të vendbanimeve urbane dhe rurale, të kaluarën dhe të sotmen e tyre. Pjesa tekstuale e botimit përcillet me material ilustrues, çfarë janë fotot për objekte të ndryshme gjeohapësinore, të trashëgimisë natyrore e kulturore dhe elementet fizionomike e funksionale etj.

Botimi pa dyshim do të përmbushë një nevojë të kahershme për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë lexues dhe do të jetë një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë.



MINISTRJA E MASHTI-IT, ZNJ ARBËRIJE NAGAVCI VIZITON ASHAK-UN

Më 2 prill 2021 Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e vizitoi ministrja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit znj. Arbërije Nagavci.



Ministrja Nagavci u prit nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja dhe anëtarët e Kryesisë së Akademisë.

Në takim u bisedua për bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve ASHAK dhe MASHTI.

Znj. Nagavci shrehu interesim për thellimin e bashkëpunimit duke theksuar se i duhet mbështetja dhe këshillat e ASHAK- ut, si institucioni më i lartë i Shkencës dhe i Artit në Kosovë.

Kryetari Kraja gjatë prezantimit të punës së ASHAK- ut, ndër të tjera e njoftoi Ministren se ASHAK- u së fundmi ka hartuar një platformë për rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë dhe së shpejti pritet ta bëjë publikimin e saj. Ai i ofroi asaj një kopje të platformës dhe tha se ASHAK- u e mirëpret bashkëpunimin ndërinstytucional dhe është i gatshëm të ofrojë mbështetje sa herë që kërkohet, gjithnjë në përputhje me rolin e saj.

PARAQITEN DISA NGA BOTIMET E SEKSIONI TË GJUHËSISË DHE TË LETËRSISË

Me datë 23 prill 2021, në orën 11, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u organizua paraqitja e disa prej botimeve të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, që kanë të bëjnë kryesisht me kontributet e albanologëve të huaj në studimet e gjuhës, letërsisë, kulturës dhe traditës shqiptare. Për shkak të masave dhe kufizimeve të shpallura nga qeveria e Kosovës për parandalimin e pandemisë Covid 19, promovimi u zhvilluar para një publiku të reduktuar, me distancat e kërkuara konform këtyre rregullave, derisa shërbimi teknik i Akademisë mundësoi që ky aktivitet të transmetohej drejtpërdrejt në kanalën youtube të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mundësi kjo që rezultoi e qëlluar, gjykuar nga reagimet e atyre që patën mundësi ta ndjekin online.

U paraqitën me këtë rast dy nga veprat e gjuhëtarit të shquar austriak Norbert Jokl (1877- 1942), që janë pjesë e projektit shumëvjeçar për mbledhjen dhe botimin e veprës së plotë të njërit nga albanologët më të mëdhenj: Studime historiko- krahasuese për gjuhën shqipe / Historisch- Vergleichende untersuchungen über das Albanische (2017) përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe prof. dr. Heiner Eichner nga Akademia Austriake dhe Gjurmime linguistike historike- kulturore në fushë të shqipes / Linguistisch- Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen (2019), përkthyer nga Skënder Gashi dhe përgatitur nga Rexhep Ismajli dhe Heiner Eichner. T'ju

rikujtojmë se në vitin 2011, po nga Norbert Jokl, qe botuar dhe promovuar vepra “Studim për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip” /Studien zur Albanischen Etimologie und wortbildung, përgatitur gjithashtu nga akademik R. Ismajli, ndaj mund të konsiderohet se me këta tri vëllime që paraqesin tri shtyllat kryesore të veprimtarisë së dijetarit të shquar, është rrumbullakuar vepra e Joklit, sado që në vitin në vijim pritet edhe një botim i fundit me artikuj e studime që do të mblidhen, sistemohen e përkthehen.

Aktivitetin e hapi, me një fjalë rasti, sekretari i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë së ASHAK- ut, akademik Eqrem Basha.



Akademik Rexhep Ismajli, që mori fjalën i pari nga paneli i referuesve të këtij aktiviteti, në përkujdesjen e të cilit si përzgjedhës, mbarështues i dorëshkrimeve të veprave që u promovuan dhe organizues i dy Konferencave shkencore, botimet e të cilave u promovuan gjithashtu, theksoi se botimi i albanologëve të traditës dhe në veçanti i albanologëve të huaj ka qenë në vatrën e interesimeve tona këtu e tridhjetë vjet më parë kur u inicua kolana, e cila ka sjellë deri sot studimet e dhjetëra studiuesve nga më të rëndësishmit në historinë e albanologjisë. Akademik Ismajli në veçanti u ndal te projekti i botimit të

veprës së albanologut austriak Norbert Jokl, i konsideruar si njëri nga më të rëndësishmit në historinë e albanologjisë, e botuar e përkthyer në gjuhën shqipe, por edhe në origjinalin gjermanisht, duke shquar të veçantat dhe rëndësinë e kësaj vepre për studimet albanologjike dhe ballkanologjike në përgjithësi.

Anëtari korrespondent Bardh Rugova foli kryesisht për botimin “Studime albanologjike”, të Brian D. Joseph- it, profesor i gjuhësisë në Ohio State University të SHBA- së, autoritet i shquar në fushë të gjuhësisë historike, specialist i greqishtes, i gjuhësisë ballkanike dhe i shqipes, anëtar i jashtëm i ASHAK- ut, kontributet e të cilit në këto studime i ka zgjedhur dhe përgatitur për shtyp akademik R. Ismajli dhe përkthyer nga origjinali anglisht ant. korr. B. Rugova. Libri ka qenë pjesë e programit të punës së Seksionit për vitin 2020 dhe doli nga shtypi në muajt e parë të këtij viti.

Gjithnjë në rrjedhën e studimeve dhe kontributeve të albanologëve të huaj për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, u realizuan dhe dy botime voluminoze me kumtesat e pjesëmarrësve në dy konferenca shkencore ndërkombëtare, organizuar nga ASHAK- u, që u përruruan gjithashtu. Për librin “Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht” / Albanistische Forschungen in den Deutschsprachigen Ländern, përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli, foli prof. dr. Milote Sadiku, nga katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të Fakultetit të Filologjisë të UP- së, ndërsa për “Studimet albanistike në Itali” / Gli studi albanistici anëtari korrespondent Shkumbin Munishi. Të dy folësit analizuan kontributet e një numri të madh studiuesish nga vende të

ndryshme të Europës dhe SHBA- së, bashkë me studiuesit shqiptarë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, që u paraqit në këto konferenca të vlerësuara të rëndësishme për këto studime.

PARAQITET PLATFORMA PËR RIMËKËMBJEN E ARSIMIT NË KOSOVË

Më 11 maj, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në përputhje me masat për parandalimin e Covid- 19 u bë paraqitja publike e “Platformës për rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë”. Në promovim, përveç anëtarëve të Akademisë, morën pjesë ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit znj. Arbërije Nagavci, përfaqësues të institucioneve arsimore, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera. Promovimin e hapi akademike Justina SH. Pula, koordinatore e Grupit punues të ASHAK- ut për hartimin e “Platformës”. Ajo tha se gjendja e rënduar në sistemin e arsimit në Kosovë e ka nxitur Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si promotore kryesore e zhvillimit të mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike, të shprehë qëndrimin e saj për problemet kyçe të arsimit në Kosovë.



Platforma është produkt i punës ekipore dhe konsultimeve të gjëra, ku kanë marrë pjesë anëtarë të ASHAK- ut dhe ekspertë që merren me problematikat e arsimit nga komuniteti akademik, institucionet shtetërore, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile.

Procesi është drejtuar nga grupi i punës i përbërë nga anëtarë të ASHAK- ut dhe profesionistë e hulumtues jashtë tij. Pas konsultimeve fillestare janë organizuar dy tryeza për analizën e gjendjes në arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë. Pastaj janë organizuar edhe shumë takime me nëngrupet për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë, theksoi akademikja Pula.

Mbi bazën e këtyre materialeve, Grupi punues ka hartuar draftin e dokumentit i cili është përpunuar pas komenteve të anëtarëve të Akademisë dhe është miratuar nga Kryesia e Akademisë.

J. Pula në fund tha se institucionet qeveritare të Kosovës kanë deklaruar vazhdimisht se arsimin e kanë prioritet, mirëpo praktika ka treguar të kundërtën, prandaj duhet të dilet nga ky rreth dhe t’u sigurohet brezave që vijnë, e drejta elementare e mendimit të lirë, e drejta për një shkollim që i përgatit për jetë.

Që Platforma të mos ngelë në letër, shoqëria e Kosovës duhet të vetëdijesohet për peshën e problemit e të përballet urgjentisht me sfidat që janë trajtuar në këtë tekst, dhe kjo përballje kërkon jo vetëm dije, por edhe guxim e dinjitet.

Më pas, një fjalë rasti e mbajti akademik Mehmet Kraja, kryetar i ASHAK- ut, i cili pasi falënderoi grupin punues dhe të gjithë të angazhuarit e tjerë për punën dhe përkushtimin e

tyre, ndër të tjera tha se “Te ne në Kosovë tashmë është krijuar një vetëdije e përgjithshme shoqërore, se arsimin e kemi në gjendje të keqe dhe se është e nevojshme po ashtu një aksion i përgjithshëm shoqëror, që të mund ta tejkalojmë këtë gjendje. Nuk tejkalohet gjendja e këtillë në arsim as me politika arsimore, as me grupe të interesit, as me individë të përgjegjshëm ose të papërgjegjshëm, as me ekspertë dhe as me institucione vendimmarrëse; tejkalohet vetëm nëse vetëdija shoqërore arrin atë nivel, kur të gjithë marrin përgjegjësitë që iu takojnë në një proces të vështirë të ringritjes përmes idealizmës dhe rikthimit tek idetë iluministe.”

Një fjalë rasti mbajti edhe Ministrja Nagavci, e cila e përgëzoi Akademinë për punën e bërë dhe u zotua se është e gatshme për bashkëpunim më intensiv ndërmjet ASHAK-ut dhe MASHTI-it.

U PARAQIT BOTIMI “ANALIZË E EKONOMISË NË HIJE NË KOSOVË”



Më 15 qershor 2021, u paraqit botimi: “Analiza e Ekonomisë në hije në Kosovë” i akademik Isak Mustafës dhe akademike Justina Sh. Pulës.

Aktiviteti u bë në praninë e anëtarëve të Akademisë, ekspertë të fushës dhe të ftuar të tjerë.

PARAQITET BOTIMI “LEKSIKON I TERMAVE TË SOCIOLINGUISTIKËS”

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 18 qershor, 2021 paraqiti botimin: “Leksikoni i termave të sociolinguistikës” të Rexhep Ismajlit, Bardh Rugovës dhe Shkumbin Munishit.

Libri bën pjesë në projektin Leksikonët e termave të gjuhësisë, nga i cili tashmë është botuar Leksikoni i termave të fonetikës dhe të fonologjisë, i Bardh Rugovës, i promovuar vitin që shkoi. Në një vëllim prej 388 faqesh janë zëbërthyer e shpjeguar rreth 770 terma të sociolinguistikës. Duke qenë një botim i vetëm dhe i veçantë, “ky fjalor hap një shteg shumë të rëndësishëm të kodifikimit e të shpjegimit gjuhësor në kulturën tonë, si dhe sprovon gjuhësinë tonë përballë traditës kodifikuese gjuhësore universale” thuhet në recensionin e këtij dorëshkrimi.



Për botimin folën studiues e autorë të librit.

PARAQITET BOTIMI “VEPRA PËR PIANO”

Më 22 qershor 2022, në mjediset e Akademisë, në praninë e një auditoriumi të gjerë u paraqit libri i akademik Rauf Dhomit: “Vepra për piano”.



Aktivitetin e hapi anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa për librin foli Mr. Sc. Syzana Jakupi. Ajo e vlerësoi lart librin duke thënë se është një vlerë e madhe për adhuruesit e muzikës serioze.

Aktiviteti u përcoll me një program të shkurtër artistik me ç’rast u ekzekutuan pjesë nga veprimtaria muzikore e Akademik Dhomit.

PARAQITET BOTIMI “KOMFORI TERMIK”

Më 28 qershor 2021 në ASHAK u bë paraqitja e librit: “Komforti termik” i autorëve Fejzullah Krasniqi dhe Rexhep Selimaj.

Fjalën përshëndetëse e mbajti anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës.



Në aktivitet morën pjesë anëtarë të ASHAK- ut, si dhe rektorët e Universitetit të Prishtinës dhe të Gjilanit, dekani dhe një pjesë e stafit të Fakultetit të Makinerisë.

Në emër të recensentëve të librit fjalimin e mbajti akademik Isuf Krasniqi.

Në fund, nga një fjalë rasti e mbajtën autorët e librit.

PARAQITJA E BOTIMEVE TË ASHAK-UT NË TUZ

Më 18 gusht 2021, Mal të Zi, në Tuz është bërë paraqitja e botimeve të ASHAK- ut:

“Në botën e përbashkët – tradita, tranzicioni, anomia”, autor Anton K. Berishaj dhe “Fshehja e krim-it- Politika serbe e mashtrimeve të mëdha”, autor Anton Vukpalaj.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë nga ASHAK- u: akademike Justina SH. Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, akademik Hivzi Islami, recensenti i parë i të dy botimeve dhe autorët: akademik Anton K. Berishaj dhe prof. dr. Anton Vukpalaj.

Para një auditoriumi të gjerë, fjalën përshëndetëse në emër të ASHAK- ut, e mbajti akademike Justina Pula.

Për të dy botimet në cilësinë e recensentit foli akademik Hivzi Islami.

Ai e vlerësoi lart kontributin e të dy autorëve dhe tha se botimet kanë rëndësi të veçantë për publikun e gjerë dhe se e pasurojnë fondin e botimeve të ASHAK- ut.

PARAQITET BOTIMI “PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE”

Më 15 shtator 2021, në sallën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK- ut paraqiti librin më të ri të akademik Rexhep Ismajlit “Për historinë e gjuhës shqipe”. Promovimi u zhvillua konform masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid 19 dhe, përveç numrit të kufizuar të pjesëmarrësve në sallë, u ndoq drejtpërdrejt në kanalën zyrtar të Akademisë në Youtube.

Në fjalën e hapjes, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, midis të tjerash theksoi se “Akademik Rexhep Ismajli, studiues e pedagog, me një përvojë pothuaj 50 -vjeçare, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës që nga viti 1993, një kohë sekretar shkencor e për dy mandate kryetar i institucionit më të lartë shkencor në Kosovë, me autoritetin e studiuesit elitari të gjuhës shqipe, të historisë së saj, gjuhësisë së përgjithshme, sociolinguistikës, politikave të planifikimit, normës e standardit, por jo dhe me më pak interesime për historinë, arkeologjinë, letërsinë dhe kulturën në përgjithësi, zë një nga vendet qendrore në fushën e botimeve shkencore te ne, jo vetëm me monografitë, studimet, veprat autoriale që konsiderohen kontribute kulmore

albanologjike dhe albanistike në botën shqiptare dhe më gjerë, por edhe me përgatitjen, mbledhjen, sistemimin, përkthimin, botimin e dhjetëra veprave të albanologëve botërorë, veprave të plota të emrave të shquar të studiuesve e albanologëve tanë e të huaj, organizues e pastaj hartues i vëllimeve të rëndësishme të bazuar në konferencat e mëdha shkencore albanologjike, si ato të studimeve albanologjike në Amerikë, në vendet ku flitet gjermanisht, në Itali, dhe kjo që po përgatitet sivjet, për studimet albanologjike në Francë, që gjithsesi do të shoqërohet edhe me botimin e kontributeve të saj në një vëllim më vete. Opusi shkencor i akademik Ismajlit, në veçanti ai i krijuar dhe i realizuar brenda Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është i gjerë dhe i denjë për hulumtime të thella e të veçanta. Ne sot jemi mbledhur këtu t’ju paraqesim veprën më të re të tij,, “Për historinë e gjuhës shqipe”, për të cilën kemi ftuar të flasin anëtarët korrespondentë të ASHAK- ut, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi, ish-studentë dhe tash kolegë në fushën e gjuhësisë, njëkohësisht dhe recensentë të veprës në fjalë. ”



Në vazhdim, anëtarët korrespondentë, Bardh Rugova e Shkumbin Munishi, që janë dhe recensentë të librit, paraqitën vlerësimet e tyre rreth botimit.

Në fund, një fjalë falënderimi mbajti dhe vetë autori i librit, akademik Rexhep Ismajli.

U PARAQIT BOTIMI: “ENIGMA E POEZISË”

Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me datë 22 shtator 2021 u paraqit libri më i ri i akademik Sabri Hamitit “Enigma e poezisë”. I paraparë me programin e punës të vitit 2021, libri doli nga shtypi nga mesi i qershorit të këtij viti. Aktiviteti u zhvillua konform masave parandaluese kundër përhapjes së pandemisë covid 19, me një numër të reduktuar pjesëmarrësish në sallë, por u transmetua drejtpërdrejt edhe në kanalën zyrtar të ASHAK- ut në Youtube (URL: <https://youtu.be/dF2NW6owOLY>). Fjalën e hapjes e mbajti akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.



“Akademik Sabri Hamitit është studiues i letërsisë dhe kritik letrar, por edhe poet, dramaturg e romancier, pedagog shumëvjeçar, në kujdesin e të cilit u ngritën gjenerata studiuesish, doktorë të shkencës së letërsisë, kritikë letrarë e krijues që begatojnë botën tonë letrare me diversitetin e kërkimeve dhe

orientimeve të reja”, theksoi mes të tjerash në fjalën e hapjes Akademik Basha. “Enigma e poezisë” titullohet libri më i ri i Akademik Hamitit që po paraqesim sot(...), një vepër që i kushtohet, siç udhëzon dhe titulli, kryekëput poezisë, poezisë shqipe, para së gjithash, por edhe enigmës së përkthimit, në një segment, kur flet për përkthimet e Rexhep Ismajlit. Diagonalet që krijon Akademik Hamiti në dy pjesët e librit, me Fishtë, Shantojën, Koliqin, Camajn, të përfshirë në pjesën e parë të librit dhe me një varg krijuesish të mesit deri te fundi i shekullit të kaluar, veçanërisht i dy dhjetëvjetëshave të parë të këtij shekulli, që përfshihen në pjesën e dytë, të japin një pasqyrë të gjerë të parapëlqimeve dhe leximeve të tij për të kërkuar- dëshmuar bindjen se kemi të bëjmë me një përkushtim par excellence ndaj poezisë së kritikut e studiuesit të letërsisë që edhe vetë është poet dhe që ka “kompetencën” ta kërkojë e ta shpalojë enigmën, rrugën që gjurmon magjinë e poezisë. Do të thoshim një mjeshtër, të përdorim fjalorin teknik me shpresë se nuk do ta thjeshtësojmë dhe aq, i matjeve dhe sondave, i analizave dhe gjetjeve që na zbërthejnë gjithë ato figura e mistere. Është ky një “dialog me libra të shënjuar të autorëve modernë që e kanë zgjedhur lexuesin apo që i ka zgjedhur lexuesi,” paralajmëronte ai vetë në paraqitjen e këtij projekti. Të mësuar me përkujdesjen e tij që të na ofrojë gjithnjë botime tematikisht të përcaktuara, rreth një boshti dhe rreth një koncepti, dorëshkrimi që kemi në dorë, për të cilën do të flasim sot kompetentët e fushës, na orienton dhe na udhëzon të zbërthejmë dhe të lexojmë më qartë, kësaj here, artin e poezisë. ”

Të ftuar për të folur rreth kësaj veprë më të re të Akademik Hamitit ishin dy pedagoge dhe studiuese të letërsisë nga Fakulteti Histori- Filologji i Universitetit të Tiranës, prof. dr. Persida Asllani dhe prof. dr. Dhurata Shehri, si dhe prof. dr. Nysret Krasniqin, nga Katedra e Letërsisë shqipe e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, anëtar korrespondent i ASHAK- ut dhe recensent i dorëshkrimit të veprës në fjalë.

AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS, MË 27 SHTATOR 2021 E VIZITOI AMBASADORI I BE- SË, NË KOSOVË TOMASH SUNJOG

Ambasadori Sunjog u prit nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, anëtarët e Kryesisë: akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar, anëtare korrespondente Myzafere Limani, sekretare shkencore, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, akademike Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës, anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve dhe akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar të ASHAK- ut.

Kryetari Kraja e falënderoi Ambasadorin për vizitën dhe e njoftoi atë me punën e Akademisë.



Akademik Ismajli e njoftoi Ambasadorin për bashkëpunimin ndërkombëtar të Akademisë dhe sfidat që kanë anëtarët e Akademisë për realizimin e udhëtimeve për shkak të mungesës së vizave.

U tha se ASHAK- u e vlerëson vizitën e ambasadorit Sunjog dhe se pret thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.

EKSPOZITA “XHEVDET XHAFA”

Më 7 tetor në galerinë e Akademisë në praninë e shumë adhuruesve të artit pamor u hap Ekspozitë personale me veprat e anëtarit korrespondent



Xhevdet Xhafa. Ekspozita u hap me rastin e promovimit të Monografisë së autorit. Ekspozitën e shpalli të hapur anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, ndërsa për Monografinë foli autorja Suzana Varvarica Kuka.

VIZITA E AMBASADORES SË FRANCËS NË ASHAK

Më 19 tetor 2021, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e vizitoi ambasadorja e Francës në Kosovë znj. Marie-Christine Butel, e shoqëruar nga z. Donato Giuliani, këshilltar për bashkëpunim dhe veprimtari kulturore dhe znj. Fikrije Pllashniku, sekretare e Përgjithshme në Departamentin për bashkëpunim dhe veprimtari kulturore.



Ambasadorja Butel, u prit nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, anëtarët e Kryesisë: anëtare korrespondente Myzafer Limani, sekretare shkencore, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar të ASHAK- ut.

Takimi u zhvillua në atmosferë miqësore. Kryetari Kraja bëri në paraqitje të punës së Akademisë në përgjithësi. Sekretarët e seksioneve folën për aktivitetet e seksioneve përkatëse dhe akademik Ismajli e njoftoi Ambasadorën për bashkëpunimin ndërkombëtar të Akademisë.

Të dyja palët u shprehën të kënaqura

për rrjedhën e takimit dhe u zotuan se do ta thellojnë bashkëpunimin.

VIZITA E AMBASADORIT TË GJERMANISË NË ASHAK

Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 20 tetor 2021 e vizitoi ambasadori i Gjermanisë në Kosovë z. Jörn Rohde.



Ambasadori Rohde u prit nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, anëtarët e Kryesisë: akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar, anëtare korrespondente Myzafer Limani, sekretare Shkencore, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës, anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve dhe akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar të ASHAK- ut.

Kryetari Kraja e falënderoi Ambasadorin për vizitën dhe e njoftoi atë me punën e Akademisë.

Akademik Ismajli e njoftoi Ambasadorin për rrjedhën e bashkëpunimit ndërkombëtar të Akademisë. Ai e njoftoi atë edhe për kontributin e studiuesve nga Gjermania që lanë gjurmë në fushën e albanologjisë.

Për bashkëpunimin në fushën e shkencave të natyrës me Akademinë e Gjermanisë- Leopoldina, Ambasadorin e njoftoi sekretari i Seksionit të SHN-së, Fetah Podvorica.

Të dyja palët u shprehën të kënaqura për rrjedhën e takimit dhe u zotuan se do ta thellojnë bashkëpunimin në të ardhmen.

PARAQITEN BOTIMET E ASHAK- UT

Më 22 tetor në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit në Tiranë u paraqitën botimet e ASHAK- ut.

Paraqitja u bë në aktivitetin "Tetori i librit" që u organizua në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit në Tiranë. Aty morën pjesë kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Mehmet Kraja i shoqëruar nga anëtarët e Kryesisë, anëtare korrespondente Myzafere Limani, sekretare shkencore, akademik Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, akademike Justina Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar i Seksionit të Arteve, më 22 tetor 2021.

Prezent në aktivitet ishin edhe kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Skënder Gjinushi, i shoqëruar nga anëtarët e Kryesisë, akademikë, profesorë dhe njerëz të letrave.

Pas paraqitjes së botimeve, dy kryetarët e Akademive i njoftuan të pranishmit për bashkëpunimin e ndërsjellë.

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE: STUDIMET PËR SHQIPTARËT NË FRANCË

E paraparë për muajin tetor 2020, me ndërhyrjen e masave parandaluese kundër pandemisë Covid 19, qe shtyrë për muajin tetor të vitit 2021. Këshilli organizues, me në krye akademik Rexhep Ismajlin, me gjithë vështirësitë, arriti të marrë konfirmimin e rreth 48 pjesëmarrësve. Konferenca u mbajt në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 29 dhe 30 tetor 2021, me praninë e pothuaj të gjithë atyre që kishin konfirmuar pjesëmarrjen dhe me paraqitjen *online* të 3- 4 pjesëmarrësve të tjerë nga Franca dhe Rumania, që paraqitën kumtesat e tyre dhe morën pjesë aktivisht në diskutime. Konferenca erdhi në vazhdimësi të tri aktiviteteve të mëhershme: "Studimet albanistike në Amerikë", (2015), "Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht", (2017) dhe "Studimet albanistike në Itali", (2019). Synohej një pasqyrë më e afërt e studimeve shqiptare në botën frankofone me qëllim që t'u jepet shtysë zhvillimeve të mëtejme dhe përdëgjimit të këtyre kontakteve në të gjitha rrafshet e veprimtarisë kulturore- intelektuale. Konferenca, e vlerësuar shumë e suksesshme, edhe në këto rrethana, u ndoq me interes edhe në kanalën zyrtar të ASHAK- ut në Youtube, praktikë e dëshmuar e nevojshme në kohët e kufizimeve nga pandemia.



KUVENDI I STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Më 24 deri më 28 nëntor 2021, në Tiranë, u mbajt Kuvendi i studimeve albanologjike, aktivitet i përbashkët i dy akademive, ASHAK dhe ASHSH.

Në këtë aktivitet kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja u paraqit me një fjalë rasti, ndërsa me kumtesa u paraqitën akademikët: Ali Aliu, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Kujtim Shala dhe anëtarët korrespondentë: Bardh Rugova, Nysret Krasniqi dhe Shkumbin Munishi.

LIGJËRATË INAUGURUESE E AKADEMIK ABDYLMENAF BEXHETIT, ANËTAR I JASHTËM

Më 2 dhjetor 2021, e enjte, ora 12:00, në mjediset e ASHAK- ut, akademik Abdylmenaf Bexheti mbajti ligjëratën inauguruese me titull: “Politikat fiskale kontraciklike me theks të veçantë përgjatë dhe pas korona krizës – Observim/ krahasim RMV dhe RKs”.

Fjalën e hapjes në këtë aktivitet e mbajti akademik Mehmet Kraja, kryetar i ASHAK- ut, i cili me këtë rast ia dorëzoi Akademik Bexhetit Fletëdëshminë e zgjedhjes anëtar i jashtëm i ASHAK- ut.

U MBAJTËN ZGJEDHJET PËR KRYESINË E RE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, sot më 9 dhjetor 2021, mbajti zgjedhjet e rregullta të udhëheqjes së Akademisë dhe zgjodhi Kryesinë e re të Akademisë:

1. Akademik Mehmet Kraja, Kryetar
2. Akademiqe Justina SH. Pula, Nënkryetare
3. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, Sekretar shkencor

Kuvendi i Akademisë gjithashtu miratoi zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve:

1. Akademik Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë
2. Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore
3. Anëtar korrespondent Fetah

Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës

Akademik Rauf Dhomi, u caktua ushtrues i detyrës së Sekretarit të Seksionit të Arteve.



KONCERT FESTIV NË AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Më 15 dhjetor në Akademinë e shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt koncert festiv, në të cilin performoi Ansambli i harqeve “Academia Albanica” nga Tirana, nën drejtimin e dirigjentit të mirënjohur Eno Koço. Në violina interpretuan Lorenc Radovani, Ednea Krasniqi, Fatos Bardulla, Edlira Shkurti, Jadvina Vani, Elda Dono dhe Lorin Lepuri; në viola Arian Paço Albana Kola dhe Albana Meneri; në violonçela Gëzim Belegu dhe Andi Alimemaj, si dhe në kontrabas Arben Basha.



U interpretuan “Ndjesi tradicionale

shqiptare” nga Thoma Nasi, Suitë për orkestër harqesh nga Zeqirja Ballata, “Tingëllim epik” nga Çesk Zadeja, “Simfoni kamerale” të Rauf Dhomit, “Valle antike” nga Vasil Tole dhe “Shpirti i traditës” nga Valton Beqiri.

Koncerti festiv në vigile të festave të fundvitit synon të bëhet tradicional në ASHAK.

U PARAQIT BOTIMI “KTHESA E DRAMËS MODERNE (SHEK. XIX-XX)” I AKADEMIK MUHAMEDIN KULLASHIT

Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të mërkurën, me datë 22 dhjetor 2021, në orën 12:00, Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK- ut paraqiti librin e akademik Muhamedin Kullashit, “Kthesa e dramës moderne (shek. XIX-XX)”.



Aktivitetin e shpalli të hapur me një fjalë rasti akademike Justina SH. Pula, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.

Për librin folën recensentët: akademik Eqrem Basha dhe prof. dr. Haqif Mulliqi.

Në fund autori paraqiti një përmbledhje të shkurtër të librit dhe falënderoi Akademinë për mbështetjen dhe të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.

**VJETARI
2021**

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Bahri Koskoviku

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 7.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 100 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup